



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Pukë**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**MBI**  
**Auditimin Financiar**

**BASHKIA PUKË**

**Tiranë, Korrik 2024**

<b>PËRMBAJTJA</b>		<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	3-7
1	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-4
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-6
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6-7
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	7-11
1	Objektivat dhe qëllimi	7-8
2	Identifikimi i çështjes	8-8
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8-8
4	Përgjegjësitë e audituesve	8-9
5	Kriteret e Vlerësimit	9-10
6	Standartet e auditimit	10-10
7	Metodat e auditimit	10-11
8	Dokumentimi i auditimit	11-11
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI AUDITIMIT</b>	12-73
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12-12
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	12-73
2.1	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit për vitin 2023	12-34
2.2	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2023	34-53
2.3	Mbi administrimin e pronës publike	53-60
2.4	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	61-69
2.5	Të ndryshme të dala gjatë auditimit (Ankesa)	69-73
<b>IV.</b>	<b>REKOMANDIME</b>	73-87
<b>V.</b>	<b>ANEKSE</b>	88-97

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia Pukë është njësi vendore, institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe 4 ish-komunave në afërsi të tij, pra në total ka 5 njësi administrative si vijon: njësia administrative Pukë (qyteti), njësi administrative Gjegjan, Rrapë, Qelëz dhe Qerret, Qyteti Pukë.

**Misioni** i Bashkisë Pukë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

**Synimi kryesor** është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

**Buxheti i Bashkisë Pukë** si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

### b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: *“1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”*. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Pukë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

### c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare, e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga Bashkia Pukë. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit;
- mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në pasqyrat financiare;
- mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike;
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

### d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

**e. Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 22 gjetje dhe ka dhënë 25 rekomandime, nga ku masa organizative me 16 gjetje dhe 19 rekomandime, 1 gjetje-rekomandim për eliminimin e efekteve negative financiare, 5 gjetje dhe 5 rekomandime

në vlerën **27,748,768 lekë** në fushën për uljen e borxhit tatimor, për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia.

**f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.** Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

▪ **Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave**

- Të ardhura të munguara në vlerën 14,206,471 lekë nga mosarkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorë e biznesit.

- Të ardhura të munguara në vlerën 802,148 lekë nga mosarkëtimi i taksës së nga debitorë familje.

- Të ardhura të munguara në vlerën 2,746,417 lekë nga mosarkëtimi i taksës së tokës nga fermerët debitorë.

- Të ardhura të munguara në vlerën 1,451,532 lekë nga mosarkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 12 persona debitorë.

- Të ardhura të munguara nga mosarkëtimi i tarifës së qirasë në vlerën 6,240,200 lekë nga 7 qiramarrës.

- Nga auditimi konstatohet se, **Llogaria 4342 “Të tjera Operacione me shtetin (të drejta)”**, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 23,725,698 lekë e cila kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare. Nga auditimi u konstatuan diferenca midis vlerave të pasqyruara në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruar në llogaritë e pasivit, në shumën **-30,633,989 lekë**. Pra, vlera e kësaj llogarie në bilancin kontabël është pasqyruar në mënyrë jo të drejtë në aktivin e pasqyruar të pozicionit financiar. Vlera e cila duhej paraqitur është 54,359,687 lekë, e cila duhej të përfaqësonte llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar.

- Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto)” në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për vlerën historike 633,837,427 lekë, është përfshirë vlera prej **85,000,000 lekë** me emërtimin e objektit “Ujësullësi i Gjogjanit” e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike, kjo vlerë është kapitalizuar si aset pa u kryer punimet përfundimtare dhe pa u marrë në dorëzim si investim. Vlera prej **85,000,000 lekë** duhej të paraqitej në shpenzime në proces për sa kohë investimi nuk ka përfunduar dhe marrë në dorëzim. Poashtu është mbajtur jashtë kontabiliteti objekti Ujësullësi i fshatit Luf-Bashkia Pukë me vlerë 96,256,588 lekë i cili është marrë në dorëzim përfundimtar nga bashkia Pukë me datë 13.11.2023.

-Nga auditimi i **Llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2023 janë në vlerën 25,959,120 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur rritje në vlerën 4,703,164 lekë dhe pakësime në vlerën 2,694,800 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie në pasqyrat financiare paraqitet në vlerën 20,681,611 lekë. Vlerat e paraqitura në bilancin kontabël nuk përputhen më të dhënat analitike të vëna në dispozicion nga zyra e financës. **Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”** ka mospërputhje e cila duhej të ishte 27,967,484 lekë dhe jo 20,681,611 lekë. Sa më sipër është kjo llogari është nënvlerësuar në shumën 7,285,873 lekë. Ky veprim ka sjellë një deformim të informacionit kontabël dhe nuk paraqet gjendjen reale të kësaj llogarie.

**h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:** Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Sektori i Urbanistikës dhe Planifikimit Vendor të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Tatim Taksave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime të reja që janë legalizuar me vlerë **1,426,025 lekë**.

- Sektori i Tatim Taksave, në bashkëpunim me Njësitë Administrative të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, duke verifikuar në terren si dhe marrjen zyrtare e të dhënave nga institucionet përkatëse. Pas identifikimit dhe evidentimit me të gjithë treguesit të parcelave të tokës që disponon çdo fermer, të rishikohet planifikimi i të ardhurave për këtë taksë, të ndiqet arkëtimi i saj nëpërmjet njoftim-vlerësimeve për detyrimet për gjithë kohën e papaguar për familjet fermerë dhe për

mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative e ligjore në strukturat e tjera kompetente, sipas rastit.

Gjithashtu të ndiqen të gjitha rrugët ligjore deri në arkëtimin e vlerës 2,746,417 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë.

- Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Pukë, si, Sektori i Urbanistikës dhe Planifikimit Vendor, Sektori Juridik, Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë e Financës, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **19,206,568 lekë** kjo për subjekte/abonent familjare, për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

- Bashkia Pukë të marrë të gjitha masat ligjore dhe administrative për arkëtimin e vlerës së debisë progresive në masën **6,240,200 lekë**.

- Kryetari i Bashkisë Pukë në bashkëpunim me Sektorin e Policisë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 102,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

- Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Financës të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe të bëjë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

- Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigojohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

- Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

- Kryetari i Bashkisë të marrë masa për ngritjen e një strukture të posaçme për ushtrimin e funksioneve në lidhje me përditësimin e inventarëve të pasurive të paluajtshme, duke krijuar një inventar të integruar për ish-komunat dhe për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me qëllim miratimin e inventarëve përfundimtare dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

- Kryetari i Bashkisë Pukë të marrë masa për ndryshimin e urdhrit nr.337 datë 29.08.2023 për emërimin e znj. V. K në pozicionin e Drejtorit të Konviktit "Ali Bytyçi", duke përcaktuar përlllogaritjen e pagës si vijon (pagë grupi 14,000 lekë + pozicioni 80,000 lekë + 2% vjetërsi), në bazë të VKM nr. 175/2017 i ndryshuar si dhe t'i kthehen diferencat e mbajtura padrejtësisht nga paga, duke filluar nga muaji shtator 2023 e në vijim.

- Bashkia Pukë të marrë masa për të anuluar kontrata e qirave për dhënie në përdorim të fondit pyjor për subjektet W. N-E" sh.p.k, "L. E" sh.p.k, "V 2021" sh.p.k si kontrata të lidhura në kundërshtim me kuadrin rregullator, duke njoftuar për këtë qëllim Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Po ashtu, të marrë masa për inventarizimin e dosjeve duke i plotësuar me dokumentacionin si planvendosjen, projektin e ndërtimit, planin e biznesit etj. Për kontratën me subjektin "MC. E G" të bëjë një rivlerësim të tarifave, përfshirë rrugën e kalimit.

- Nëpunësi zbatues të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)" me qëllim dhënie e informacionit kontabël të saktë.

- Nëpunësi zbatues në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare, të marrë masa për kapitalizimin e të gjitha objekteve të marra në dorëzim. Po ashtu të sistemojë vlerat e paraqitura gabim në pasqyrën 7/b me qëllim paraqitjen reale të gjendjes dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata.

- Drejtori i financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, të marrë masa që me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024 të sistemojë me analizë llogarinë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” me qëllim pasqyrimin e saktë të vlerave në kontabilitet. Po ashtu të kapitalizojë vlerën 73,804,717 lekë e cila i përket investimeve të përfunduara prej vitesh.

### **I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit**

#### **Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2023:**

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Pukë për periudhën ushtrimore 01.01.2023–31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i primeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

*"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Pukë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar me rezervë**”, e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

#### **Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 - Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 11.8 milion lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2023, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- **Llogaria 4342 “Të tjera Operacione me shtetin (të drejta)”**, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 23,725,698 lekë e cila kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare. Nga auditimi u konstatuan diferenca midis vlerave të pasqyruara në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruar në llogaritë e pasivit, në shumën **-30,633,989 lekë**. Pra, vlera e kësaj llogarie në bilancin kontabël është pasqyruar në mënyrë jo të drejtë në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar. Vlera e cila duhej paraqitur është 54,359,687 lekë, e cila duhej të përfaqësonte llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar.

-Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto)” në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për vlerën historike 633,837,427 lekë, është përfshirë vlera prej **85,000,000 lekë** me emërtimin e objektit “Ujësjetësi i Gjogjanit” e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike, kjo vlerë është kapitalizuar si aset pa u kryer punimet përfundimtare dhe pa u marrë në dorëzim si investim. Vlera prej **85,000,000 lekë** duhej të paraqitej në shpenzime në proces për sa kohë investimi nuk ka përfunduar dhe marrë në dorëzim. Poashtu është mbajtur jashtë kontabiliteti objekti Ujësjetësi i fshatit Luf-Bashkia Pukë me vlerë 96,256,588 lekë i cili është marrë në dorëzim përfundimtar nga Bashkia Pukë me datë 13.11.2023.

-Nga auditimi i llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit

ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 244,905,059 lekë kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se, në fund të vitit 2023 ka kontrata që kanë përfunduar si punime dhe likujdime për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesa sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Vlera në total prej 73,804,717 lekë duhej kapitalizuar dhe jo të kategorizohej si shpenzim në proces. Për sa më sipër konstatohet se për këtë llogari nuk ka një pasqyrim real jo vetëm të gjendjes faktike por për pasojë ka ndikuar në vlerën e fondit bazë neto të institucionit, dhe në pasqyrimin e aseteve në dispozicion të kësaj bashkie.

-Nga auditimi i **Llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2023 janë në vlerën 25,959,120 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur rritje në vlerën 4,703,164 lekë dhe pakësime në vlerën 2,694,800 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie në pasqyrat financiare paraqitet në vlerën 20,681,611 lekë. Vlerat e paraqitura në bilancin kontabël nuk përputhen më të dhënat analitike të vëna në dispozicion nga zyra e financës. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” ka mospërputhje e cila duhej të ishte 27,967,484 lekë dhe jo 20,681,611 lekë. Sa më sipër kjo llogari është nënvlerësuar në shumën 7,285,873 lekë. Ky veprim ka sjellë një deformim të informacionit kontabël dhe nuk paraqet gjendjen reale të kësaj llogarie.

-Nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit: Aktivët që pas vlerësimit janë nxjerrë jashtë përdorimit, janë hequr nga regjistri i aktiveve në përdorim, por nyk janë bërë hyrje në magazinë. Nuk ka gjurmë auditimi për procesin e bërjes hyrje të aktiveve jashtë përdorimi dhe ndarjes së aktiveve të cilat mund të përdoren për dru zjarri në rastin e aktiveve si karrige, banga shkolle, orendi të tjera apo në rastin e materialeve metalike nga ku mund të përdoren për skrap.

- Të ardhura të munguara në vlerën 14,206,471 lekë nga mosarkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorë e biznesit.

- Të ardhura të munguara në vlerën 802,148 lekë nga mosarkëtimi i taksës së nga debitorë familje.

- Të ardhura të munguara në vlerën 2,746,417 lekë nga mosarkëtimi i taksës së tokës nga fermerët debitorë.

- Të ardhura të munguara në vlerën 1,451,532 lekë nga mosarkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 12 persona debitorë.

- Të ardhura të munguara nga mosarkëtimi i tarifës së qirasë në vlerën 6,240,200 lekë nga 7 qiramarrës.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. prot., 618/1, datë 09.05.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 13.05.2024 deri në datë 07.06.2024, në subjektin Bashkia Pukë për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 u krye auditimi “Mbi Auditimin Financiar”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A. G., përgjegjës grupi;
2. A. D., auditues;
3. R. L., auditues;
4. R. A., auditues.

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

### 1. Objekti dhe qëllimi i auditimit.

Auditimi Financiar në Bashkinë Pukë kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrin ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe

mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>3</sup>;

- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Pukë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 2023, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

### **Identifikimi i çështjes.**

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Pukë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Fushat të cilat u audituan janë si vijon:

1. Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit;
2. Raportimi financiar;
3. Organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike;
4. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
5. Të tjera të dala gjatë auditimit (Ankesa)

### **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.**

Niveli drejtues i Bashkisë Pukë (Kryetari i Bashkisë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Drejtori i Financës, në rolin e Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontroleve të brendshme të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keq-raportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

Gjithashtu Kryetari i Bashkisë Pukë, Drejtorët dhe Përgjegjësit e sektorëve pranë Bashkisë Pukë kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

### **Përgjegjësitë e audituesve.**

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim, pra nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe rezultatet financiare të njësisë ekonomike janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi (ISSAI 1200.3). Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së arsyeshme. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozonë që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat



financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë. Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keqraportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. (ISSAI 1200.7) Raporton rastet e mospërfundshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë, dhe/ose Raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

**Kriteret e vlerësimit.** Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, datë 16.10.2017 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”, pikat 88-125; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2023”, pikat 95-122; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF

nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financiare nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .  
- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.  
Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

- **Standardet e auditimit.** ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

**Metodat e auditimit.** Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë rrisht. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*<sup>1</sup>. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi

---

<sup>1</sup> ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:*

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

*Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

### **Dokumentimi i auditimit.**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Me shkresën nr. 618/3, datë 25.06.2024, nga grupi i auditimit të KLSH është nisur Projektraporti i Auditimit në të cilën u evidentuan mangësitë e konstatuara gjatë procesit të auditimit, mangësi të cilat nuk kishin argumentin e duhur ligjor gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i përcillet subjektit për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

### **III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:**

Bashkia është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

Auditimi në subjektin “Bashkia Pukë”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar. Në këtë subjekt, *u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi që në gjykimin profesional të pavarur janë materiale por jo të përhapura, etj.*

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

#### **2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.**

##### **2.1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit**

###### **2.1.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2023:**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se për vitin 2023 për përgatitjen e PBA 2023-2025 dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me VKB nr. 68, datë 30.12.2022, si dhe VKB përkatëse për miratimin e fondeve të trashëguara për çdo fillim viti buxhetor. Gjithashtu janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 87/1 prot., datë 19.01.2023. Në vija të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Pukë.

Fusha me prioritet në shpenzimet për investime janë konsideruar:

- a. *Përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit;*
- b. *Përmirësimi i rrjetit rrugor rural;*
- c. *Menaxhimi i mbetjeve urbane;*
- d. *Ndriçimi i rrugëve;*
- e. *Përmirësimi i kushteve për turizmin;*
- f. *Ofrimi i shërbimeve publike;*
- g. *Riparimi i objekteve arsimore.*

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e MFE nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësisive të Qeverisjes Vendore”. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

Programi i të ardhurave për vitin 2023 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me VKB nr.56, datë 30.12.2022.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Buxheti total i Bashkisë Pukë për vitin 2023 është 479,834 mijë lekë.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2023, realizohen nga dy burime:

**Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen;

**Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2023 paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor.

Tabela nr.1, PBA për periudhën 2023-2025 sipas programeve ekonomike që menaxhon Bashkia Pukë

Nr.	Kodi	Programi	PBA Plan viti 2023	Buxheti vjetor 2023 Plani i Rishikuar	Realizimi i periudhes progresiv	Diferenca (3-2)
1	01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	63,682	64,711	57,723	(6,988)
2	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	2,876	3,006	2,798	(208)
3	03280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	23,773	26,004	15,155	(10,849)
4	04130	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	129	129	129	-
5	04240	Menaxhimi i Infrastruktues së Ujitjes dhe Kullimit	6,608	7,460	1,587	(5,873)
6	04520	Rrjeti Rrugor Rural	11,313	12,413	11,681	(732)
7	05100	Menaxhimi i Mbetjeve	11,158	12,108	10,403	(1,705)
8	06260	Shërbimet Publike Vendore	63,431	86,658	54,590	(32,068)
9	04260	Administrimi I pyjeve	16,897	18,091	12,596	(5,495)
10	06370	Furnizim me Uje	15,250	85,250	85,250	-
11	08130	Sport dhe Argëtim	26,548	27,572	22,522	(5,050)
12	08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	5,450	6,760	5,619	(1,141)
13	09120	Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin	75,342	68,519	47,314	(21,205)
14	09230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	31,486	31,306	21,862	(9,444)
15	10140	Cerdhja ditore	8,328	8,328	7,924	(404)
16	10430	Përkujdesi Social	91,384	107,084	106,181	(903)
17	10661	Strehimi Social	6,200	6,200	3,800	(17,309)
18	04940	Fond Rezerve dhe kontigjence	2,000	2,000	-	(2,000)
19	10910	Emergjencat Civile	11,946	11,946	8,513	(3,433)
20	01170	Gjendja civile	3,260	3,260	2,956	(304)
21	01620	Zgjedhjet e përgjithshme lokale	1,251	1,251	1,231	(20)
<b>Totali i shpenzimeve të njësisë</b>			<b>478,312</b>	<b>590,056</b>	<b>479,834</b>	<b>125,131</b>

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2023-2025, pjesë e të cilit është edhe planifikimi për vitin buxhetor, si dhe krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor, rezulton se diferenca ndërmjet planit fillestar dhe atij final është 125,131 mijë lekë. Diferencë e konsiderueshme rezulton në programin ekonomik për “Shërbimet Publike Vendore”, “Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor”, “Strehimi Social”, “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” dhe “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”.

Pjesë e PBA dhe planifikimit të buxhetit vjetor, është edhe planifikimi i të ardhurave, si burim i integruar në programet buxhetore, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Kështu për periudhën 2023-2025 Bashkia Pukë ka planifikuar të arkëtojë të ardhura tatimore dhe jo tatimore, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.2, Planifikimi i të ardhurave Bashkia Pukë

Përshkrimi	Planifikimi 2023
Të ardhura tatimore	14,252
Të ardhura jotatimore	32,130
<b>TOTAL</b>	<b>46,382</b>

000/lekë

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Për PBA 2023-2025 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Pukë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

-Për PBA 2023-2025 dhe Buxhetin vjetor 2023 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 33 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si vijon: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor”.

-Për PBA 2023-2025 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore”, për drejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetore të Bashkisë Pukë, lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Pukë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, (nuk është bërë analize e detajuar);

-Për PBA 2023-2025 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, pasi nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;

- Tavanet Përgatitore dhe tavanet Përfundimtare të PBA-së 2023-2025, janë miratuar jashtë afateve;

- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 7, datë 26.02.2021 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”.

-Në buxhetin vjetor të vitit 2023, nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin/përmirësimin e fondit pyjor, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 5 të nenit 23 në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020.

### **2.1.2. Celja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.**

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit parardhës.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të Kryetarit të Bashkisë.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Pukë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Pukë ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit Pukë, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Shkodër.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Tabela nr. 3, Planifikimi i buxhetit për vitin 2023, Bashkia Pukë

Nr.	Përshkrimi	Plani i Viti 2023	
		Të ardhurat	Shpenzime
1	Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës	1,975,937	
2	Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës	15,738,947	
3	Trashëguar nga transferata specifike	30,408,741	
4	Të trashëguara nga FZHR	2,278,000	
5	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	66,382,000	
6	Granti	132,140,000	
7	Transferta specifike	119,366,118	
8	Paga (600) + sigurime shoqërore (601)		218,200,929
9	Shpenzime operative (602)		61,897,929
10	Investime (230+231) nga të ardhurat dhe tr.e pakushtëzuar		64,168,000
11	Fondet emergjencë dhe fondet rezervë		4,661,000
12	Investime (230+231) nga buxheti i shtetit		
13	Shpenzime (603+604+606)		19,361,885
<b>Totali i buxhetit</b>		<b>368,289,743</b>	<b>368,289,743</b>

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Rezulton se buxheti i konsoliduar (Bashki + Njësitë e Varësisë) për vitin 2023 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **368,289,743 lekë**.

Përgjatë vitit 2023, kanë ndodhur 3 ndryshime buxhetore me efekt në shtesa/pakësim të fondeve për artikull ekonomik, veprime që tregojnë për planifikime jo optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtime të shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

Tabela nr.4, Ndryshimet buxhetore për vitin 2023

Periudha Buxhetore	Buxheti fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve				
	Nr. datë	Vlera	Nr. Datë	Vlera	Pakësuar artikulli / shtuar artikulli				
					Shtesa. Art.	Shuma	Pakësim. Art.	Shuma	
Viti 2023	Nr 68 date 30/12/2022_ konfirmuar nr 81/1 date 19.01.2023	327,212			600+601	207,012			
					602-609	78,303			
					231	41,897			
						327,212			
		VKB.Nr.26 date 22/09/2023 konfirm nr.623/1 date 05.10.2023 Urdher nr. 162 date 25.05.2023				600+601	9,727		
						602-609	6,697		
						231	173		
		shuma			168,78		16,878		
		VKB.Nr.34 date 01/11/2023 konfirm nr.743/1 date 17.11.2023			41,89				
						600+601	4,189		
		Urdher nr 369 date 12/09/2023 te ardhura kesh Qarkut			20,000				
231	20,000								
<b>Totali Viti 2023</b>		<b>327,212</b>		<b>41,067</b>		368,279			

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 149 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në gjykimin e grupit të auditimit ndryshimet buxhetore përgjatë vitit buxhetor, tregojnë për një performancë jo të mirë në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Tabela nr.5, Realizimi i buxhetit vjetor në nivel programi ekonomik

Nr.	Kodi	Programi	Plan Progresiv 2023	Fakti	000/lekë
					%
1	01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	64,711	57,723	89
2	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	3,006	2,798	93
3	03280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	26,004	15,155	58
4	04130	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	129	129	100
5	04240	Menaxhimi i Infrastruktues së Ujitjes dhe Kullimit	7,460	1,587	21
6	04520	Rrjeti Rrugor Rural	12,413	11,681	94
7	05100	Menaxhimi i Mbetjeve	12,108	10,403	86
8	06260	Shërbimet Publike Vendore	86,658	54,590	63
9	04260	Administrimi I pyjeve	18,091	12,596	70
10	06370	Furnizim me Uje	85,250	85,250	100
11	08130	Sport dhe Argëtim	27,572	22,522	82
12	08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	6,760	5,619	83
13	09120	Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin	68,519	47,314	69
14	09230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	31,306	21,862	70
15	10140	Cerdhja ditore	8,328	7,924	95
16	10430	Përkujdesi Social	107,084	106,181	99
17	10661	Strehimi Social	6,200	3,800	61
18	04940	Fond Rezerve dhe kontigjence	2,000	-	
19	10910	Emergjencia Civile	11,946	8,513	71
20	01170	Gjendja civile	3,260	2,956	91
21	01620	Zgjedhjet e pergjithshme lokale	1,251	1,231	98
<b>Totali i Shpenzimeve të Njesisë</b>			<b>590,056</b>	<b>479,834</b>	<b>81%</b>

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se:

**Për vitin 2023** realizimi i buxhetit është në nivelin 81%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimi më të lartë është “Furnizimi me ujë”, “Përkujdesi social”, “Rrjeti Rrugor Rural, dhe “Planifikim Menaxhimi dhe Administrimi; Programi me realizimin më të ulët është “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”;



### **2.1.3. Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.**

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Pukë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar në përgjithësi janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Pukë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë ose të diktuar nga Transferata e deleguar nga pushteti qendror.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2023-2025, referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Tabela nr.6, Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik – viti 2023

<i>000/lekë</i>				
Art.	Emertimi	Plani progresiv	Fakti	%
600	Paga	192,306	177,155	92
601	Sigurime Shoqërore	31,421	29,151	93
602	Mallradhe Shërbime të Tjera	62,278	37,060	60
604 609	Transferata Korrente të Brendshme	26,699	21,159	79
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	107,640	106,638	99
230 231	Investime	154,586	108,671	70
231	Investime me donator	15,125	0	0
	<b>TOTAL</b>	<b>590,055</b>	<b>479,834</b>	<b>81%</b>

*Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin 2023 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 81%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 “Transferata për Buxhet Familjar dhe Individ” duke vijuar me shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, transferata korrente të brendshme si dhe realizimin më të ulët e kanë mallra dhe shërbime të tjera. Vihet re se për vitin 2023 art. (602) mallra dhe shërbime të tjera paraqiten 60 %, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.

### **Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit.**

Tabela nr.7, Buxheti sipas burimeve të financimit 2023

<i>000/lekë</i>						
Art.	Emertimi	Fakt 2023				% nga përdorimi i të ardhurave të veta
		Gjithesëj	Të ardhurat e veta	Tr.Pakush tëzuar	Tr.kushtëzuar dhe Specifike	
600	Paga	177,155	11,781	78,561	86,813	7
601	Sigurime Shoqërore	29,151	771	14,059	14,321	3
602	Shp. Operative	37,020	3,808	24,054	9,158	10
604	Transf. Korrente të Brendshme	21,159	4,345	14,300	2,514	21
606	Transf. për familje dhe individ	106,638		324	106,314	0
231	Investime	108,671	6,869	8,314	93,488	6
	Kuotë qarku	40		40		0
	<b>Total</b>	<b>479,834</b>	<b>27,574</b>	<b>139,652</b>	<b>312,608</b>	<b>6%</b>

*Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

-Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se fondet e shpenzuara nga transferata e kushtëzuar dhe specifike, në vlerën 312,608 mijë lekë ose 65 % të fondeve të shpenzuara për vitin 2023, për të vijuar me transfertën e pakushtëzuar në vlerën 139,652 mijë lekë ose 29% të fondeve sipas burimit të financimit dhe të ardhurat e veta në vlerën 27,574 mijë lekë ose 6% të fondeve sipas burimit të financimit.

### **Transferata e kushtëzuar specifike.**

-Buxheti nga transferata e kushtëzuar dhe specifike për vitin 2023 është realizuar në vlerën 312,608 mijë lekë, ose 65 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore

brenda transfertës kushtëzuar dhe specifike, e zënë shpenzimet për Transferta për familje dhe individ dhe investime.

#### **Transferta e pakushtëzuar.**

-Buxheti nga transfertat e pakushtëzuar për vitin 2023 është realizuar në vlerën 139,652 mijë lekë, ose 29% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga, shpenzime operative dhe Investime.

#### **Të ardhurat e veta.**

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2023 është realizuar në vlerën 27,574 mijë lekë, ose 6 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga, investime dhe transfertat korrente të brendshme.

#### **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.**

Me miratimin e buxhetit për vitin 2023 është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/dhe kontigjencës, ku për vitin 2023 është planifikuar në masën 2,000 mijë lekë. Sipas të dhënave nga Bashkia Pukë nga fondi rezerve/dhe kontigjencës nuk janë përdorur gjatë vitit.

-Totali i fondit rezervë dhe kontigjencës është brenda limitit 3%, përjashtuar transfertën e kushtëzuar.

#### **Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Pukë.**

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se Bashkia Pukë përgjatë periudhës 2023 nuk ka marrë nuk ka dhënë asnjë subvencion.

#### **Realizimi i Investimeve.**

Grupi i KLSH konstaton se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele jo të mira në vitin 2023, konkretisht në masën 70 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Pukë në fillim të vitit buxhetor planifikon procedurën të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Neni 47 në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

#### **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak.**

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 datë 30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44<sup>2</sup>, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konstatohet se për vitin 2023 nuk administrohet raporti i monitorimit të buxhetit për 4 mujorin e parë të vitit, për 4 mujorin e dytë është raportuar në Ministrinë e Financave me datë 26.09.2023, nuk administrohet shkresa përcjellëse dhe me shkresën nr. 541 prot., datë 27.02.2024 ka përcjellë në Ministrinë e Financave raportin vjetor të monitorimit të buxhetit. Pra për 4 mujorin e parë të vitit nuk ka përcjellë në Ministrinë e Financave raportin e monitorimit të buxhetit, për 4 mujorin e dytë nuk administrohet shkresa përcjellëse si dhe nuk është përcjellë në Këshillin Bashkiak një kopje e raportit të monitorimit të buxhetit të njësisë

---

<sup>2</sup> Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport paraqitet në këshill jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

së qeverisjes vendore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 48 të ligjit nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

**2.1.4. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve, celja e fondeve dhe realizimi i tyre;**

-Vlera e fondeve të parashikuara/planifikuara për prokurim për vitin 2023 në artikullin (602/231) shprehur gjithësej në vlerë 93,721,556 lekë pa TVSH, nga e cila:

- Prokurime me vlerë të lartë në vlerën 54,408,674 lekë.
- Prokurime me vlerë të vogël në vlerën 39,312,882 lekë.

*Nga prokurimet me vlerë të lartë, janë parashikuar në fushën e investimeve në vlerën prej 44,382,885 lekë, dhe në fushën e shërbimeve/blerjeve në vlerën 10,025,789 lekë*

-Vlera e fondeve të kontraktuara realizuara, në vitin 2023, në artikullin (602/231) shprehur gjithësej në vlerë 47,886,409 lekë pa tvsh, nga e cila:

- Prokurime me vlerë të lartë në vlerën 26,197,134 lekë.
- Prokurime me vlerë të vogël në vlerën 21,689,275 lekë.

*Nga prokurimet me vlerë të larta, janë realizuar në fushën e investimeve vlera prej 17,089,760 lekë, dhe sa janë në fushën e shërbimeve/blerjeve në vlerën 9,107,366 lekë.*

-Vlera e fondeve të pa likuiduar të kontratave të lidhura dhe të përfunduara, në fund të vitit 2023, për artikullin (602/231) shprehur gjithësej në vlerë 1,950,000 lekë, nga e cila:

- Prokurime me vlerë të lartë në vlerën 1,066,000 lekë.
- Prokurime me vlerë të vogël në vlerën 884,000 lekë.

*Nga prokurimet me vlerë të larta, janë realizuar në fushën e investimeve në vlerën 1,950,000 lekë, dhe në fushën e shërbimeve/blerjeve në vlerën 0 lekë.*

Përsa i përket procedurave të prokurimeve të pa realizuara kjo ka ardhur për disa faktorë për shkak të mosrealizimit të të ardhurave të parashikuara, të problematikave të konstatuara në projektet teknike për investimet si dhe për arsye të mos pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në procedurat e prokurimit.

**2.1.5. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.**

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Pukë, rezulton se, është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, si dhe janë raportuar periodikisht në Këshillin Bashkiak dhe MF.

Me fondet buxhetore të vitit 2023, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministrinë e linjës sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023 ka ardhur duke u ulur. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë vitit 2023.

Tabela nr.8, Detyrimet e prapambetura për periudhën 2023

Detyrime	Detyrimi në fund të vitit 31.12.2022	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2023-31.12.2023	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2023	Mbetja e Detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2023
Investime	5,799,759	17,902,927	23,702,686	19,902,927	3,799,759
Investime nga FZSHH	1,154,842		1,154,842		1,154,842
Mallra dhe shërbime	5,692,577		5,692,577	694,800	4,997,777
Vendime gjyqësore	25,844,918	86,400	25,931,318	5,249,707	20,681,611
Të tjera			0		0
<b>Totali</b>	<b>38,492,096</b>	<b>17,989,327</b>	<b>56,481,423</b>	<b>25,847,434</b>	<b>30,633,989</b>

*Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Vlera e detyrimeve të mësipërme është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që Bashkia Pukë ka ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2023, si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyrues (faturë tatimore/vendim gjykate) që krijon detyrimin përkatës.

-Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2023, përcjellë në MF me shkresën nr. 540 prot., datë 27.02.2024, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Pukë ndaj palëve të treta raportuar në MF është në vlerën **29,479,147 mijë lekë**, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime korrente, shpenzime kapitale dhe vendime gjyqësore pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela nr.9, Situata Financiare për vitin 2023

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJVQV-së
I	<b>Borxhe (a+b)</b>	0		
a	Hua sfatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	<b>Hua afatshkurtër</b>	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	<b>Detyrime (a+b+c)</b>	<b>29,479,147</b>		
a	<b>Shpenzime korrente</b>	<b>4,997,777</b>		
a,1	Mallra dhe shërbime	4,997,777		
a,2	Paga dhe sigurime			8 %
a,3	Të tjera			
b	<b>Shenzime kapitale</b>	<b>4,954,601</b>		
b,1	Insitucione buxhetore			
b,2	Subjekte private	4,954,601		
c	<b>Vendime gjyqësore</b>	<b>19,526,769</b>		
c,1	Marrëdhënie pune	134,000		
c,2	Mallra dhe shërbime	1,440,001		
c,3	Investime	<b>17,952,768</b>		
c,4	Të tjera			
III	<b>Totali (I+II)</b>	<b>29,479,147</b>	<b>368,289,743</b>	<b>8 %</b>

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Në vijim parashtrojmë përcaktimet e bëra për detyrimet e prapambetura, cfarë përfaqësojnë dhe cilat detyrime përfshihen:

“Detyrime të prapambetura ndaj palëve të treta”, nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare të NJVQV-ve, të pa paguara brenda 60 ditëve kalendarike (30 ditë për procedurat 3 e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit) nga data e pagesës së specifikuar në kontrat, faturë ose sipas ligjit”.

“Detyrimet e prapambetura rregjistrohen në llogarinë ekonomike nr.4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura”<sup>3</sup>.

“Njësitë e qeverisjes së përgjithshme përpara mbylljes së llogarive vjetore 2023, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë nr.486 në debi të llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në llogari në datën 31.12.2023”<sup>4</sup>.

-Pra sa më sipër vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është në masën 8 % ndaj totalit të shpenzimeve të miratuara për vitin 2023.

Stoku i detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta paraqitet më pak se 15% të shpenzimeve vjetore të miratuara, ç’ka do të thotë se **Bashkia Pukë në fund të vitit 2023 rezulton në një situatë normale.**

Stoku i detyrimeve nga Ministritë e Linjës është në vlerën 1,154,842 lekë deri në 31.12.2023.

<sup>3</sup> Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

<sup>4</sup> Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar”.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2023 janë në vlerën 20,681,611 lekë ose rreth 70% e detyrimeve të raportuara. Përgjatë vitit 2023 janë kryer likujdime në vlerën 5,163,307 lekë, të detyrimeve të mbartura nga vitet e mëparshme. Në fund të vitit 2023 Bashkia Pukë ka pasur fonde në dispozicion në vlerën 106,454,640 lekë, të cilat mund t'i përdorte për likuidimin e plotë të vendimeve gjyqësore si dhe nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit/personave që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Pukë.

Nga kryqëzimi i të dhënave mbi detyrimet e Bashkisë Pukë ndaj palëve të treta, kryesisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, konstatohet se:

Si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore nga vitet e mëparshme për personat e larguar nga puna përgjatë vitit 2023 janë likuiduar në vlerën 277,091 lekë dhe në fund të vitit 2023 janë në vlerën 134,000 lekë të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona.

Si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore nga vitet e mëparshme për investime dhe shërbime, përgjatë vitit 2023 janë likuidura në vlerën 4,886,216 lekë dhe në fund të vitit 2023 janë në vlerën 20,547,611 lekë.

-Gjithashtu konstatohet se për likuidimin e subjekteve të mësipërme është nxjerrë urdhëri përkatës nga titullari i institucionit, por në urdhrin e likuidimit nuk është nxjerrë edhe përgjegjësia administrative ndaj personit/personave që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Pukë.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

### **Shpronësimet për interes publik.**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Financës rezultoi se përgjatë vitit 2023 nuk ka pasur detyrime për shpronësime të krijuara në vitin 2023 apo nga vite të mëparshme dhe të palikuiduara.

### **Faturat e palikuiduara brenda afatit 30 ditor.**

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Pukë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën deri në fund të vitit 2023, ky afat nuk është respektuar në 97 raste për vlerën 30,633,989 lekë, pasqyruar në tabelën përmbledhëse më poshtë, në Kapitullin “Anekse”.

Tabela nr.10, Përmbledhëse e faturave për vitin 2023

Artikulli	Sasia	Viti 2023/lekë
230-231	16	25,636,212
602	81	4,997,777
<b>Totali</b>	<b>97</b>	<b>30,633,989</b>

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për periudhën deri në fund të vitit 2023 janë 97 fatura të palikuiduara për shpenzime për investime, shpenzime për vendime gjyqësore, shërbime dhe mirëmbajtje në vlerën 30,633,989<sup>5</sup> lekë.

-Likuidimi me vonesë i faturave në tejkallim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

<sup>5</sup> Analitikisht pasqyruar në Anekse.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

*Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: z. Gj. Gj me detyrë ish Kryetar i Bashkisë Pukë, znj. F. P, ish Drejtore e Financës dhe znj. F. L, Drejtore e Financës Bashkia Pukë.*

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**2.1.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënie me qira të aseteve dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.**

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023
- Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit për vitin 2023.
- Rregjistri i taksapaguesve privat dhe familjar.
- Rakordimet me agjentët tatimor.
- Evidenca e planifikimit të të ardhurave.
- Aktet e rakordimit me degën e thesarit për të ardhurat.
- Regjistrat e subjekteve debitorë në 31.12.2023.
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në lidhje me çështjen e të ardhurave.

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:***

**I.Struktura e Sektorit të Tatim Taksave, Bashkia Pukë.**

Për vitin 2023 me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB nr.67, nr.2308/2 prot., datë 30.12.2022, i ndryshuar, është miratuar numri i punonjësve, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Shkodër me shkresën nr.51/2, datë 18.01.2023. ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë, ku bën pjesë dhe sektori i Tatim Taksave.

Sektori i taksave në aktivitetin e tij për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave bashkëpunon edhe me sektor të tjerë pranë Bashkisë, si ai i pronave, pyjeve, urbanistikës, infrastrukturës, si dhe me inspektorët e taksave, për çdo Njësi Administrative, ku roli i këtyre sektorëve është hartimi i autorizimit për arkëtim, si dhe roli i sektorit të taksave dhe tarifave vendore është hartimi i faturës për arkëtim, dokument i cili i shërben subjektit për kryerjen e pagesës, duke vijuar me ndjekjen e arkëtim/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara.

-Sektori i Tatim Taksave ka në përbërjen e saj, 1 përgjegjës sektori dhe 5 specialistë.

Struktura e Sektorit të Tatim Taksave Bashkia Pukë, si dhe lëvizjet e punonjësve përgjatë vitit 2023 pasqyrohet si më poshtë:

Nr.	Emri Mbiemri	Funksioni Sipas Strukturës	Lloji i shkollës	Larte ose i mesëm	Urdhri i emërimit Nr., datë	Urdhri largimit Nr.,datë	Pozicioni i punës
a	b	1	2	3	4	5	6
1	N. A	Përgjegjes	Ekonomik	Larte	Nr.117/30.06.2020		Përgjegjes zyre
2	F. L	Specialist	Ekonomik	Larte	Nr.02/04.01.2023		Specialist
3	R. N	Specialist	Mesuesi	Larte	Nr.47/20.02.2017	Nr.203/06.07.2023	"
4	S. E	Specialist	Ekonomik	Larte	Nr.331/29.08.2023		"
5	G. Ll	Specialist	Ekonomik	Larte	Nr.248/07.09.2022		"
6	Gj. M	Specialist	Ekonomik	Larte	Nr.134/28.07.2016	Nr.596/22.11.2023	"
7	L. P	Specialist	Profesional	Mesem	Nr.597/22.11.2023		"
8	S. M	Specialist	Ekonomik	Larte	Nr.284/23.10.2017	Nr.453/02.10.2023	"

9	E. F	Specialist	Mesem	Nr.563/08.11.2023	"
---	------	------------	-------	-------------------	---

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë, për vitin 2023 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Pukë nga taksat dhe tarifat.

## **II. Taksat dhe Tarifat e aplikuara dhe arkëtuara nga Bashkia Pukë.**

-Paketa fiskale për vitin 2023 është miratuar me VKB nr. 56, datë 30.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr.43/1 prot., datë 19.01.2023.

-Mbështetur në paketën fiskale të mësipërme në Bashkinë Pukë, sipas sektorëve përkatës, në mënyrë të përmbledhur janë aplikuar/mbledhur rreth 38 lloje taksash dhe tarifash.

Për vitin 2023 subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Pukë dhe NJA, ndahen në 4 kategori:

**1.Biznes;**

**2.Ambulant;**

**3.Familjar;**

**4.Institucione.**

Kategoritë e mësipërme (përfshijtur institucionet) ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:

-Kategoria e parë ndahet në Biznes i Madh dhe Biznes i Vogël.

-Kategoria e tretë për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Llojet e subjekteve mbi të cilët janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore, si dhe numri i tyre.

Nr	Lloji	2023
1	Biznesi i Madh	45
2	Biznesi i Vogël	150
3	Ambulant (Hapësirat e tregut)	20
4	Institucione	24
	<b>Total</b>	<b>239</b>

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar planit vjetor të miratuar dhe akt rakordimeve me Degën e Thesarit Pukë parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Pukë për vitin 2023 paraqitet në mënyrë analitike si më poshtë:

000/lekë

Emërtimi	Viti 2023			
	Plan	Fakt	%	Diferenca
<b>Të Ardhura nga Burimet e Veta</b>				
<b>Të Ardhura nga Taksat Lokale</b>	<b>6,376</b>	<b>3,591</b>	<b>56%</b>	2,785
Taksa vendore mbi biznesin e vogël	0	28		(28)
Taksa mbi ndërtesën	3,384	1,663	49%	1,721
Taksa mbi tokën bujqësore	124	122	98%	2
Taksa mbi truallin	797	472	59%	325
Taksa vendore në shërbimin hotelier	322	0	0%	322
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	1,045	705	67%	340
Taksa e tabelës	704	601	85%	103
<b>Të Ardhurat nga Taksat e Ndara</b>	<b>7,840</b>	<b>10,197</b>	<b>130%</b>	<b>(2,357)</b>
Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme	65	61	94%	4
Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	4,200	5,823	139%	(1,623)
Taksa e rentës minerare	0	4		(4)
Taksa mbi të ardhurat personale	2,955	4,211	143%	(1,256)
Taksa të tjera (Reklama)	620	98	16%	522
<b>Të Ardhurat nga Tarifat Vendore</b>	<b>22,305</b>	<b>9,207</b>	<b>41%</b>	<b>13,098</b>
<b>Tarifa me menaxhimin të mbetjeve</b>				0
Tarifa e pastrimit për familjet	1,700	1,700	100%	0
Tarifa e pastrimit për institucionet	1,571	1,571	100%	0
Tarifa e pastrimit për biznesin	4,680	2,175	46%	2,505
<b>Tarifa për ndriçimin publik</b>				0
Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	306	306	100%	0
Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	450	450	100%	0
Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	500	246	49%	254
<b>Tarifa për gjelbërimin</b>				0

Tarifa për gjelbërimin nga familjet	100	50	50%	50
Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	48	48	100%	0
Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	136	51	38%	85
<b>Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë</b>				0
Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	40	0	0%	40
Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	150	57	38%	93
Tarifa e liçensimit të veprimtarive të transportit	130	119	92%	11
Tarifa e parkimit për mjetet e liçensuara dhe vendparkime publike	233	123	53%	110
Tarifa për pyejt dhe kullotat (Lende drusore)	8,750	104	1%	8,646
Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksja	72	10	14%	62
Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave	534	76	14%	458
Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	77	77	100%	0
<b>Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj</b>				0
Mensa (Konviktet)	115	177	154%	(62)
Kopshtet	505	587	116%	(82)
Çerdhet	253	388	153%	(135)
<b>Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime</b>	54	20	37%	34
Tarifa të tjera	1,901	872	46%	1,029
<b>Të Ardhurat e Tjera</b>	<b>9,861</b>	<b>6,195</b>	<b>63</b>	<b>3,666</b>
Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	2,711	5,765	213%	(3,054)
Kthimi nga investimet kapitale	3,816	0	0%	3,816
Shitja e mallrave dhe shërbimeve	100	0	0%	100
Kundravajtjet administrative (Gjjobat)	203	410	202%	(207)
Sekuestrime dhe Zhdëmtime	100	10	10%	90
Të tjera (Pulla)	2,931	10	0%	2,921
<b>TOTALI</b>	<b>46,382</b>	<b>29,190</b>	<b>63%</b>	<b>17,192</b>

*Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Për vitin 2023 të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën **46,382 mijë** lekë dhe janë realizuar në vlerën **29,190 mijë** lekë, ose 63% rreth 17,192 mijë lekë më pak nga plani.

Në krahasim me vitin 2022 kemi ulje të të ardhurave të arkëtuara me 5,429 mijë lekë më pak, ose 19% më pak.

-Për vitin 2023 peshën kryesore të të ardhurave e zënë të ardhurat nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura me 5,823 mijë lekë, ose 20% ndaj totalit të të ardhurave të realizuara, duke vijuar me të ardhurat nga qiraja e asetëve në pronësi të bashkisë në vlerën 5,765 mijë lekë, ose 20% ndaj totalit, taksa mbi të ardhurat personale në vlerën 4,211 mijë lekë, ose 14.5% ndaj totalit, tarifa e pastrimit për biznesin në vlerën 2,175 mijë lekë, ose 7.5%.

-Në tabelën e mësipërme vihet re për disa lloje taksash dhe tarifash të cilat nuk bëhet planifikimi i saktë niveli i arkëtimit, konkretisht për planifikimin e të ardhurave nga kthimi nga investimet kapitale është planifikuar në vlerën 3,816 mijë lekë dhe realizimi është 0 lekë, gjithashtu tarifa për pyjet dhe kullotat (Lëndë Drusore) kjo tarifë parashikohet në shumën 8,750 mijë lekë dhe realizimi është në vlerën 104 mijë lekë, taksa e pullës parashikohet në vlerën 2,931 lekë dhe realizimi është në vlerën 10 mijë lekë.

*Me tejkallim paraqiten zërat, si:*

Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura është planifikuar në vlerën 4,200 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 5,823 mijë lekë ose realizuar në masën 139%.

Taksa mbi të ardhurat personale është planifikuar në vlerën 2,955 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 4,211 mijë lekë ose realizuar në masën 143%.

Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë është planifikuar në vlerën 2,711 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 5,765 mijë lekë ose realizuar në masën 213%.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkallim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke mos pasqyruar sakt burimin e të ardhurave.



Nga Sektori i Tatim Taksave nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga ky Sektor nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2023 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Pukë që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjat “a” dhe “e” të nenit 5 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e njësive të vetëqeverisjes vendore”.

### **III. Detyrimet e palëve të treta ndaj Bashkisë Pukë sipas kategorive të tyre.**

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur ecuria e debitorëve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, si dhe trashëguar nga vitet e mëparshme.

Në fund të vitit 2022 (progresive)	Nr	Vlerë	Principal	Kamat-Vonesë	Gjobat e aplikuar
		<b>27,047,859</b>	<b>25,717,040</b>	<b>1,330,819</b>	
Biznesi i Madh	12	8,838,832	7,887,439	951,393	
Biznesi i Vogël	80	4,349,128	3,969,702	379,426	
Tarifa e licencimit për karburantet	3	2,200,000	2,200,000	0	
Tregëtar Ambulant	1	44,784	44,784	0	
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	1857	557,194	557,194	0	
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	13	1,451,532	1,451,532	0	
Taksa e tokës bujqësore	<b>ne proces evidencimi</b>	2,746,417	2,746,417	0	
Gjobat e Policisë Bashkiake	16	90,000	90,000		
Qira fond pyjor dhe kullor	0	6,769,972	6,769,972	0	
<b>Krijuar brenda vitit 2023</b>	<b>Nr</b>	<b>Vlerë</b>	<b>Principal</b>	<b>Kamat-Vonesë</b>	<b>Gjobat e aplikuar</b>
		<b>1,230,681</b>	<b>1,230,681</b>		
Biznesi i Madh	8	760,601	760,601	0	
Biznesi i Vogël	9	213,126	213,126	0	
Tarifa e licencimit për karburantet	0	0	0	0	
Tregëtar Ambulant	0	0	0	0	
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	870	244,954	244,954	0	
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	0	0	0	0	
Taksa e tokës bujqësore	0			0	
Gjopa të Policisë Bashkiake	12	12,000	12,000	0	
Qira fond pyjor dhe kullor	0			0	
<b>Në fund të vitit 2022 (progresive)</b>	<b>Nr</b>	<b>Vlerë</b>	<b>Principal</b>	<b>Kamat-Vonesë</b>	<b>Gjobat e aplikuar</b>
Biznesi i Madh	20	9,599,433	8,648,040	951,393	
Biznesi i Vogël	89	4,562,254	4,182,828	379,426	
Tarifa e licencimit për karburantet	2	2,200,000	2,200,000		
Tregëtar Ambulant	1	44,784	44,784		
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	2655	802,148	802,148		
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	12	1,451,532	1,451,532		
Taksa e tokës bujqësore		2,746,417	2,746,417		
Gjopa të Policisë Bashkiake	28	102,000	102,000		
Qira fond pyjor dhe kullor	7	6,240,200	6,240,200		
<b>Total</b>		<b>27,748,768</b>	<b>26,417,949</b>	<b>1,330,819</b>	

*Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Nga tabela e mësipërme rezulton se:

-Vlera e detyrimeve në fund të vitit 2023 është **27,748,768 lekë** për taksat dhe tarifat vendore, qiratë, gjobat, kamatëvonesa etj., nga të cilat detyrime janë 26,417,949 lekë dhe kamat-vonesa janë 1,330,819 lekë. Në krahasim me fundin e vitit 2022, në fund të vitit 2023 kemi rritje të vlerës debitore me 1,230,681 lekë ose 4.4%.

Situata e mësipërme tregon për një punë të pamjaftueshme të Bashkisë Pukë në arkëtimin e të drejtave të saj ndaj palëve të treta.

Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Tatim Taksave, vlera totale borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Pukë paraqitet:

1. Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 802,148 lekë.
2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë 1,451,532 lekë.
3. Biznese Debitore në vlerë 14,206,471 lekë.
4. Taksa e tokës Bujqësore 2,746,417 lekë.

Nga auditimi konstatohet se, në fund të vitit 2023 borxhi tatimor është në vlerën **19,203,568 lekë** të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pukë.

### **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Pukë kryhet në programin Excel. Sektori i Tatim Taksave nuk kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Pukë i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Sektorit të Tatim Taksave.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Sektorit të Tatim Taksave për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të Sektorit të Tatim Taksave.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për vitin 2023, paraqiten si më poshtë:

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja në fund të periudhës 2023
1	Biznes i vogël	2023	150	0	0	150
2	Biznes i madh	2023	42	3	0	45
<b>TOTAL</b>			<b>192</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>195</b>

*Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

### **III.1. Kategoria “Biznes”.**

Debitorët “Biznes” të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore, si dhe mosmarrja e masave ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e detyrimeve përkatëse.

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Sektori i Tatim Taksave, rezulton se në fillim të vitit 2023 kanë qenë debitor 92 subjekte të kategorisë “Biznes”, në vlerën 13,232,744 lekë.

-Në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive rezultojnë debitor 110 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën **14,206,471 lekë**, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë.

-Në fund të vitit 2023 në krahasim me fillimin e vitit 2023, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë “Biznes” ka ardhur në rritje.

-Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes) nga sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, nuk janë bërë përpjekje duke aplikuar masa shtrënguese për të gjithë subjektet (deri në vendosjen e barrës siguruese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), nuk është vazhduar me masa shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 76, neni 114 dhe neni 117 i Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Pikat 1, 2 dhe 7 në nenin 4, neni 22/5, nenin 26, neni 34 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;

Neni 64 në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

### **Taksa e fjetjes në hotel.**

Për vitin 2023 taksa e fjetjes në hotel paraqitet me realizim në vlerën 0 lekë. Nga Sektori i Tatim Taksave nuk është bërë planifikimi dhe realizimi i saktë i taksës së fjetjes në hotele.

Nga auditimi u konstatua se, aplikimi i tarifës është llogaritur në bazë të strukturave dhe kapaciteteve akomoduese në territorin e Bashkisë Pukë, strukturat akomoduese taksohen në bazë vjetore, këto veprime janë në kundërshtim me Tab.4 në paketën fiskale të vitit 2023.

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të kësaj takse rezulton se Sektori i Tatim Taksave ka të regjistruar 1 hotel, si dhe për vitin 2023 janë arkëtuar 0 lekë dhe në fund të periudhës progresive është në vlerën **92,085 lekë**, veprime të cilat çojnë në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pukë, pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

000/lekë

Subjekti	NIPT	Adresa	Nr dhomash	Faturuar për taksë e fjetjes në hotel	Arkëtuar 2023	Diferenca 31.12.2023
B 1900 HTP Shpk	K.....M	Pukë	30	92,085		92,085
<b>Total</b>				<b>92,085</b>		<b>92,085</b>

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për periudhën objekt auditimi specialistët e Sektorit të Tatim Taksave nuk kanë kryer verifikime në terren për të identifikuar dhe më pas regjistruar njësi të tjera akomoduese. Gjithashtu, nga ana e Sektorit të Tatim Taksave nuk janë bërë përpjekje as për të verifikuar nëpërmjet faqeve të internetit për rezervime online të hoteleve si një mënyrë për të kontrolluar nëse ka hotele apo njësi të tjera akomoduese që japin dhoma me qira dhe nuk janë të regjistruara për t’i paguar bashkisë taksën e fjetjes në hotel sipas përcaktimeve të VKB për miratimin e taksave dhe tarifave vendore.

### **Debitor nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake.**

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake Pukë, është në vlerën 102,000 lekë nga të cilat në vitin 2023 janë 12 gjoba në vlerën 12,000 lekë dhe 16 gjoba në vlerën 90,000 lekë deri në fund të vitit 2022. Pasqyruar në tabelën përmbledhëse<sup>6</sup> si më poshtë:

#### Gjobat e Policisë Bashkiake Pukë

Debitor deri në 2023	Subjekte	Principal	Kamatvonesë	Paguar	Vlerë
<b>Gjithësej progressive 31.12.2023</b>	<b>28</b>	<b>102,000</b>			<b>102,000</b>
Nga të cilat në 2023	12	12,000			12,000
Nga të cilat progresive deri në 2022	16	90,000			90,000

Burimi: Sektori i Tatim Taksave, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

<sup>6</sup> Tabela analitike bashkëlidhur akt-konstatimit.

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2023 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të pa arkëtuara në vlerën **102,000 lekë**.

Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse<sup>7</sup> si dhe nuk janë aplikuar kamatvonesat për të gjitha gjobat e vendosura. Nuk rezulton në asnjë rast të jetë bërë kërkesë për titull ekzekutiv ashtu sikurse përcaktohet në pikën 10 të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “për kundravajtjet administrative” *Gjobat analitike janë të pasqyruar në Kapitullin aneke.- Tab. nr.3, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

### III.2 Familjet.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Pukë dhe NJA, për vitin 2023 janë taksuar 3310 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”. Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen për çdo NJA, pasqyrohen si më poshtë:

NJA	Familje të taksuara	Familje sipas Gj.Civile
Puke	867	3155
Qelez		
Rrapë	115	
Gjegjan	520	1257
Qerret	282	931
<b>Total</b>	<b>1784</b>	<b>5343</b>

*Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

- Situata e mësipërme tregon se Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Në këtë drejtim kërkohet më tepër përkushtim nga Bashkia Pukë duke ngritur grup pune, për evidentimin e saktë dhe të plotë të familjeve që jetojnë në Bashkinë Pukë dhe NJA.

-Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezulton se për arkëtimin e taksave të familjeve të qytetit Pukë, është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me U-K Sh.A Pukë nr.1994 prot., datë 25.10.2017, i cili vepron si agent tatimor për llogari të Bashkisë Pukë. Përfshirë familjet e qytetit, në NJA taksimi dhe tarifimi i familjeve bëhet fizikisht, pra lëshohet faturë kur familjari paraqitet pranë zyrave të bashkisë për të përfituar shërbim, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Tab. 13 në Paketën Fiskale të Bashkisë Pukë.

-Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Pukë dhe NJA, rezulton se në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive janë 2655 familje debitorë për vlerën 802,148 lekë, nga të cilat, në vitin 2023 janë krijuar 870 familje debitorë për vlerën 244,954 lekë.

-Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për tarifën e ndriçimit, pastrimit dhe taksën e ndërtesës.

<sup>7</sup> Mbështetur në nenin 13 të Ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar, “Për shkeljet e vërejtura punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës kanë të drejtë të gjobitin në vend personat përgjegjës në masën 500 deri në 5000 lekë. Kundërvajtësit janë të detyruar të paguajnë gjobën brenda 5 ditëve nga data e dhënies. Për çdo ditë vonesë gjoba paguhet me kamatë 2 për qind. Me kalimin e afatit njëmuor, gjoba vilet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin "Për kundërvajtjet administrative"; duke vijuar me përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Numër familje debitore sipas NJA, të cilat rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa

Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	Në fund të vitit 2022 (progresive)		Krijuar brenda vitit 2023		Në fund të vitit 2023 (progresive)	
	Nr	Vlerë				
	1857	557,194	870	244,954	2655	802,148

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 1.857 familje debitore për vlerën 557,194 lekë dhe në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive janë 2.655 familje debitore për vlerën 802,148 lekë, nga të cilat, në vitin 2023 është krijuar 244,954 lekë debi. Pra në krahasim me vitin 2022, në fund të vitit 2023 kemi rritje të vlerës debitore për taksat dhe tarifatat për kategorinë “familje”, ç’ka tregon për performancë të dobët të Bashkisë Pukë në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme.

-Sa i përket familjeve debitore, rezulton se nuk janë marrë masa ligjore (njoftimin e vlerësimit të detyrimit tatimor, bllokimin e llogarive bankare, etj) për arkëtimin e vlerës debitore.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Kreu III në Udhëzimin nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”.

### Taksa e tokës bujqësore

Nga të dhënat e pasqyrës, kjo taksë është realizuar në masën 98% ose nga vlera e planifikuar prej 124 mijë lekë është arkëtuar vlera 122 mijë lekë.

Sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga Sektori i Tatim Taksave, Bashkia Pukë rezulton se numri i familjeve të trajtuara me tokë është 5.413 fermerë me një sipërfaqe të përgjithshme prej 954 Ha, sipërfaqe e ndarë me AMTP. Kjo sipërfaqe duhet të shërbejë për Bashkinë Pukë për planifikimin e taksës së tokës bujqësore. Ndarja e tokës bujqësore me AMTP, sipas Njësisë Administrative të Bashkisë Pukë, pasqyrohet si më poshtë:

Njesite Administrative	Nr. i fshatrave për çdo njësi	Sipërfaqja e tokës së ndarë në (Ha)	Nr. i familjevetë trajtuara me tokë sipas ligjit 7501
Puka	2	52	254
Gjegjan	10	300	1,846
Rrape	10	251	1,388
Qerret	9	163	883
Qelez	10	188	1,042
<b>SHUMA</b>	<b>41</b>	<b>954</b>	<b>5,413</b>

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Planifikimi i taksës së tokës është bërë në bazë të dhënash për bazën e taksueshme të sipërfaqes së tokave bujqësore në disponim të familjeve fermere, informacion i cili i dërgohet nga NJA Sektorit të Tatim Taksave në fazën e përgatitjes së buxhetit. Këto të dhëna nuk janë të sakta, edhe për faktin se ka mosrakordim të dhënash në mes të dhënave të NJA dhe të dhënave që disponon Sektori i Tatim Taksave. Planifikimi i të ardhurave sipas Bashkisë Pukë për vitin 2023 i taksës së tokës bujqësore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

### Planifikimi i taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Pukë

Kategoria e tokës	Sip/HA Nj.A. Puke	Sip/HA Nj.A. Gjegjan	Sip/HA Nj.A. Qerret	Sip/HA Nj.A. Rrape	Sip/HA Nj.A. Qelëz	Sip/HA NjA.	Vlera/Ha	Plani/Lekë
Kategoria V								
Kategoria VI								
<b>Kategoria VII-X</b>	<b>29</b>	<b>109</b>	<b>43</b>	<b>22</b>	<b>40</b>	243	500	<b>121,500</b>
Kategoria VIII								
<b>Totali sip. Ha sipas planifikimit familjet rezidente</b>	<b>29</b>	<b>109</b>	<b>43</b>	<b>22</b>	<b>40</b>	<b>243</b>	<b>500</b>	<b>121,500</b>

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në lidhje me planifikimin dhe realizimin e taksës së tokës rezulton se: Nga Njësitë Administrative disponohen regjistrat e tokës me të dhënat e sipërfaqeve dhe cilësisë së tokave (kategorizimi), si dhe marrëdhëniet juridike më të, pra statusi i pronësisë për të gjitha familjet fermere. Mbi bazën e këtyre regjistrave të hartuar në vitet e mëparshme nga të dhënat e marra nga sektori i Bujqësisë nga specialistët e taksave ngarkoheshin familjet fermerë me taksën e tokës sipas kategorisë dhe nivelin e taksës përkatëse të përcaktuar në paketën fiskale. Në Njësitë Administrative Gjegjan, Rrapë, Qerret dhe Qelëz, vjelja e detyrimeve për taksën e tokës bëhet atëherë kurë subjekti/individ i paraqitet pranë njësisë/ve për marrjen e shërbimit dhe kryen pagesën përkatëse. Duhet theksuar se nuk kishte një përditësim të këtyre regjistrave në 10 vitet e fundit, gjë që është e domosdoshme për të patur të dhëna të sakta për bazën e taksueshme.

Situata e mësipërme tregon gjithashtu se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

### **Të ardhurat dhe vlerat debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale, objekt legalizimi.**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Sektori i Urbanistikës dhe Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë në lidhje me realizimin e të ardhurave të bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga Drejtoria Vendore e ASHK Shkodër, u auditua dokumentacioni për periudhën e vitit 2023, i paraqitur nga Sektori i Urbanistikës Bashkia Pukë. Nga DVASHK Shkodër, janë dërguar dokumentet për çdo person që është pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale, me qëllim përlllogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI).

Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Sektori i Urbanistikës nuk është zbatuar pika 5 në paketën fiskale të Bashkisë Pukë për vitin 2023, pasi për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga subjektet e pajisur me leje legalizimi përgjatë vitit 2023, nuk janë marrë masa për njoftimin e tyre me qëllim kryerjen e pagesës përkatëse. Veç sa më sipër ku nuk janë marrë masa në mënyrë shteruese për arkëtimin e TNI, konstatohet edhe për sa i përket arkëtimin të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për debitorët e rezultuar deri në datë 31.12.2023, për të cilët administrohet vetëm njoftimi për arkëtim. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Sektorit të Urbanistikës dhe Sektorit të Tatim Taksave Bashkia Pukë, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së TNI, të ndjekin procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale.

Në vijim paraqitet në mënyrë të përmbledhur pasqyra e personave të cilët janë pajisur me leje legalizimi, si dhe vlera debitore progresive dhe e ndarë sipas viteve.

Tabela analitike për TNI për legalizimin e objekteve informale

Nr.	Emër	Mbiemri	Data	Lloji i objektit banim/social ekonomike	Sip. totale e ndërtimit (m <sup>2</sup> )	% që aplikohet	Shuma që duhet të arkëtohet (lekë)	Faturuar		Paguar 2023	Debia 31.12.2023
								Po	Jo		
1	B Sha										1,138,425
2	N	L									24,821
3	R	S	3634/22.07.2019	Banim	337.3	0.5%	55,436	Po			55,436
4	M	M	2423/02.05.2019	Banim	321.6	0.5%	52,855	Po			52,855
5	I	A	2423/02.05.2019	Banim	155.2	0.5%	25,507	Po		25,507	
6	R	M	3634/22.07.2019	Banim	83.03	0.5%	13,690	Po			13,690
7	N	H	3634/22.07.2019	Banim	59.3	0.5%	9,746	Po			9,746
8	Gj	F	3634/22.07.2019	Banim	158.2	0.5%	26,000	Po			26,000
9	M	Frr	11114/16.12.2019	Banim	121.7	0.5%	20,001	Po			20,001
10	N	M	584/21.01.2020	Banim	106.7	0.5%	17,536	Po			17,536
11	Gj	C	3427/12.03.2020	Banim	60.5	0.5%	9,943	Po			9,943
12	K	N	10619/10.10.2022	Banim	272.9	0.5%	44,851	Po			44,851

13	L	N	10619/10.10.2022	Banim	77.4	0.5%	12,721	Po		12,721
14	Frr	Gj	258/04.05.23	Banim	30.4	0.5%	4,996	Po	4,996	
15	M	K	258/04.05.23	Banim	30.5	0.5%	4,996	Po	4,996	
16	Xh	B	705/18.05.23	Banim	348.0	0.5%	57,194	Po	57,194	
17	Xh	B	705/18.05.23	Banim	34.0	0.5%	5,588	Po	5,588	
18	Xh	B	705/18.05.23	Banim	82.0	0.5%	13,477	Po	13,477	
19	Z	F	705/18.05.23	Banim	175.8	0.5%	28,893	Po	28,893	
<b>TOTALI</b>					<b>3426.13</b>		<b>403,430</b>		<b>140,651</b>	<b>1,426,025</b>

Burimi: Sektori i Urbanistikës Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Bazuar në të dhënat e marra u konstatua se, nuk janë marrë masa për vjeljen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje ndërtimi, të pajisura me leje legalizimi konkretisht:

Vlera debitore progresive për periudhën deri në fund të vitit 2023 (nga viti 2019) – vlera debitore është **1,426,025 lekë**, e cila përfaqëson të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë. Në numër personash të cilët posedojnë lejen e legalizimit dhe që nuk kanë shlyer detyrimin e taksës vendore të ndikimit në infrastrukturë është 10 posedues.

Për arkëtimin e vlerës debitore krijuar si rrjedhojë e mos likuidimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve informale, nuk janë marrë masat shtrënguese në mënyrë shteruese, si dhe ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Sektorit të Urbanistikës dhe Sektorit të Tatim Taksave Bashkia Pukë, për shkëmbimin e informacionit si dhe ndjekjen e procedurave ligjore, për arkëtimin e TNI.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27; Ligji nr. 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar”, neni 9, pika 3/c; Ligji nr. 98/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar”, neni 1, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5; etj.

### **Menaxhimi borxhit nga taksat e tarifave vendore. Auditimi i rasteve në lidhje me zbatimin e masave shtrënguese për arkëtimin e borxhit ndaj subjekteve debitorë.**

Duke vlerësuar riskun e praktikave të menaxhimit të borxhit u përzgjedhën disa raste për auditimin e procedurave që janë kryer, për ndjekjen dhe procedurat e arkëtimin të borxhit në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, me ndryshime, nga ku rezultoi se:

Për vitin 2023 nuk janë ndjekur procedura të masave shtrënguese për uljen e borxhit tatimor përveç njoftimeve për likuidimin e detyrimeve tatimore. Të gjitha praktikat e paraqitura mungojnë procedurat e ndjekura për mbledhjen e detyrimeve të papaguara, por janë mjaftuar vetëm me njoftimet e subjekteve apo individëve, ku edhe ato janë të pjesshme.

- Për 13 subjekte, të identifikuar si debitorë në vlerën 8,943,583 lekë nuk janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore për likuidimin e detyrimeve Tatimore.

<b>BIZNESI MADH</b>				
1	"B 1900 HTP" shpk	Hotel	K.....M	2,123,351
2	"B" shpk	Sherbime ndertimi	J.....K	3,609,601
3	"V A" shpk	Prodhime maskash	K.....L	310,969
4	"A Sh" shpk	Konfeksione	L.....R	1,065,672
5	NN (V shpk)	Sherbime	J.....C	247,934
6	"F I" shpk	Farmacit	L.....R	40,500
7	"C Sh" shpk	Prodhime kepucesh	M.....C	83,775
8	"H" shpk	Ndertim	M.....C	62,440
9	"E 2000" shpk	Sherbime	K.....D	40,100
10	"S" shpk	Karburant	F.....K	150,420
11	"E - L" shpk	Sherbime	J.....I	693,594
12	"B" sha K 2	Prodhime	K.....A	14,396
13	Gj K	Sherbime	L.....E	500,831
<b>Total vlera debitore deri 31.12.2023</b>				<b>8,943,583</b>

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nuk ka asnjë urdhër ekzekutiv të mbledhjes me forcë të detyrimeve në bashkëpunim me institucionet e tjera për të minimizuar subjektet dhe familjet që nuk likuidojnë detyrimet.

-Nga dosjet e zgjedhura për auditim, nuk gjen zbatim ndryshimi ligjor i nenit 89 i ligjit të procedurave tatimore, ku thuhet se; *“Në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit”*.

Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitore strukturat e Sektorit të Tatim Taksave Bashkia Pukë, nuk ka ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë, duke vepruar në mospërputhje ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, nenet 86-92 Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93 dhe 94.

Gjithashtu nga Sektori i Tatim Taksave për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar kallëzim penal bazuar në nenin 181-Mos pagimi i taksave dhe tatimeve, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”.

### **Agjentët tatimorë**

Në rregulloren e brendshme të institucionit miratuar me Vendimin nr.247, datë 30.12.2015, nuk është përfshirë personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve me agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt rakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me rentën minerare, ASHK në lidhje me taksën e ndikimit në ifrastrukturë dhe DRSHTRR Shkodër në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht për llogari të Bashkisë Pukë dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Pukë.

Nga të dhënat e paraqitura nga Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Pukë, konstatohet se për periudhën objekt auditimi nuk janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj dhe vjetorë, nuk evidentohet se sa është numri i personave që duhet të paguajnë detyrimin, sa nga këto persona plotësojnë kriteret për pagesa, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe nëse vlera e arkëtuar nga agjentët tatimorë janë likuiduar në afat apo jo, kjo për ASHK (nga shitja e pasurisë), Drejtoria e Transportit (për mjetet qarkullues), Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër (tatim fitim thjeshtuar) dhe U K Sha Pukë (abonentët familjarë), Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave (renta minerare) Bashkia Pukë nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Në qoftë se krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm. Për sa më sipër, Bashkia Pukë nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Pukë, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjatëmbajtjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 117, ku përcaktohet që “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008,



“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 7, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”.

Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Pukë. Është e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me agjentin tatimor por ka një shumë të madhe debitorësh e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Pukë, për vitin 2023

		<i>000/lekë</i>
<b>Agjenti Tatimor</b>	<b>Lloji i Taksës</b>	<b>2023</b>
Drejtoria rajonale e tatimeve	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	4,211
D.R.SH.T Rrugor	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	5,823
Z.V.R.P.P (AKSH)	Taksa e kalimit të pronësisë	61
DPT & DPD	Renta Minerare	4
Ujësjetllës-Kanalizime	Taksë ndërtese	419
	Tarifë shërbimi	1,526
<b>TOTALI</b>		<b>12,044</b>

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të ulët realizimi.

Bashkia Pukë nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm.

#### **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Pukë mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

-Ligj Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar

-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017;

-VKM nr.212, datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”

-VKB për miratimin e paketës fiskale;

-Dosjet e licencimit të subjekteve, me përmbajtje: Licenca e dhënë për ushtrim aktiviteti, Ekstrakti i regjistrimit në QKB (në të cilin pasqyrohet lloji aktivitetit dhe vendet e ushtrimit të aktivitetit nga subjekti në Bashkinë Pukë dhe NJA, që korrespondon me periudhën 01.01.2023-31.12.2023), Akti teknik i lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial; Leje mjedisore për ushtrim aktiviteti, Raporti teknik i lëshuar nga shërbimi i zjarrëfikses, Projekti teknik i vendit ku do të ushtrohet aktiviteti, vendosja e depozitave, Autorizimet për pagesë, Faturat e arkëtimit dhe pagesa e kryer nga subjekti;

-Paketa Fiskale e vitit 2023 dhe Rregullore e brendshme e Bashkisë Pukë.

-Referuar të dhënave nga databasat e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial, (institucioni që inspekton subjektet e tregtimit të karburanteve).

Subjektet për të cilat administrohet dosje fizike dhe që kanë ushtruar aktivitet në vitin 2023 në Bashkinë Pukë.

Nr.	Subjekti	Adresa	Nipti	Pajisur me Licencë		Licenc		Tarifa e aplikuar nga Bashkia	Pagesa e kryer	Vlera e detyrimit
				Po	Jo	Fillon	Mbaron			
1	"K" shpk	Pukë	J.....P	Po	x	25.02.2019	24.02.2024	1,000,000	1,000,000	0
2	"S. G" shpk	Pukë	K.....V	Po	x	05.04.2022	05.04.2027	1,000,000	1,000,000	0

Burimi: Sektori i Tatim Taksave, Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sipas të dhënave të paraqitura nga Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Pukë, për vitin 2023 ushtrojnë këtë aktivitet 2 subjekte. Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2023 subjektet kanë paguar detyrimet për vitin fiskal, ndërkohë rezultojnë debitorë për vlerën 2,200,000 lekë për periudhën deri në fund të vitit 2021. Konkretisht subjektet janë:

1. "K" shpk me adresë Pukë, subjekt i cili është i pajisur me autorizim 5 vjeçar me nr.1, datë 25.02.2019 për tregtim me pakicë të karburanteve dhe gazit të lëngshëm të cilit i mbaron afati në datë 24.02.2024.
2. "S. G" shpk me adresë Pukë, subjekt i cili është i pajisur me autorizim 5 vjeçar me nr.1, datë 05.04.2022 për tregtim me pakicë të karburanteve dhe gazit të lëngshëm të cilit i mbaron afati në datë 05.04.2027.

### **Përdorimi i të ardhurave.**

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2023 është realizuar përkatësisht në vlerën 27,574 mijë lekë, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga.

#### Përdorimi i të ardhurave – viti 2023

Art.	Emertimi	Te ardhurat e veta
600	Paga	11,781
601	Sigurime Shoqërore	771
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,808
604	Trans. Institucioneve	4,345
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0
231	Kapitale të Trupëzuara	6,869
	<b>Total</b>	<b>27,574</b>

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

*Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. N. A, Përgjegjësi i Sektorit të Tatim Taksave, znj. F. L, z. G. Ll, z. Gj. M, z. R. N, z. S. E, znj. E. F, z. L. P dhe znj. S. M agjent tatimor pranë NJA-ve.*

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

## **2.2. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

**2.2.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.**

**2.2.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.**

**2.2.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe magazinës.**

**2.2.4. Verifikimi i inventareve të Aktiveve Afatgjata Materiale sa prej tyre janë me çertifikatë pronësie.**

### **➤ Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:**

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe

kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

➤ **Hartimi i pasqyrave financiare:**

Për vitin 2023 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

**Oasja dhe metodologjia e auditimit.**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2023 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit **9,600 mijë lekë** për shpenzimet, sipas **Pasqyrës** më poshtë:

**Pasqyra PF: Materialiteti për Bashkinë Pukë 2023**

000/Lekë

Emërtimi i Shpenzimeve 2023	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	178,008,627	0.70	13
Sigurime Shoqërore (601)	26,464,613	0.70	2
Mallra e Shërbime (602)	36,608,864	0.70	3
Investime të brend. (230-231)	244,905,059	2.00	51
Te tjera transfer. korrente (606)	106,637,970	0.70	8
<b>Total</b>	<b>592,625,133</b>		
Materialiteti në %	2%		
<b>Materialiteti në vlerë</b>	<b>11,852,503</b>		
Kalkulimi i precizionit			
<b>Materialiteti</b>	<b>11,852,503</b>		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	1,185,250		
<b>Nëntotali</b>	<b>10,667,252</b>		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
<b>Vlera e precizionit</b>	<b>9,600,527</b>		

**Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:**

Pasqyrat financiare të Bashkisë Pukë për vitin 2023 janë të nënshkruara nga z. Rr. D me detyrë Kryetar i Bashkisë Pukë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. F. L me detyrë Drejtor i Financës (hartuesi i llogarive vjetore) në cilësinë e nëpunësit zbatues të cilat janë depozituar pranë Degës së Thesarit Pukë me shkresën nr. 710 prot., datë 26.03.2024, brenda afatit ligjor të cilat janë konfirmuar më datë 29.03.2024.

### **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:**

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

### **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:**

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditaret kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

### **-Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Nga auditimi rezultoi që mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike, në Bashkinë Pukë, mbahet me sistem Financa-5. Sektori i financës në Bashkia Pukë, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me "Bartës informatik", të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.

-Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues nuk është bërë në mënyrë të plotë, pasi nuk përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

-Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njesisë ekonomike.

**Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:**

**Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e **Pasqyrave Financiare të Bashkisë Pukë** për aktivitetin ekonomiko-financiare për periudhën 01.01.2023, deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekset pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike. Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të Degës së Thesarit Pukë për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin e pasqyrës së lëvizjes në Cash viti 2023.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2023, të pozicionit financiar të Bashkisë Pukë (pasqyrat financiare), Formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

		<i>000/Lekë</i>
<b>Aktivitet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivitet Neto</b>		<b>1,897,910,533</b>
Aktivitet		2,082,843,163
Pasivet		-184,932,630
Aktivitet Neto		1,897,910,533

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

		<i>000/Lekë</i>
<b>Aktivitet Afatshkurtra më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën</b>		<b>355,732,242</b>
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”		116,948,982
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”		16,252,267
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”		222,530,993

## A. AKTIVET

### I. Aktivet Afat Shkurtra

#### 1. Llogaritë e Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

##### PF.1

		<i>000/Lekë</i>		
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
531	Mjete monetare në arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	9,042,382	12,575,881	-3,533,499
520	Disponibilitete në thesar	106,454,640	59,178,543	+47,276,097
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	1,451,960	1,312,620	+139,340
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizione zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>116,948,982</b>	<b>73,067,044</b>	<b>43,881,938</b>

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 106,454,640 lekë përbëhet nga gjendja e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 92,128,322 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 14,326,318 lekë. Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Në pasqyrën e mëposhtme paraqiten më hollësisht lëvizjet e llogarisë 520.

##### PF.2

Llogaria 520 në vitin 2023	Vlera /Lekë
<b>I.Të trashëguara nga viti 2022</b>	
Sipas aktit t ërakordimit për shumën. Nga të cilat:	

Granti i trashëguar	6,935,947
Të ardhura të trashëguara	1,975,937
Mjete në ruajtje e të trashëguara ( llog. 466)	
Fonde specifike	7,976,741
Jashte limiti	
<b>Totali</b>	<b>16,888,625</b>
<b>II.Tëhyrat (Shtesatdebitore) gjatë vitit 2023</b>	
Granti I vitit	140,943,000
Të ardhurat e vitit	46,832,000
Të hyra nga mjetet në ruajtje	
Grant ispecifik	143,626,118
Buxheti	221,766,906
FZHU	0
Jashte limiti	20,000,000
<b>Tot.</b>	<b>573,168,024</b>
<b>Totali I tëardhurave (I+II)</b>	<b>590,056,649</b>
<b>III.Lëvizjet kreditore të llogarisë 520</b>	
Pagasigurime (600+601)	206,306,000
Shpenzime operative (602)	37,060,000
Subvencione (603)	
Transferim ekorente të brendshme (604)	21,159,000
Transferime korente me jashtë (605)	
Transferime për buxhetet familjare dhe individë (606)	106,638,000
Kredia (BKT) + Interesapërhuamarje (651)	
Investime (231)	108,671,000
Të dala nga mjetet në ruajtje (466)	4,817,000
Transferime korente te brendshme + transfertabuxhetin e vet (404,696 +2,378,840)	-1,048,991
<b>Totali</b>	<b>483,602,009</b>
<b>Gjendja debitore (Saldi) (I+II) – III =</b>	<b>106,454,640</b>

## 2. Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

### PF.2

000/Lekë				
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
31	Materiale	4,105,867	4,049,128	+56,739
32	Inventar i imët	10,743,620	16,136,947	-5,393,327
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	1,402,780	1,547,018	-144,238
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>16,252,267</b>	<b>21,773,093</b>	<b>-5,480,826</b>

Llogaritë e Klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 16,252,267 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 4,105,867 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 10,743,620 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 5,480,826 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në PF në vlerën 5,480,826 lekë.

### **Procesi i inventarizimit:**

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Gjatë vitit 2023, me shkresën nr. 1002 prot., datë 30.05.2023, Kryetari i Bashkisë Pukë ka nxjerrë Urdhërin nr. 166 datë 30.05.2023, me objekt “Për ngritjen e grupit të punës për

asgjesimin e inventareve të evidentuar nga komisioni i verifikimit për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi të pasurisë së njësisë administrative Gjegjan, sipas proces verbaleve të mbajtura më datë 09.12.2022, është ngritur komisioni i përbërë nga znj. F. J kryetar dhe anëtarët, z. P. P, z. A. Gj dhe z. A. P. Në procesverbalin nr.1, nr.2, nr.3, nr.4 dhe nr.5, mbajtur në datë 30.05.2023, (Proces-Verbal) nga ana e anëtarëve të komisionit të asgjesimit i materialeve të institucioneve arsimore, kulturore dhe njësisë administrative kanë asgjesuar pajisje dhe materiale të dala jashtë përdorimit në vlerë 102,400 lekë.

Me shkresën nr. 1089 prot., datë 30.05.2023, Kryetari i Bashkisë Pukë ka nxjerrë Urdhërin nr. 178 datë 14.06.2023, me objekt “Për ngritjen e grupit të punës për asgjesimin e inventareve të evidentuar nga komisioni i verifikimit për aktivet e nxjerra jashtë përdorimi të pasurisë së njësisë administrative Rrape, sipas proces verbaleve të mbajtura më datë 09.12.2022, është ngritur komisioni i përbërë nga znj. L. M kryetar dhe anëtarët, znj. E. I, z. T. P, z. N. Ll dhe z. R. M të cillët janë ngarkuar për agjesimin e materialeve (inventar i imët ekonomik) të evidentuara jashtë përdorimit në Shkollën Prozhem. Në proces verbalet e mbajtura nga ana e anëtarëve të komisionit të asgjesimit i materialeve të institucioneve arsimore, kanë asgjesuar pajisje dhe materiale (inventar i imët ekonomik) të dala jashtë përdorimit në vlerë 58,968 lekë. *Komisioni ka hartuar relacion sqarues për inventarin fizik, së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit të nënshkruar nga secili punonjës që disponon aktive në ngarkim sipas kartelave përkatëse.*

### **Inventari i vitit 2023.**

Me shkresën nr. 2320 prot., datë 01.12.2023, Kryetari i Bashkisë Pukë ka nxjerrë Urdhërin nr. 616 datë 01.12.2023, me objekt “Për ngritjen e komisionit të punës për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të institucionit dhe njësisë vartëse.

Janë ngritur komisionet dhe janë përcaktuar dhe vendet ku do të ushtrohet inventarizimi si vijon: Bashkia, Klubi sportiv, ndërmarrja e pastrimit, shkolla e mesme, shkolla 9-vjecare, konvikti, kopështi dhe çerdhja. Komisioni i përbërë nga: z. E. K kryetar dhe anëtarët, znj. M. E dhe znj. F. L.

#### **1. Pallati kulturës, QKF dhe qendra sociale.**

z. N. A kryetar.

znj. F. D,

z. L. F.

Përgjegjësi material, anëtar.

#### **2. Njësia administrative Qerret**

Znj. L. N, kryetar.

z. L. P, anëtar.

z. A. S, anëtar.

Përgjegjësi material, anëtar.

#### **3. Njësia administrative Gjegjan.**

z. G. Ll, kryetar.

z. Gj. Sh, anëtar.

z. Ll. N, anëtar.

Përgjegjësi material, anëtar.

#### **4. Njësia administrative Qelëz.**

z. F. P, kryetar.

z. F. Gj, anëtar.

z. M. P, anëtar.

Përgjegjësi material, anëtar.

#### **Njësia administrative Rrape.**

z. S. E, kryetar.

z. E. M, anëtar.

z. K. M, anëtar.

Përgjegjësi material, anëtar.

Në procesverbalin nr.1, nr.2, nr.3, nr.4 dhe nr.5, mbajtur në datë 30.05.2023, (Proces-Verbal) nga ana e anëtarëve të komisionit të asgjesimit i materialeve të institucioneve arsimore, kulturore dhe njësisë administrative kanë asgjesuar pajisje dhe materiale të dala jashtë përdorimit në vlerë 102,400 lekë.

Ne proces verbalin e mbajtur me datë 19.12.2023 nga komisioni i inventarizimit të pasurisë së institucionit, i ngritur në bazë të urdhërit të titullarit nr. 616, datë 01.12.2023, komisioni ka përfunduar kryerjen e inventarizimit më datë 19.12.2023. Në bazë të listës së aktiveve, të marra nga zyra e financës, komisioni ka përpiluar fletën përkatëse dhe ka konstatuar se nuk ka diferenca fizike dhe ate kontabël. Po ashtu nga verifikimi cilësor dhe fizik i aktiveve, ka rezultuar se një grup pajisje zyrash (Ilogari ekonomike 218 & 218.6) nuk janë në gjendje pune, në vlerë totale **8,779,901** lekë, vlerë historike. Procesverbali është firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit. Në njësinë Administrative Gjegjan, po ashtu ka identifikuar pajisje zyrash që kanë humbur funksionin dhe janë jo në gjendje pune, në vlerë historike **3,586,143** lekë.

Në njësinë administrative Rrape pajisje zyrash jashtë funksioni në vlerë historike **955,414** lekë. Në njësinë administrative Qerret pajisje zyrash jashtë funksioni në vlerë historike **3,271,048** lekë. Në njësinë administrative Qelez pajisje zyrash jashtë funksioni në vlerë historike **776,972** lekë. Në total **17,369,478** lekë vlerë historike.

Me shkresë nr. 2318 prot., datë 01.12.2023, Kryetari i Bashkisë Pukë ka nxjerrë Urdhërin nr. 614 datë 01.12.2023, me objekt "Për ngritjen e komisionit për kryerjen e vlerësimit të pasurisë së luajtshme institucionit dhe njësisve vartëse.

Komisioni i përbërë nga:

Znj. F. L, Kryetar (NZ)

Znj. A. N anëtar

Znj. M. F, anëtar

Z. V. Gj, anëtar.

Znj. K. M, anëtar.

Znj. E. F, anëtar.

Z. Gj. M, anëtar.

Në proces verbalin e mbajtur me datë 27.12.2023 (Proces Verbal Vlerësimi) nga komisioni i vlerësimit të pasurisë së luajtshme të institucionit, i ngritur në bazë të urdhërit të titullarit nr. 614, datë 01.12.2023, komisioni ka përfunduar kryerjen e vlerësimit dhe në bazë të listës së aktiveve të identifikuara jashtë funksioni, komisioni ka përpiluar fletët përkatëse për aktivet bashkë me përshkrimin e gjendjes dhe ka vlerësuar se këto pajisje plotësojnë kriteret për nxjerrjen jashtë përdorimi të tyre. Procesverbali është firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Me shkresën nr. 2571 prot., datë 29.12.2023, Kryetari i Bashkisë Pukë ka nxjerrë Urdhërin nr. 702 datë 29.12.2023, me objekt "Për ngritjen e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimi dhe asgjesimin e vlerave materiale të përcaktuara si të papërdorshme të pasurisë së luajtshme institucionit dhe njësisve vartëse.

Komisioni i përbërë nga:

Z. D. S, Kryetar.

Znj. A. N, anëtar.

Z. H. Q, anëtar.

Z. D. Q, anëtar.

Znj. F. L, anëtar.

Në procesverbalin e mbajtur me datë 29.12.2023 (Procesverbal Vlerësimi) nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi i aktiveve të papërdorshme jashtë funksioni të institucionit, i ngritur në bazë të urdhërit të titullarit nr. 702, datë 29.12.2023, komisioni ka përfunduar kryerjen e procesit dhe në bazë të listës së aktiveve të identifikuara jashtë funksioni, komisioni ka përpiluar proces verbalin për nxjerrjen nga përdorimi dhe asgjesimin aktiveve sipas aneksit bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit. Procesverbali është firmosur nga të gjithë



anëtarët e komisionit dhe është konfirmuar nga titullari i institucionit i cili ka miratuar dhe nxjerrjen përfundimtare nga përdorimi i aktiveve.

**Konkluzioni 1:**

-Nga auditimi konstatohet se: Nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit sipas pikës 74 të UMF nr.30 ku përcaktohet se; *Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.* Si dhe pikës 109 të UMF. Nr. 30 datë 27.12.2011

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve si vijon: *Z. D. S, kryetar. Anëtarët; znj. A. N, z. H. Q, z. D. Q dhe znj. F. L.*

➤ Analiza e aktiveve afatshkurtra.

**3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:**

**PF.3**

000/Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
	<b>Llogari të arkëtueshme</b>	<b>75,102,532</b>	<b>72,175,441</b>	<b>2,927,091</b>
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	0
431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0
468	Debitorë te ndryshëm	51,376,834	49,517,165	1,859,669
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	23,725,698	22,658,276	1,067,422
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
	<b>Totali</b>	<b>75,102,532</b>	<b>72,175,441</b>	<b>2,927,091</b>
	<b>Të tjera aktive afatshkurtra</b>			
409	Parapagime	480,316	0	480,316
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	116,314,156	190,994,151	-74,679,995
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	30,633,989	38,492,096	-7,858,107
	<b>Totali</b>	<b>147,428,461</b>	<b>229,468,247</b>	<b>82,057,786</b>

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet më datën 01.01.2023, në vlerën 36,929,950 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 37,079,035 lekë me një rritje në vlerën 779,085 lekë. Në mënyrë të përmbledhur të dhënat paraqiten si më poshtë:

000/Lekë

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2023	49,517,165
Shtesa (K)	1,859,669
<b>Gjendja debitore në 31.12.2023</b>	<b>51,376,834</b>

Në mënyrë të detajuar lista e debitorëve sipas kategorive paraqitet në tabelën më poshtë;

**PF.4 në Lekë**

<b>1</b>	<b>Total tatime</b>	<b>28,485,843</b>
2	Kopeshti	134,518
3	Cerdhe	67,540
4	Konvikt	3,000
5	Thyerje 2007	711,183
6	Gjoha policia bashkiake	462,000
7	Auditi Shkoder	803,900
8	Klsh 2012	1,072,820
9	F. L Klsh 2015	63,641
10	L. P Klsh 2015	50,000
11	KLSH 2017	8,435,063
12	Vjedhjet ish komuna gjegjan 1994	762,035
13	Vjedhjet ish komuna gjegjan dhjetor 1997	1,825,655

14	Vjedhjet ish komuna gjegjan dhjetor 2009	2,354,416
15	Vjedhjet ish komuna qerret	386,770
16	Debitore ish komuna qerret	289,175
17	KLSH 2019	4,983,526
18	Dif inventari konvikt +cerdhe viti 2020	11,721
	Banesa nsh	43,840
19	Banesa me kosto të ulët	430,188
	<b>Totali</b>	<b>51,376,834</b>

### **Konkluzioni.2:**

Nga auditimi i pasqyrave financiare, në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është përfshirë vlera 6,755,600 lekë e cila i përket debitorëve nga kontratat e dhënieve me qira të pyjeve dhe kullotave, më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 të programit të auditimit. Për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitore. **Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi.** Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licensave dhe Drejtorisë së Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Shkak për këtë problematikë është mos zbatimi i kuarit të përgjithshëm të përgatitjes së pasqyrave financiare.

### **Konkluzioni.3:**

Nga auditimi u konstatua se: **Llogaria 4342 “Të tjera Operacione me shtetin (të drejta)”**, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 23,725,698 lekë e cila kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare. Nga auditimi u konstatuan diferenca midis vlerave të pasqyruara në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruar në llogaritë e pasivit, duke e nënvlerësuar llogarinë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” në shumën **30,633,989 lekë**. Pra, vlera e kësaj llogarie në bilancin kontabël është pasqyruar në mënyrë jo të drejtë në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

-Vlera e cila duhej paraqitur është 54,359,687 lekë, e cila duhej të përfaqësonte llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, e cila duhej të përbëhej sipas tabelës së mëposhtëme:

#### **Llogaria 4342 “Të tjera Operacione me shtetin (të drejta)”**

000/Lekë

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	14,655,544
Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”	20,681,611
Paga personeli llogaria 42	13,826,786
Tatimi mbi të ardhurat llogaria 431	669,936
Sigurime shoqërore llogaria 435	3,982,435
Sigurime shëndetësore 436	543,375
<b>Totali</b>	<b>54,359,687</b>

Llogaritë e klasës 4, nuk kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5. Në kundërshtim me pikën 32, kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” të Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 dhe nenit 61 të Ligjit 9936 datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

#### ➤ **Analiza e aktiveve afatgjata**

## **II. AKTIVET AFAT GJATA**

## 1. Aktivitet Afatgjata Jomateriale.

-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 1,137,600 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 79,043 lekë, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,058,557 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

000/Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	1,137,600
	2	Amortizim i akumuluar	79,043
	3	<b>Gjendja në 01.01.2023</b>	<b>1,137,600</b>
	2	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	0
	3	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
	6	<b>Gjendja më datë 31.12.2023</b>	<b>1,058,557</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Pukë.

-Nga auditimi, u konstatua se Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në Bashkinë Pukë në datën 31.12.2023 përbëhet nga 5 studime e projektme në vlerën 1,058,557 lekë, nga të cilat 593,835 lekë janë projekte të trashëguara që nga ish-komunat të pa zbatuar dhe realizuar, ndërsa 543,765 lekë janë projekte të hartuara gjatë vitit 2022, por edhe këto të pa realizuara deri në fund të vitit 2023. Kjo llogari paraqitet në Pasqyrën PF7 si më poshtë:

Nr.	Llogaria 202 kosto historike	Vlera në lekë
1	Studim projektim kanali Bushat	399,600
2	Studim projektim Ujesjellesi Bicaj	138,000
3	Studim projektim Ura Kavlibne	300,000
4	Studim projektim rruga Lumzi	300,000
5	Studim projektim kanali Bushat	399,600
<b>Totali</b>		<b>1,137,600</b>

Burimi: Bashkia Pukë

Sa më sipër konstatohet se: Deri në fund të vitit 2023 rezulton se asnjë nga këto projekte nuk janë vënë në zbatim. Për këtë arsye bashkia nuk duhej të përllogariste norma amortizimi për këto asete, pasi sipas Standarteve të Kontabilitetit (SKK-05), kostot e studimit dhe projektimit përfshihen në koston e plotë të aktivitetit, pra amortizohen në totalin e investimit të ndërtimit të aktivitetit (studimi+projektimi+zabtim, supërvizim, kolaudim). Ky veprim ka sjellë nënvlerësimin e llogarisë në shumën 79,043 lekë.

## 2. Aktivitet Afatgjata Materiale

Gjendja e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 1,202,645 lekë pandryshuar nga vitit paraardhës. Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën, si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Vlera në lekë
1	Gropa mbeturinave F-Qarri Bashkëfinancim	475,231
2	Permiresim I gropes mbeturinave stadiumi fondac ABC	331,414
3	Ndërtim sheshi per mbledhje Njesia Gjegjan	396,000
<b>Totali Bashkia+Njësitë</b>		<b>1,202,645</b>

Burimi: Bashkia Pukë

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” më datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 1,202,645 lekë. Nga verifikimi dhe analiza e llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” konstatohet se kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale nga Sektori i Financës pasi nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të trojeve nën objekt të objekteve si godina e Bashkisë dhe trualli përreth saj, trojet e ndërtesave të shkollave, kopshteve e çerdheve, Shtëpisë së Kulturës, zyrrave në Njësitë Administrative etj., sipas regjistrimit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”. Gjithashtu nuk mund të përcaktohet se vlera e pasqyruar në kontabilitet për llogarinë 212 “Ndërtime konstruksione” e cila paraqitet në vlerën 653,691,341 lekë më datë 31.12.2022, dhe në vlerën 637,399,293 lekë më datë 31.12.2023, a përfaqëson

vetëm vlerën e objekteve apo dhe vlerën e truallit nën këto objekte. Kjo përbën një klasifikim dhe paraqitje jo të saktë të vlerës pasi, ndërtesat amortizohen sipas normave të përcaktuara në SKK (*Standarti Kombëtar i Kontabilitetit*) nr. 5, për “Aktive afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, ndërkohë që trojet nën objekte janë të pa amortizueshme. -Procesi i përcaktimit të tokës dhe pronave shtetërore dhe ndarja e tyre në mes të agjencive shtetërore dhe njërive të qeverisjes vendore është një proces i cili ka nisur që nga viti 2001. Ky proces duhej zbatuar në bazë të Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

Dispozita ligjore e fundit që trajton problematikën e procesit të pronësisë për njësitë e vetëqeverisjes vendore është Ligji nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, përcaktohet që: “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit”, proces i cili duhet të përfundonte në muajin nëntor të vitit 2021.

Më hollësisht e trajtuar dhe në pikën 3 të programit të auditimit.

**-Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën neto 653,691,341 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 16,634,136, dhe pakësim sipas normave të amortizimit, gjithësej në vlerën 32,926,185, lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 637,399,292 lekë. *Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në Kapitullin anekse bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit:*

	Analiza e Llog 211	Neto 01.01.2023	Shtesa 2023
1	Pyllzime me akacie fshati Qelez	433,533	
2	Pyllzime me geshtenje dhe lajthi shpati I kishes Qelez	365,492	
3	Pyllzime me dru dekorativ ne varrezat e fshatrave Kalivare dhe Gjegjan	652,630	
4	Pyllzime me arre dhe akacie ek pyjore Buhot,Bicaj	966,222	
5	Gjelberimi Luf Komuna Luf -Qerret	117,965	
6	Dru frutore Komuna Qerret	605,985	
7	Pyllzime Gomsiqe Komuna Qerret	791,883	
8	Pyllzimme Luf Komuna qerret	482,322	
9	Pyllzimme Luf-Kcire Komuna Qerret	728,659	
10	Blerje fidane kodra e hanit	153,600	
11	Blerje Fidane Puke	787,20	
12	Punime pyje Munelle,Luf ,Qelez,Rrape	662,688	
12	Pyllzim hapje gropa qafe Qerreti Qelez	285,600	
13	Pyllzim hapje gropa qafe qerreti Qelez	6,325,301	
14	Punime ne pyje mure mbajtëse Rrapë Breg		296,880

-Për sa i përket kalimit të sipërfaqeve të pyjeve dhe kullotave në zbatim të VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike”.

Bashkia Pukë ka në administrim një fond pyjor dhe kullor prej 45,774.843 ha. Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave është miratuar me VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, ndryshuar me VKM nr.134 datë 3.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433/2016. Sipërfaqet pyjore dhe kullorore, sipas listës së inventarit, që transferohen në pronësi të Bashkisë Pukë, janë sipas shtojcës 48, bashkëlidhur këtij vendimi, e cila përmban listën e inventarit që fillon me numrin rendor 1 (një) deri 2,763 (dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre).

#### **Tabela e sipërfaqeve të transferuara “Pyje, kullota, plantacione” Bashkia Pukë**

Lloji	Sipërfaqja në ha
Pyll	38,558.113
Djerrë dhe inproduktive	5,776.33
Kullotë	1,130.14
Bimësi pyjore	288.25
Ujore	22.01
<b>Totali</b>	<b>45,774.834</b>

Në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione” nuk janë pasqyruar sipërfaqet e trajtuara më sipër, për sa kohë nuk ka një inventar të saktë të gjendjes dhe të vlerës reale aktuale, në kushte të tilla kjo llogari nuk paraqet një pamje reale në pasqyrat financiare të vitit 2023.

Më hollësisht e trajtuar dhe në pikën 3 të programit të auditimit.

**-Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën neto 653,691,341 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 16,634,136, dhe amortizim të akumuluar në vlerën 32,926,185, lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 637,399,292 lekë. *Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në Kapitullin anekse bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit:*

000/Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 212 “Ndërtime Konstruksione”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	872,880,366
	2	Amortizim i akumuluar	219,189,025
	<b>3</b>	<b>Gjendja në 01.01.2023</b>	<b>653,691,341</b>
	2	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	16,634,136
	3	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	4	Kosto historike	<b>653,691,341</b>
	5	Amortizim i akumuluar	32,926,185
	<b>6</b>	<b>Gjendja më datë 31.12.2023</b>	<b>637,399,292</b>

**-Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione”** ka të evidentuara në kontabilitet një numër të konsiderueshëm objektesh nga ish-Komunat të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre. Kjo vjen për arsye se një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (ish/Komunat) në periudhat raportuese para vitit 2015 janë të pa shoqëruar me kartela objekti. Në këto kushte duke qënë se ka mospërputhje në administrimin për çdo objekt të “Ndërtesave e Konstruksioneve” nga Bashkia Pukë, Sektori i Financës, Sektori Juridik, Sektori i Urbanistikës, në bashkëpunim ndërmjet tyre, duhej që të bëhej hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara saktësimi objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt. **Për sa më sipër llogaria 212 “Ndërtime konstruksione” nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2023.**

**-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 1,034,877,540 lekë kosto historike. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 91,037,266 lekë dhe pakësim sipas normave të amortizimit gjithësej në vlerën 479,568,031 lekë, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 646,346,775 lekë neto. *Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në Kapitullin anekse bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

000/Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	1,034,877,540
	2	Amortizim i akumuluar	450,193,274
	<b>3</b>	<b>Gjendja në 01.01.2023</b>	<b>584,684,266</b>
	2	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	91,037,266
	3	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	4	Kosto historike	1,125,914,806
	5	Amortizim i akumuluar	479,568,031
	<b>6</b>	<b>Gjendja më datë 31.12.2023</b>	<b>646,346,775</b>

### Konkluzion.3

-Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto)” konstatohet se, llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për vlerën historike 633,837,427 lekë, është përfshirë vlera prej **85,000,000 lekë** me emërtimin e objektit “Ujësllësi i Gjegjanit” e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike, **pasi kjo vlerë është kapitalizuar dhe përlllogaritur dhe normë amortizimi pa u kryer punimet përfundimtare dhe pa u marrë në dorëzim si investim.** Vlera prej 85,000,000 lekë duhej të paraqitej në shpenzime në process për sa kohë investimi nuk ka përfunduar dhe marrë në dorëzim. Poashtu është mbajtur jashtë kontabiliteti objekti Ujësllësi i fshatit Luf- Bashkia Pukë, duke e nenvlerësuar llogarinë në

vlerë 96,256,588 lekë i cili është marrë në dorëzim përfundimtar nga bashkia Pukë me datë 13.11.2023. Është ciluar dhe garancia e punimeve për këtë objekt, cka do të thotë se objekti duhej kapitalizuar në asetet e bashkisë dhe duhej përlloritur dhe norma e amortizimit nëse aplikohet. Kjo vlerë ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë dhe saktësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5. Në mbyllje të gjendjes së kësaj llogarie më datë 31.12.2023, është pasqyruar vlera e amortizimit të akumuluar për vitin 2023 në vlerën 29,374,757 lekë, por kjo vlerë i përket amortizimit të akumuluar të çeljes së llogarisë më datë 31.12.2022.

**Për sa më sipër llogaria ekonomike nr.213 “Rrugë rrjete dhe vepra ujore” nuk paraqet një pamje reale në pasqyrat financiare të vitit 2023 me ndikim në vlerat e paraqitura në bilancin kontabël.**

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Z. Rr. D në cilësinë e Nëpunësit autorizues, Znj.F. L në cilësinë e nëpunësit Zbatues dhe hartues i bilancit kontabël.*

**-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 30,214,458 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 648,246 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 17,055,767 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 13,806,937 lekë në vlerë neto. *Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në Kapitullin anekse bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Puditimit.*

000/Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	<b>30,862,704</b>
	2	Amortizim i akumuluar	17,055,767
	<b>3</b>	<b>Gjendja në 01.01.2023</b>	<b>30,214,458</b>
	2	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	648,246
	3	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0

*Burimi i të dhënave: Bashkia Pukë.*

**-Llogaria 215 “Mjete transporti”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 29,991,200 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa me pagesë në vlerën 2,514,000 blerje fadrome, dhe shtesa pa pagesë në vlerë 11,075,038 lekë, ardhur (transferim kapital) nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, bërë hyrje me FH nr.3 datë 14.02.2023. Amortizim të akumuluar në vlerën 24,172,806 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja neto e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 19,407,432. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

EMERTIMI	Vlere historike	Shtesa 2023	Paksime	Vlera Neto 2023
Komion teknologjik tip "Volo" targe TR8826R,	3,480,000	0	0	229,891
Makine Teknologjike per mbetjet tip Renault ngjyre e bardhe	2,820,000	0	0	696,370
Makine "Foristrade"	2,070,000	0	0	-
Mercedes Benz 'ML' ngjyre	650,000	0	0	160,511
Rover AA339AR ngjyre e bardhe.	270,000	0	0	66,674
Kompatator	2,940,000	0	0	-
Kamionçine me targe SH808IE	960,000	0	0	491,520
Kamion me targe AA681MO	4,020,000	0	0	2,058,240
Mjet Zjarrfikese MAN	20,400	0	0	-
Mjet Zjarrfikese Steyer	700,000	0	0	96,888
Mjet Zjarrfikese Ford Tranzit	480,000	0	0	101,167
Mjet tip Steyr-- PUCH Pinzgrauer 712, Targa PU 15185 A	350,000	0	0	114,689
SAURER Automjet nr.shasie 201778317	5,470,000	0	0	246,693
Land Rover ngjyre blu e erret	380,000	0	0	93,837
Makine	350,000	0	0	-

Mercedes BENZ GLE 350,VITI 2016	3,880,000	0	0	2,483,200
Automjet Furistrade	1,150,800	0	0	920,640
Blerje fadrome	2,514,000	2,514,000	0	2,514,000
AUTOMJET MICUBISH L 200	11,075,038	11,075,038	0	9,133,114

Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto)” konstatohet se, për llogarinë 215 “Mjete transporti” për vitin ushtrimor 2023 është përlllogaritur në rregull norma e amortizimit. Këto veprime janë në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

**-Llogaria 218 “Inventar ekonomik”** më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 81,161,178 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesë në vlerën 4,265,040 lekë. Pakësim në vlerë 17,369,748 vlerë historik lekë si pasojë e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe amortizim i akumuluar në vlerën 51,322,705 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 16,734,035 lekë vlerë neto.

Referenca	Nr.	Llogaria 218 “Inventar ekonomik”	Vlera lekë
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	<b>81,161,178</b>
	2	Amortizim i akumuluar	60,904,932
	<b>3</b>	<b>Gjendja në 01.01.2023</b>	<b>20,256,246</b>
	2	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	4,265,040,
	3	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	3,363,289
	4	Kosto historike	68,056,740
	5	Amortizim i akumuluar	51,322,705
	<b>6</b>	<b>Gjendja neto më datë 31.12.2023</b>	<b>16,734,035</b>

Shënim: (Analiza e detajuar llogarisë 218 “Inventar Ekonomik” nuk është pasqyruar në PRA për arsye madhësisë si evidencë por ky dokumentacion do të jetë pjesë e dosjes së auditimit në CD).

#### **Konkluzioni 4:**

-Nga auditimi i llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, janë të pa analizuar në kontabilitet, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit, për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat e paraqitura në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 6, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30, pika 74, dhe Udhëzimi nr. 05, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

- Vlen të theksohet se në Buxhetin Vjetor të vitit 2023 nuk janë parashikuar fonde për nisjen e procedurave për regjistrimin e asetëve të institucionit.

### **3. Aktivët Afatgjata Financiare:**

Aktivët Afatgjata Financiare, në fund të vitit 2023 paraqiten në vlerën 140,923,000 lekë dhe kjo kuadron dhe rakordon me vlerën e pasqyruar në në PF të disponueshme në sistemin e thesarit. Kjo vlerë përbëhet nga vlera e aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Pukë Sh.a dhe Futboll Klub Tërbuni Sh.a.

#### 4. Investimet.

Gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 244,905,059 lekë, ku është kontabilizuar vlera për kontrata punimesh të cilat janë në proces zbatimi punimesh. Nga testimi i kontratave konstatohet se nuk ka kontrata punimesh të cilat janë ende të pa likuiduara nga viti 2022. Në mënyrë të detajuar gjendja e llogarisë 231 paraqitet në Kpitullin anekse, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit:

000/Lekë

Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale”	
Çelje e vitit 2023	240,553,912
Shtesa (K)	106,834,434
Pakësime (D)	101,000,717
<b>Gjendja debitoare në 31.12.2023</b>	<b>244,905,059</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Pukë.

#### Konkluzioni 5

Nga auditimi u konstatua se: Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 244,905,059 lekë kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se, në fund të vitit 2023 ka kontrata që kanë përfunduar si punime dhe likujdime për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesa sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Vlera në total prej 73,804,717 lekë duhej kapitalizuar dhe jo të gjendej si shpenzim në proces. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kapitulli anekse Tab nr.1, Klasa 23.

Për sa më sipër konstatohet se për këtë llogari nuk ka një pasqyrim real të gjendjes faktike e për pasojë ka ndikuar duke mbivlerësuar llogarinë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në vlerën 73,804,717 lekë dhe duke nënvlerësuar llogarinë 101 “Aktive neto” të institucionit dhe në pasqyrimin e aseteve në dispozicion të kësaj bashkie. Për veprimet dhe mos veprime e mësipërme mbajnë përgjegjësi znj. F. P për periudhën Janar-Korrik 2023 dhe znj. F. L për periudhën 06.07.2023 -31 dhjetor 2023, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Pasqyra e objekteve të përfunduara e të marra në dorëzim të cilat paraqiten si shpenzime në proces paraqitet si më poshtë.

nr	Emertimi I objektit	Viti	Vlera në lekë 31.12.2023	
11	Sistemim I lagjes pas pallateve te kultures	2312212	2016	13,899,603
16	Sistemim I lagjes pas pallateve te kultures	2312118	2017	13,386,656
27	Rip ujsjellsi Rrape	2313300	2017	368,797
29	Vend dep mbetjesh B.Puke	2312118	2018	1,968,001
755	24.11.2020 Rruga Kabash	2313100	2020	2,400,000
821	14.12.2020 NSHN Puke	2312118	2020	9,868,261
847	29.12.2020 Diga Kukaj	2313400	2020	18,846,895
	viti 2022 Nderim Ura Auto Kabash	2313200	2022	1,999,815
	viti 2022 Rruga Gjykates investim ndricim	2313600	2022	1,115,972
	<b>VITI 2022</b>			<b>63,854,000</b>
71	02.03.2023 Trotuar dhe ndricim rruga Gjykates	2313600	2023	781,714
154	19.04.2023 Nderim ura Kabash	2313200	2023	770,823
160	26.04.2023 Kolaudim punimesh ure Kabash	2313600	2023	8,368
197	24.05.2023 Trotuar dhe ndricim rruga Gjykatës	2313600	2023	997,442
295	18.08.2023 Supervizim ndricim dhe trotuar rruga Gjykates	2313600	2023	37,333
483	13.12.2023 Nderim Ura Pla	2313200	2023	5,144,646
532	19.01.2024 Kolaudim Ura Pla	2313200	2023	8,000
533	19.01.2024 Supervizim Ura Pla	2313200	2023	50,400
161	27.04.2023 VNM Rik Qendra Rinore sportive	2312118	2023	8,288
242	16.06.2023 Rik Qendra Rinore sportive	2312103	2023	940,016
244	21.06.2023 Rikonst Palestra shkolla 9 vjeqare	2312103	2023	682,627
399	19.10.2023 Qendra Rinore Inovative Pallati Kultures	2312103	2023	508,320
437	20.11.2023 Kolaudim punimesh Palestra Sh Migjeni	2312118	2023	1,970
438	20.11.2023 Kolaudim punimesh Qendra Rinore	2312103	2023	1,970
439	20.11.2023 Supervizim Qendra Rinore Sportive	2312103	2023	8,800
	<b>Viti 2023</b>			<b>9,950,717</b>
	<b>Total 31.12.2023</b>			<b>73,804,717</b>



## **B. PASIVET (DETYRIMET)**

### **I. Pasivet Afatshkurtra**

#### **1. Llogari të pagueshme**

Llogaritë e klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Pukë më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

<i>000/Lekë</i>			
<b>Llogaria</b>	<b>Emërtimi i llogarisë</b>	<b>Viti 2023</b>	<b>Viti 2022</b>
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	14,655,544	17,391,112
42	Detyrime ndaj personelit	13,826,786	12,856,235
16,17,18	Hua Afat shkurtra		
460	Huadhenes		
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	669,936	745,525
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
435	Sigurime Shoqerore	3,982,435	3,692,761
436	Sigurime Shendetesore	543,375	505,619
437,438,	Organizma te tjere shteterore		
44	Institucione te tjera publike		
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	14,326,318	13,842,857
467	Kreditore te ndryshem	20,681,611	25,959,120
4341	Operacione me shtetin( detyrime	0	0
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
<b>Llogari të pagueshme</b>		<b>80,352,906</b>	<b>81,581,112</b>

**-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”,** në datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 14,655,544 lekë, pra Bashkia Pukë ka fatura të vitit në vazhdim të pa likuiduara për këtë llogari.

**-Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”** referuar pasqyrave financiare vlera 3,426,735 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2023 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

<i>000/Lekë</i>	
<b>Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”</b>	
Çelje e vitit 2023	<b>12,856,234</b>
Shtesa (K)	970,551
Pakësime (D)	0
<b>Gjendja debitore në 31.12.2023</b>	<b>13,826,786</b>

Vlera e kontabilizuar në llogarinë “Detyrime ndaj personelit” është 13,826,786 lekë ndërkohë që duke u bazuar në dokumentacionin justifikues (urdhër shpenzimet e realizuara nëpërmjet Degës së Thesarit Pukë) është në vlerën 13,826,786 lekë.

**-Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”,** paraqitet në vlerën 669,936 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor.

<i>000/Lekë</i>	
<b>Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”</b>	
Çelje e vitit 2023	745,525
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	75,589
<b>Gjendja debitore në 31.12.2023</b>	<b>669,936</b>

**-Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2023 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 3,982,435 lekë për sigurime shoqërore dhe 543,375 lekë për sigurime shëndetësore.

<i>000/Lekë</i>	
<b>Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”</b>	
Çelje e vitit 2023	3,692,761
Shtesa (K)	289,674
Pakësime (D)	0

<b>Gjendja debitore në 31.12.2023</b>		<b>3,982,435</b>
<b>Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”</b>		
Çelje e vitit 2022		505,619
Shtesa (K)		37,756
Pakësime (D)		0
<b>Gjendja debitore në 31.12.2023</b>		<b>543,375</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Pukë.

**-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Pukë në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 14,326,318 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Pukë.

000/Lekë

<b>Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”</b>		
Çelje e vitit 2023		<b>13,842,857</b>
Shtesa (K)		5,339,291
Pakësime (D)		4,855,830
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>		<b>14,326,318</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Pukë

Për disa objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Pukë janë ngurtësuar fonde për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Pukë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Sektori i Shërbimit Urban dhe Sektori i Financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, për të njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Këto veprime janë në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket, paraqitet në Kapitullin anekse bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### **Konkluzioni 6:**

Nga auditimi u konstatua se: **-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2023 janë në vlerën 25,959,120 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur rritje në vlerën 4,703,164 lekë dhe pakësime në vlerën 2,694,800 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie në pasqyrat financiare paraqitet në vlerën 20,681,611 lekë. Vlerat e paraqitura në bilancin kontabël nuk përputhen më të dhënat analitike të vëna në dispozicion nga zyra e financës. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” ka mospërputhje e cila duhej të ishte 27,967,484 lekë dhe jo 20,681,611 lekë. Sa më sipër është kjo llogari është nënvlerësuar në shumën 7,285,873 lekë. Ky veprim ka sjellë një deformim të informacionit kontabël dhe nuk paraqet gjendjen reale të kësaj llogarie. *Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në Kapitullin anekse, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

000/Lekë

<b>Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”</b>		
Çelje e vitit 2023		25,959,120
Shtesa (K)		4,703,164
Pakësime (D)		2,694,800
<b>Gjendja kreditore në 31.12.2023</b>		<b>27,967,484</b>

**-Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”** sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Pukë në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerë 0 lekë. Ku në fakt duhej paraqitur sipas analizës si më poshtë, paraqitur në formë tabelare.

Nr.	Emertimi				DHJETOR 2023
		31.12.2022	Debi	Kredi	
1	Paga neto e punonjësve	12,856,235	13,698,079	12,856,235	13,698,079

2	Drejtorisë TatimTaksa për tatimin mbi të ardhurat	745,525	669,936	745,525	669,936
3	DrejtorisëTatimTaksa për kontribute tshoqërore (punëdhënës +punëmarrës)	3,692,761	3,982,435	3,692,761	3,982,435
4	Drejtorisë TatimTaksa përkontributet shëndetësore (punëdhënës+punëmarrës)	505,619	543,375	505,619	543,375
5	Detyrime permbarimi ndalesa ne page	10,000	10,000	10,000	10,000
6	Ndihmë ekonomikedhjetor 2023		118,707		118,707
7	Furnitoremuauidhjetor 2023	4,848,136	4,703,164	4,848,136	4,703,164
	<b>Total</b>	<b>22,658,276</b>	<b>23,725,696</b>	<b>22,658,276</b>	<b>23,725,696</b>

## **TË ARDHURAT**

### **1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:**

**-Llogaria 70 “Të ardhurat nga taksat e tatimet”,** në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 12,741,433 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 11,076,473 lekë me një pakësim në vlerën 1,664,960 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

000/Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
<b>70</b>	<b>I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME</b>	<b>11,076,473</b>	<b>12,741,433</b>
<b>700</b>	<b>1. Tatimi mbi të ardhurat</b>	<b>27,500</b>	<b>99,183</b>
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	10,000	0
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	54,289	194,205
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
<b>702</b>	<b>2. Tatimi mbi pasurinë</b>	<b>1,885,093</b>	<b>2,603,642</b>
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	1,839,115	2,463,962
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	45,978	139,680
<b>703</b>	<b>3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit</b>	<b>9,143,630</b>	<b>10,010,608</b>
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	5,822,597	3,900,576
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	3,321,033	6,110,032
<b>704</b>	<b>4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

### **2. Të ardhurat jo tatimore:**

**-Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”,** në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 15,989,829 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 13,898,688 lekë me një pakësim në vlerën 2,091,141 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

000/Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
<b>71</b>	<b>III. TË ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>13,898,688</b>	<b>15,989,829</b>
<b>710</b>	<b>1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia</b>	<b>6,639,276</b>	<b>7,966,007</b>
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	6,639,276	7,966,007
<b>711</b>	<b>2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare</b>	<b>7,259,412</b>	<b>8,023,822</b>
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	5,565,266	6,562,572
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	1,264,543	1,290,530
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	10,000	78,930
7114	Të ardhura nga biletat		0
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	419,603	91,790
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
<b>719</b>	<b>3. Të tjera të ardhura jo tatimore</b>		

### **3. Të ardhura të tjera:**

**-Llogaria 72 “Grante korente”,** në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 383,745,342 lekë ndërsa në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 444,499,590 lekë me një rritje në vlerën 60,754,248 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

000/Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
<b>72</b>	<b>V. GRANTE KORENTE</b>	<b>444,499,590</b>	<b>383,745,342</b>
<b>720</b>	<b>I. Grant korent i brendshëm</b>	<b>444,499,590</b>	<b>383,745,342</b>
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	0	0
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	396,558,982	355,199,759
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	4,214,910	3,310,493
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	0	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	23,725,698	22,658,276

7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	0	118,814
7209	Të tjera grante korente të brendshme	20,000,000	2,458,000
<b>721</b>	<b>2. Grant korent i huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	Nga Qeveri të huaja	0	
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	0

## **SHPENZIMET**

### **1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:**

-Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 153,126,292 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 176,989,125 lekë me një rritje në vlerën 23,862,833 lekë, si pasojë e rritjes së pagave bazuar në VKM nr.328 datë 31.05.2023.

-Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 23,600,905 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 26,464,613 lekë me rritje në vlerën 2,863,708 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Pukë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

000/Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
6001	Paga, personel i përhershëm	176,989,125	153,126,292
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	26,464,613	23,600,905
6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	2,986,199	2,674,677
	<b>Totali</b>	<b>206,439,937</b>	<b>179,401,874</b>

### **2. Blerje mallra dhe shërbime:**

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datë 31.12.2022, ka qenë në vlerën 42,042,802 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 36,608,864 lekë me zbritje në vlerën 5,433,938 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Pukë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

000/Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
<b>602</b>	<b>III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME</b>	<b>36,608,864</b>	<b>42,042,802</b>
602	Mallra dhe shërbime të tjera	0	0
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	1,223,888	711,492
6021	Materiale dhe shërbime speciale	5,092,226	5,996,611
6022	Shërbime nga të tretët	9,019,660	10,293,256
6023	Shpenzime transporti	9,020,879	9,137,809
6024	Shpenzime udhëtimi	1,354,541	2,650,800
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	789,480	1,500,204
6026	Shpenzime për qiramarrje	0	0
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	5,009,707	7,474,345
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	5,098,483	4,278,285

### **3. Subvencionet:**

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Pukë nuk ka pasur subvencione.

### **4. Transferime korente:**

Gjendja e llogarisë së fondeve 604 “Transferime korente të brendshme” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 21,159,330 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve 606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 106,637,970 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

000/Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
	<b>V. TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>127,797,300</b>	<b>140,396,242</b>
604	1. Transferta korente të brendshme	21,159,330	21,063,443

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
6040	Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë		
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	2,795,330	
6042	Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	40,000	40,000
6044	Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse	18,324,000	21,023,443
<b>605</b>	<b>2. Transferime korente me jashtë</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>606</b>	<b>3. Transferime për buxhetet familjare e individë</b>	<b>106,637,970</b>	<b>119,332,799</b>
6060	Transferita të paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferita të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendorë	106,637,970	119,332,799

**Për vitin 2023** totali i të ardhurave në vlerë është 580,660,332 lekë dhe totali shpenzimeve është 488,532,010 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 92,128,322 lekë kuadron me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 92,128,322 lekë.

### **Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme për periudhën 01.01.2023 deri më datë 21.06.2023 ngarkohen me përgjegjësi: Znj. F. P me detyrë ish/Drejtor i Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nga data 06.07.2023 dhe Znj. F. L me detyrë Drejtor i Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, për periudhën nga 06.07.2023 deri më datë 31.12.2023 dhe anëtarët e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit si vijon: Z. D. S, Kryetar, Znj. A. N, Z. H. Q, Z. D. Q dhe Znj. F. L, anëtarë.*

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### **2.3. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.**

Në zbatim të pikës 3 “Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (aseteve, pyje dhe kullota)”, të programit të auditimit nr. 618/1 datë 09.05.2024 për auditimin financiar ushtruar në Bashkinë Pukë, janë administruar evidencat si mëposhtë:

- Lista e pasurive të paluajtshme të transferuar në Bashkinë Pukë
- Lista e pasurive të paluajtshme të regjistruar në kadastrë
- Inventari i fondit pyjor
- Kontratat e lidhura për dhënie me qira të fondit pyjor

## **I. PASURITË E PALUAJTSHME**

### **2.3.1. Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës**

Sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë ishin

të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t'u transferoheshin, një proces që përfshinte hartimin e inventarit paraprak, afishimin dhe përditësimin e pasurive dhe në fund miratimin e listës përfundimtare të pronave me vendim të Këshillit të Ministrave.

Nr	Njësia e Qeverisjes vendore	VKM		Në total	Ne pronësi	Ne përdorim	Të regjistruara
		Nr.	Datë				
1	Bashkia Puke	140	23.02.2011	199	154	45	8
2	Ish-komuna Qelëz	648	31.7.2013	56	41	15	2
3	Ish-komuna Rrapë		Nuk ka VMM për miratimin e listës përfundimtare				
4	Ish-Komuna Gjegjan		Nuk ka VMM për miratimin e listës përfundimtare				
5	Ish-komuna Qerret		Nuk ka VMM për miratimin e listës përfundimtare				
	<b>Totali</b>			<b>255</b>	<b>195</b>	<b>60</b>	

Për Bashkinë Pukë, lista përfundimtare e pronave është miratuar me VKM nr. 140 datë 23.02.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Pukë, të qarkut të Shkodër, nga ku rezultojnë pronat të natyrës si mëposhtë:

- Pronat me funksion administrativ **në pronësi**, me numër rendor 5, 7-14, 17-21, 28, 34 në total 15.
- Prona me funksion arsimor **në pronësi**, me numër rendor 38-47 në total 10 pasuri.
- Prona me funksion shërbimi shëndetësor **në pronësi**, me numër rendor 55, 56, në total 2 pasuri.
- Pronat me funksion social-kulturor **në pronësi**, me numër rendor 57-64, në total 8 pasuri.
- Prona që përdoren për strehim **në pronësi**, me numër rendor 65-88, në total 24 pasuri.
- Prona me funksion shërbimi social **në pronësi**, me numër rendor 89, në total 1 pasuri.
- Prona me funksion varreza **në pronësi**, me numër rendor 90-94, në total 5 pasuri.
- Prona me funksion troje të lira, sheshe **në përdorim** me numër rendor 95-101;111-144;146-148;160, në total 45 pasuri.
- Prona me funksion infrastrukture **në pronësi**, me numër rendor 102-110;145 në total 10 pasuri.
- Prona me funksion të zhvillimit ekonomik **në pronësi**, me numër rendor 149-158;165-166, në total 12 pasuri.
- Prona me funksion rrugë **në pronësi**, me numër rendor 159;406-419 në total 15 pasuri
- Prona me funksion bujqësore toka produktive në përdorim, me numër rendor 171-174, në total 4 pasuri.
- Prona me funksion ujësjellës kanalizime **në pronësi**, me numër rendor 392-395, në total 4 pasuri.
- Prona me funksion për ndriçimin publik **në pronësi**, me numër rendor 422-465, në total 44 pasuri.

Prona të regjistruara rezultojnë:

Nr	Emërtimi i pronës	Nr. Pasuri	Data e regjistrimit	Zona kadastral	Adresa	Sip truall m <sup>2</sup>	Sip nd. m <sup>2</sup>	Pasqyruar ose jo ne bilancin e Bashkisë.
1	Ndërtesë 2-katëshe	1/253	03.03.2022	3069	Pukë	190	150	PO
2	Godine 4 -katëshe Bashkia Pukë	1/233	03.03.2022	3069	Pukë	666	440	PO
3	Godinë Shkollë e Mesme Qelëz	47/4	25.05.2022	3092	Ish-komuna Qelëz	800	800	Jo
4	Zyrat e PLL-se Njësi	1/236-N1	11.05.2023	3069	Pukë	0	16	PO
5	Zyra e Komunës Qelëz	1050	04.03.2022			153	153	
6	Zyrat e Konfederatave te pavarura	1/236N2	11.05.2023	3069	Pukë	0	14.6	PO
7	Shtëpia e Oficerëve	1/383	01.07.2022	3069	Pukë	2580	633	PO
8	Kopshti i fëmijëve	145	23.01.2023	3070	Fshat Pukë	281	102	PO
9	Njësi						54	

10	Godina e Ish fjetores	Janë hapur kartelat si apartament				-	-	
10	godina e Ish Fjetorja N.N apartamenti	1/325+4-2	19.01.2023	3069	Pukë	0	85	PO
11	godina e Ish Fjetorja N.N	1/325+4-1	19.01.2023	3069	Pukë		65	PO
12	godina e Ish Fjetorja N.N	1/325+1-1	19.01.2023	3069	Pukë		65	PO
13	godina e Ish Fjetorja N.N	1/325+2-1	19.01.2023	3069	Pukë		65	PO
14	godina e Ish Fjetorja N.N	1/325+1-2	19.01.2023	3069	Rr.Lajthizë, Pukë		65	PO
15	godina e Ish Fjetorja N.N	1/325+2-2	19.01.2023	3069	Rr.Lajthizë, Pukë		85	PO
16	godina e Ish Fjetorja N.N	1/325+3-1	19.01.2023	3069	Rr.Lajthizë, Pukë		65	PO
17	godina e Ish Fjetorja N.N	1/325+3-2	19.01.2023	3069	Rr.Lajthizë, Puke		85	Po

Sa i përket çertifikatave të pronësisë, rezulton se nuk ka një bazë të dhënash të sakta mbi numrin real të regjistrimit. Asnjë drejtori në Bashkinë Pukë nuk është e ngarkuar me këtë detyrë.

Në lidhje me pasurinë nr. 47/4, zona kadastrale 3092 me sipërfaqe 800 m<sup>2</sup> truall dhe 800 m<sup>2</sup> ndërtesë, objekti gjimnazi, ish-Komuna Qelëz rezulton se në certifikatën e pronësisë mungon sipërfaqja e truallit funksional të ndërtesës. Kjo pasuri i përkon numrit rendor 621 të inventarit me sipërfaqe 1800 m<sup>2</sup> truall dhe 800 m<sup>2</sup> ndërtesë. Si pasojë, rezulton një sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup> më pak sesa inventari, për të cilën në Bashkinë Pukë nuk administrohet asnjë informacion nga Zyra Vendore e ASHK Pukë për arsyet e kësaj diference.

### **Ish-Komuna Qelëz, aktualisht njësi administrative**

Lista përfundimtare e pronave është miratuar me VKM nr. 648, datë 31.7.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qelëz të qarkut të Shkodrës”, nga ku rezultojnë pasuritë si mëposhtë:

- Prona për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative **në pronësi**, me nr. rendor 554, në total një 1 pasuri;
- Prona për realizimin e programeve arsimore **në pronësi**, me nr. rendor 555-561, 621, në total 8 pasuri ;
- Prona për realizimin e funksioneve në shëndetin publik **në pronësi**, me nr. rendor 562; 563 në total 2 pasuri;
- Prona për realizimin e funksioneve në infrastrukturë **në pronësi**, me nr. rendor 564-575 në total 12 pasuri;
- Prona me funksion varreza publike në pronësi, me nr. rendor 576-585 në total 10 pasuri;
- Prona me funksion të ujësjellës-kanalizime në pronësi, me nr. rendor 586-592, në total 7 pasuri;
- Prona me funksion bujqësore toka produktive **në përdorim**, me nr. rendor 604-618 në total 15 pasuri;
- Prona me funksion për zhvillim ekonomik **në pronësi**, me nr. rendor 620 në total 1 pasuri;

### **Për Bashkinë Pukë**

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Pukë nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të integruar të inventarit të pronave të bashkisë. Në strukturën e bashkisë dhe rregulloren e brendshme nuk përcaktohen asnjë sektor apo specialist për ushtrimin e funksioneve në lidhje me inventarin dhe regjistrimin me qëllim mbulimin e një fushe komplekse sikurse është inventari i pasurive të paluajtshme.

Nga verifikimi i evidencave, rezulton se:

- Në territorin administrativ të bashkisë Pukë, janë miratuar listat përfundimtare të pronave vetëm për bashkinë dhe ish-komunën Qelëz. Tre ish-komunat, Gjegjan, Rrapë dhe

Qerret (aktualisht njësi administrative) nuk kanë listë përfundimtare të pasurive të paluajtshme të transferuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Si pasojë në mungesë të këtij akti, ASHK nuk mund të kryejë regjistrime bazuar në listën e inventarit paraprak. Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Pukë nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si rrjedhojë, inventari rezulton i papërditësuar, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se *“bashkitë kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedura e përditësimit mbështetet në verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren dhe verifikimit juridik, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së. Po ashtu, bashkia i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligji”*.

- Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Pukë nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të inventarit të pronave të bashkisë.
- Në bashkinë Pukë nuk ka një sektor që mbulon çështjen e pasurive të paluajtshme të transferuara, sikurse përcaktohet në VKM nr.28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve”. Struktura e posaçme ka si funksion bashkëpunimin me drejtorinë përkatëse të ASHK-së, të cilat rakordojnë ndërmjet tyre, me qëllim realizimin e procedurave të parashikuara nga neni 37, i ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.
- Në total, nga 195 pasuri që i janë transferuar “në pronësi” Bashkisë Pukë, përfshirë ish-komunën Qelëz, vetëm 10 pasuri rezultojnë me dokumentacion pronësor që i korrespondojnë listës së inventarit përfundimtar. Nga evidencat e shqyrtuara konstatohet se sa i përket certifikatave të pronësisë, rezulton se nuk ka një bazë të dhënash të sakta mbi numrin real të regjistrimit.
- Në veçanti vërehet se nuk janë regjistruar pasuritë e shërbimeve arsimore, ndonëse për to janë realizuar investime përgjatë viteve, për Bashkinë Pukë.

## II.Fondi Pyjor

### 3.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira dhe likuidimin e kontratave të lidhura

Bashkia Pukë ka në administrim një fond pyjor dhe kulllosor prej 45774.843 ha. Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave është miratuar me VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, ndryshuar me VKM nr.134 datë 3.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433/2016. Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 17 të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, Bashkia Pukë nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonominë pyjore. Të regjistruara rezultojnë;

- Pasuria me nr.748/4, pyll me sipërfaqe 19954 m<sup>2</sup>, e përfuturara me ndarje sipas shënimit në kartelë dhe nuk ka të dhëna për pasurinë “mëmë”. Certifikata e pasurisë është lëshuar me datë 16.03.2023.
- Pasuria me nr. 644 me sipërfaqe pyll 56 ha, regjistruara në 21.09.2010 në emër të Komunës Qerret. Rezulton se ka problematikë në hartën treguese.
- Pasuria me nr. 645 me sipërfaqe 40.75 ha, regjistruar në 21.09.2010 në emër të Komunës Qerret. Rezulton se ka problematikë në hartën treguese.



- Pasuria me nr. 601 me sipërfaqe 78 ha regjistruara në 21.09.2010 në emër të Komunës Qerret. Rezulton se ka problematikë në hartën treguese.
- Pasuria me nr. 600 me sipërfaqe 78 ha regjistruara në 21.09.2010 në emër të Komunës Qerret. Rezulton se ka problematikë në hartën treguese.
- Pasuria me nr. 598 me sipërfaqe 37.25 ha regjistruara në 21.09.2010 në emër të Komunës Qerret. Rezulton se ka problematikë në hartën treguese.
- Pasuria me nr. 647 me sipërfaqe 54.5 ha regjistruara në 21.09.2010 në emër të Komunës Qerret. Rezulton se ka problematikë në hartën treguese.
- Pasuria me nr. 648 me sipërfaqe 71 ha regjistruara në 21.09.2010 në emër të Komunës Qerret. Rezulton se ka problematikë në hartën treguese.
- Pasuria me nr. 648 me sipërfaqe 71 ha regjistruara në 21.09.2010 në emër të Komunës Qerret. Rezulton se ka problematikë në hartën treguese.
- Pasuria me nr. 649 me sipërfaqe 86.25 ha regjistruara në 21.09.2010 në emër të Komunës Qerret. Rezulton se ka problematikë në hartën treguese.
- Pasuria me nr. 599 me sipërfaqe 7.67 ha regjistruara në 21.09.2010 në emër të Komunës Qerret. Rezulton se ka problematikë në hartën treguese.
- Pasuria me nr. 646 me sipërfaqe 41 ha regjistruara në 21.09.2010 në emër të Komunës Qerret. Rezulton se ka problematikë në hartën treguese.
- Pasuria me nr. 596 me sipërfaqe 13.75 ha regjistruara në 21.09.2010 në emër të Komunës Qerret. Rezulton se ka problematikë në hartën treguese.
- Pasuria me nr. 517, me sipërfaqe 30 ha me lëshim çertifikate 27.04.2018, lëshuar në emër të Bashkisë Pukë.

Për çertifikatat e pronësisë të lëshuara në emër të ish- Komunës Qerret me sipërfaqe totale 635,17 ha, Bashkia Pukë duhet të aplikojë për certifikata pronësore të reja për të përditësuar paraqitjen hartografike të këtyre pasurive dhe kalimin në pronësi nga “Komuna Qerret” në emër të “Bashkisë Pukë”.

Sipas llojit, fondi pyjor në Bashkinë Pukë përbëhet nga:

	Sipërfaqja në ha
Pyll	38558.113
Djerrë dhe inproduktive	5776.33
Kullotë	1130.14
Bimësi pyjore	288.25
Ujore	22.01
<b>Totali</b>	<b>45774.834</b>

### **Për vitin 2023 janë lidhur kontratat e qirasë për fondin pyjor si më poshtë:**

1. Me nr. 257 prot., datë 10.02.2023 është lidhur kontrata për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullosor prej 2.252 ha mes Bashkisë Pukë, përfaqësuar nga z. Gj. Gj dhe subjektit “W. N-E” sh.p.k, me objekt studimin dhe vendosjen e anomometrit të matjes së shpejtësisë së erës, në ekonomitë pyjore “Gomsiqe”, “Dush”, “Kuzhnen”, “Livad Hamzi”, Tërbun”, “Dedaj” “Bohot”.

Vlera e qirasë është përlllogaritur sipas VKM nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, sipas pikës 9 të shtojcës 1 për veprimtarinë “Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektsh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe”.

Lloji	Përlllogaritja	Vlera
Trungishte	1.32*96,000	126,720
Cungishte	0.72*78,000	56,160
Inproduktive	0.48*62000	29,760
<b>Totali</b>		<b>212,640</b>

Kontrata e qirasë është lidhur për një afat 10 vjeçar dhe hyn në fuqi me 15.01.2023 deri në 14.01.2033 dhe dorëzimit me procesverbal të ngastrave për studimin dhe vendosjen e anomometrit të matjes së shpejtësisë nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave.

Nga auditimi u konstatua se:

- Në lidhje me pagesën e detyrimit, ne nenin 5 të kontratës është përcaktuar se pagesa e qirasë do të bëhet brenda 10 ditëve nga data e fillimit të punimeve. Ky parashikim është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 20 ku përcaktohet se “Pagesa e qirasë është vjetore, duke u llogaritur nga data e lidhjes së kontratës dhe shlyhet në momentin e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën datë në vitet pasardhëse”. **Si pasojë, kjo kontratë nuk prodhon efekte financiare për Bashkinë Pukë.**

- Afati i kontratës prej 10 viteve nuk i përshtatet qëllimit të objektit të kontratës, sa i përket natyrës së studimit dhe matjes së shpejtësisë së erës, për të cilën maksimumi realizohet brenda një afati 2 vjeçar. Kontrata është konceptuar nga z. A. H dhe miratuar nga ish-Kryetari i Bashkisë, z. Gj. Gj.

2. Me nr. 189/8 prot., datë 14.04.2023 është lidhur kontrata mes Bashkisë Pukë dhe subjektit “L E” sh.p.k për dhënien në përdorim të një sipërfaqeje në ekonominë pyjore Gomsiqe, me objekt “Ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike eolike”, me afat 1 vjeçar. Vlera e qirasë është përlllogaritur sipas VKM nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, sipas pikës 8 dhe 10 të shtojcës 1.

Lloji	Përlllogaritja	Vlera
Cungishte	0.2465 ha*192,000 lekë	47,328
Linjë e shtrirjes (cungishte)	5.185 km*190,000 lekë	985,150
Hapja e rrugës(cungishte)	1.2 km*50,000	60,000
Vlera e lëndës së punimit	6*3500	21,000
Dru Zjarri	50 m <sup>3</sup> *600	30,000
<b>Totali</b>		<b>1,143,478</b>

Subjekti “L E” ka marrë miratimin paraprak nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me nr. 2649/2 datë 23.05.2022 dhe kontrata është lidhur një muaj para përfundimit të afatit të miratimit paraprak. Me vendimin nr.04 datë 06.02.2023, Këshilli Bashkiak ka shprehur dakortësinë për vijimin e procedurave për heqjen e fondit pyjor të sipërfaqes prej 0.0165 Ha, në ekonominë pyjore “Gomsiqe”, ngastra 15/a, ku do të ndërtohet bazamenti i shtyllës eolike. Nga auditimi u konstatua se:

- Në lidhje me pagesën e detyrimit, ne nenin 5 është përcaktuar se “pagesa e qirasë do të bëhet brenda 15 ditëve nga data e fillimit të punimeve, e cila është edhe dita e hyrjes në fuqi të kontratës”. Ky parashikim është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 20 ku përcaktohet se “Pagesa e qirasë është vjetore, duke u llogaritur nga data e lidhjes së kontratës dhe shlyhet në momentin e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën datë në vitet pasardhëse”. Si **pasojë, kjo kontratë nuk prodhon efekte financiare për Bashkinë Pukë,** por edhe në rrethanat kur do të nisin punimet, kjo kontratë i përfundon efektet për 1 vit.

- Afati 1 vjeçar nuk i përshtatet qëllimit të objektit të kontratës, për arsye se ndërtimi, së bashku me infrastrukturën lidhëse, të një objekti energjetik, kërkon një kohëzgjatje përdorimi 5- 10 vjet, e rinovueshme për aq kohë sa zhvillohet aktiviteti.

- Dosja përkatëse nuk është e inventarizuar dhe nuk ka planvendosjen, projektin e ndërtimit, planin e biznesit për përcaktimin e sipërfaqeve të linjave të shtrirjes, sipërfaqe e parcelës ndërtimore të objektit, me trullin funksional përkatës. Raporti teknik është hartuar nga z. A. H, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Për Pyjet dhe Kullotat. Kontrata është konceptuar nga z. A. H dhe miratuar nga ish-Kryetari i Bashkisë, z. Gj. Gj.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 24 të Udhëzimin nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik.

3. Me nr. 190/8, prot., 13.04.2023 është lidhur kontrata për dhënien në përdorim të fondit pyjor e kullosur për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike eolike, mes Bashkisë Pukë dhe shoqëria “V 2021” sh.p.k, me afat 1 vjeçar.

Vlera e qirasë është përlllogaritur sipas VKM nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, sipas pikës 8 dhe 10 të shtojcës 1.

Lloji	Përlllogaritja	Vlera
Cungishte	0.216 ha*192,000 lekë	41,472
Linjë e shtrirjes (cungishte)	5.853km*190,000 lekë	1,112,070
Hapja e rrugës(cungishte)	1 km*50,000	50,000
Vlera e lëndës së punimit	4*3500	14,000
Dru Zjarri	40 m <sup>3</sup> *600	28,000
<b>Totali</b>		<b>1,245,542</b>

Me vendimin nr. 03 datë 06.02.2023, Këshilli Bashkiak ka shprehur dakortësinë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor/kullosor të sipërfaqes 0.016 ha në ngastrën 15/a të ekonomisë pyjore “Gomsiqet” të Bashkisë Pukë.

Nga auditimi u konstatua se:

- Në lidhje me pagesën e detyrimit, ne nenin 5 është përcaktuar se “pagesa e qirasë do të bëhet brenda 15 ditëve nga data e fillimit të punimeve, e cila është edhe dita e hyrjes në fuqi të kontratës”. Ky parashikim është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, pika 20 ku përcaktohet se “Pagesa e qirasë është vjetore, duke u llogaritur nga data e lidhjes së kontratës dhe shlyhet në momentin e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën datë në vitet pasardhëse”. Si **pasojë, kjo kontratë nuk prodhon efekte financiare për Bashkinë Pukë**, por edhe në rrethanat kur nëse nisin punimet, kjo kontratë i përfundon efektet për 1 vit, pavarësisht vijimit të aktivitetit përkatës.

- Afati 1 vjeçar nuk i përshtatet qëllimit të objektit të kontratës, për arsye se ndërtimi, së bashku me infrastrukturën lidhëse, të një objekti energjetik, për të afati duhet të jetë 10 vjet, e rinovueshme për aq kohë sa zhvillohet aktiviteti. Kontrata është konceptuar nga z. A. H dhe miratuar nga ish-Kryetari i Bashkisë, z. Gj. Gj.

- Dosja përkatëse nuk është e inventarizuar dhe nuk ka planvendosjen, projektin e ndërtimit, planin e biznesit për përcaktimin e sipërfaqeve të linjave të shtrirjes, sipërfaqe e parcelës ndërtimore të objektit, me truallin funksional përkatës. Raporti teknik dhe kontrata është hartuar nga z. A. H, me detyrë ish - Drejtor i Drejtorisë Për Pyjet dhe Kullotat, aktualisht specialist. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 24 të Udhëzimin nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”.

4. Me kontratën nr. 1498/1 datë 28.08.2023 është bërë një aneks kontratë për HEC “Fani i Madh” për shoqërinë MC. E G” sh.p.k. Vlera e qirasë nuk është përlllogaritur plotësisht sipas VKM nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, sipas pikës 8 dhe 10 të shtojcës 1.

Lloji	Përlllogaritja	Vlera
Trungishte	1.3425*120,000	161,000 lekë
Linjë e shtrirjes trungishte tubacion	1.2810*240,0000	307,440
Vlera e lëndës së punimit)	10 m <sup>3</sup> *3500	35000
Dru zjarri	46m <sup>3</sup> *600	27600
<b>Totali</b>		<b>531,140</b>

Vlera për trungishte për sipërfaqen 1.3425 ha është përlllogaritur gabim, ku duhet të ishte në vlerën 322,400 lekë me vlerë tarifa 240,000 lekë dhe jo 120,000 lekë, duke rezultuar një diferencë në vlerën 161,200 lekë, Po ashtu nuk janë llogaritur tarifat për rrugën e kalimit. Subjekti ka paguar vlerën e kontratës në 531,140 lekë. Përveç fondit pyjor, për kullotën është

lidhur një kontratë me nr. 531/4 datë 20.03.2023 për vlerën 107,300 për një sipërfaqe 1.342 ha. Vlera e kësaj kontratë është paguar.

Në lidhje me likuidimin e kontratave të qirave rezulton se debia progresive në vitin 2023 është në vlerën 6,420,200 lekë.

Nr.	Qiramarrësi	Zona	Objekti i kontratës (HEC, gurore, agrikulturë, etj)	Afati Vjet	Kontrata	Debia progresive 31.12.2022	Detyrim vjetor lek/ha për vitin 2023	Paguar	Debia Progresive 31.12.2023
1	XH. I	Puke	Ndertese	1	nr./ dt.03.01.2017	15,180	x	x	15,180
2	E. C	Puke	"	1	nr.42/13.01.2022	x	60,000	60,000	x
3	'O-A" sh.a	Puke	"	5	nr.25/217 dt.22.05.2017	x	300,000	300,000	x
4	'O-A" sh.a	Qerret	Fond Pyjor	9	nr.2011/02.11.2020	x	160,000	160,000	x
5	'O-A" sh.a	Qerret	"	9	nr.51/18 dt.06.08.2018	x	93,500	93,500	x
6	'O-A" sh.a	Gjegjan	"	9	nr.2012/02.11.2020	x	300,000	300,000	x
7	"V" sh.a	Qerret	"	5	nr.480/2 dt.09.12.2015	x	337,500	337,500	x
8	"V" sh.a	Gjegjan	"	5	nr.113/2 dt.04.04.2014	x	300,000	300,000	x
9	"7 S B F" shpk	Qerret	Kullote	5	nr.763/1, dt.22.05.2019	1,222,800	x	x	1,222,800
10	"E U" shpk	Rrape	Fond Pyjor	mbi 5	nr.296/2, dt.06.05.2015	x	1,735,400	1,400,000	335,400
11	"G M" shpk	Gjegjan	Kullote	mbi 5	nr.229/01.04.2021	x	65,500	65,500	x
12	"I" shpk	Qerret	"	3	nr.167/1, dt.27.04.2017	475,531	x	x	475,531
13	"S-C" shpk	Gjegjan	Fond Pyjor	3	nr.630/3, dt.18.04.2018	837,000	x	x	837,000
14	"D-1" shpk	Qerret	Gurore	5	nr./dt.04.10.2012	266,079	x	x	266,079
15	"B" sha	Qerret	Fond Pyjor	mbi 5	nr.26/03.02.2015	3,268,210	x	x	3,268,210
16	"M.C E G" shpk	Gjegjan	"	1	nr.1418/8 dt.22.08.2022	x	531,140	531,140	x
<b>Totali</b>						<b>6,084,800</b>	<b>3,883,040</b>	<b>3,547,640</b>	<b>6,420,200</b>

Për vitin 2023, rezulton debitor një subjekt "E U" i cili nga detyrimi prej 1,735,400 lekë, ka paguar vlerën prej 1,400,000 lekë ose 335,400 lekë më pak se detyrimi.

Nr.	Qiramarrësi	Zona	Objekti	Afati Vjet	Kontrate	Detyrim vjetor lek/ha	Paguar	Pa paguar
1	'O-A" sh.a	Qerret	Fond Pyjor	5	nr.2011/02.11.2020	160,000	160,000	0
2	'O-A" sh.a	Qerret	"	5	nr.51/18, dt.06.08.2018	93,500	93,500	0
3	'O-A" sh.a	Gjegjan	"	9	nr.2012/02.11.2020	300,000	300,000	0
4	"V" sh.a	Qerret	"	5	nr.480/2, dt.09.12.2015	337,500	337,500	0
5	"V" sh.a	Gjegjan	"	5	nr.113/2, dt.04.04.2014	300,000	300,000	0
6	"G M" shpk	Gjegjan	Kullote	mbi 5	nr.229/01.04.2021	65,500	65,500	0
7	E U		Fond Pyjor		nr.296/2, dt.06.05.2015	1,735,400	1,400,000	335,400
8	"M.C E G" shpk	Gjegjan	Fond Pyjor	1	nr.1418/8, dt.22.08.2022	531,140	531,140	0
<b>Totali</b>						<b>3,523,040</b>	<b>3,187,640</b>	<b>0</b>

Burimi: Bashkia Pukë

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### 2.4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Referuar auditimit të mëparshëm, Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka kryer auditim në Bashkinë Pukë "Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë" (Për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022), miratuar me Vendimin nr.16 , datë 30.01.2024 të Kryetarit të KLSH-së.

##### 2.4.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

1. Me shkresën nr.1895/18 prot., datë 22.02.2024 “Kthim përgjigje për raportin përfundimtar të auditimit dhe rekomandimet e lëna”, Bashkia Pukë ka respektuar afatin prej 20-ditësh për dërgimin e planit të veprimit, për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**Shkalla e zbatimit:** Ky detyrim ligjor është zbatuar në afat.

#### ***2.4.2. Realizimi programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.***

2. Bashkia Pukë nuk ka dërguar në KLSH, raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit prej 6-muajsh, në përputhje me pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**Shkalla e zbatimit:** Lidhur me këtë detyrim ligjor nuk mund të shprehemi, referuar shkresës përcjellëse me nr. 316/10 prot., datë 11.09.2023 e dërgimit të të Raportit Përfundimtar të Auditimit si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situates, nuk mund të shprehemi pasi është brenda afatit 6 – mujor.

#### ***2.4.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.***

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se:

**a.** Nga **23 masa organizative** të rekomanduara, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat 3 masa janë zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht 9 masa nuk janë zbatuar dhe 10 masa janë në proces zbatimi.

**b.** Nga **3 masa** për përdorimin e fondeve me efektivitet në vlerën **1,655,604 lekë** të cilat janë pranuar plotësisht nga subjekti, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 1 masë është e pazbatuar.

**c.** Nga **6 masa** për të ardhura të munguara në vlerën **33,174,957 lekë** të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat 3 masa janë në proces zbatimi dhe **2 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë e pazbatuar.**

**d.** Nga **3 masa** disiplinore të cilat janë pranuar plotësisht, rezultojnë 3 masa në proces zbatimi.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, shkronja “j”. Shkresa nr.683/26 prot, datë 23.05.2022 e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe rekomandimeve për përmirësimin e situatës.

**Më hollësisht rekomandimet e pazbatuara, zbatuar pjesërisht/proces, për të cilat nga KLSH rikërkohet zbatimi i tyre, paraqiten si më poshtë vijon (numrat rendor janë sipas renditjes në shkresën përcjellëse dërguar subjektit):**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kërkesat e “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim te Titullari nga secila drejtori/sector, etj. Të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 rezulton i **pazbatuar.**

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm.

**2.2.Rekomandimi:** Nga menaxhimi i lartë i Bashkisë Pukë, në koordinim me Drejtorinë e përgjithshme të harmonizimit të kontrollit të brendshëm financiar publik dhe Drejtorinë e

harmonizimit të auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të shikohen mndësitë për lidhjen e një marrëveshjeje me strukturën e auditimit të brendshëm të njëres nga bashkitë e afërta, duke përdorur edhe praktikën e ngjashme nga bashki të tjera.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezultoi se rekomandimi 2.1 Me vendimin nr. 23, datë 29.08.2023, “Për Planin Vjetor të panimit në Shërbimin Civil, në Institucionin e Bashkisë Pukë”, janë shpallur vendet e lira dhe është vijuar me procedurat e rekrutimit të punonësve për pozicionet vakante, ku përfshihen dhe pozicionet e njësisë së auditit të brendshëm (bashkëlidhur kopje e njehsuar me origjinalin e vendimit të sipërcituar) dhe rekomandimi 2.2 Me urdhërat nr. 481, datë 05.10.2023, si dhe me nr. 596, datë 22.11.2023 (bashkëlidhur kopje e njehsuar e këtyre urdhërave), janë emëruar në punë znj. R. P, si Përgjegjëse e Sektorit të Auditit të Brendshëm dhe znj. Gj. M, specialiste e auditit të brendshëm. Pas emërimit të tyre është koordinuar puna me drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave për trajnimin dhe certifikimin e tyre si auditues.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 rezultoi në **proces zbatimi.**

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.2 rezultoi në **proces zbatimi.**

**3.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë të marrë masa që për 12 rastet e konstatuara ku nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit/kryerja e punimeve, nga Komisioni i blerjeve të vogla të përlllogariten penaltitetet përkatëse dhe të njoftohen subjektet për likuidimin e tij.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezultoi se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 3.1 rezultoi në **pazbatuar.**

**4.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Pukë.

-Të dokumentohet procesi i ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-Të respektohen afatet gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;

-Të pasqyrohet trajtimi i risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat çënojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**4.2.Rekomandimi:** Për çdo vit buxhetor të kryhen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Pukë.

#### **Në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezultoi se rekomandimet e mësipërme nuk janë zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 4.1 rezultoi në **pazbatuar.**

**Zbatimi:** Rekomandimi 4.2 rezultoi në **pazbatuar.**

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

#### **Në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar.

**Zbatimi:** Rekomandimi 5.1 rezulton i pazbatuar.

**6.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

**Në vijimësi**

**6.2.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

**Në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rekomandimet e mësipërme janë në proces zbatimi.

**Zbatimi:** Rekomandimi 6.1 rezulton në **proces zbatimi.**

**Zbatimi:** Rekomandimi 6.2 rezulton në **proces zbatimi.**

**7.1.Rekomandimi:** Njësia e Prokurimit Bashkia Pukë, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

**Në procedurat e prokurimit për vitin 2024 dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, Nga sektori i prokurimit të Bashkisë Pukë është sjellë informacioni se njësia e prokurimit në procedurat në vazhdim ka vendosur kriteret në përputhje me rekomandimet e KLSH, duke sjellë si rast “blerje karburant gazoil”, urdhër prokurimi nr. 50 datë 01.02.2024 lidhur me kapacitetin teknik, ku është bërë ndryshim tek dëshmitë e punëve të ngjashme. Po ashtu, në ftesën për ofertë me nr. 314/1 datë 12.02.2024 “bjerje ndriçuesi LED”, bjerje e vogël, janë shtuar kriteret e rekomanduara nga KLSH, si deklarata e konflikt të interesit.

**Zbatimi:** Rekomandimi 7.1 rezulton në **proces zbatimi.**

**8.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorit ekonomik, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, nga Bashkia Pukë është sjellë informacioni se titullari i AK ka ndryshuar plotësisht përbërjen e KVO (shembull urdhri nr.51 datë 01.02.2024) duke vendosur anëtarë të fushave dhe profesionave përkatëse.

**Zbatimi:** Rekomandimi 8.1 rezulton në **proces zbatimi.**

**9.1. Rekomandimi:** Bashkia Pukë të mundësoj blerjen dhe vënien në funksion të një programi financiar elektronik që të gjitha veprimet kontabël, transaksionet financiare dhe pasqyrat financiare të regjistrohen dhe të hartohen nëpërmjet këtij programi financiar.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se po aplikohet programi Alfa.

**Zbatimi:** Rekomandimi 9.1 rezulton i **zbatuar.**

**10.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Zyrën e Tatim Taksave, Bashkia Pukë të marrë masa për evidentimin dhe kontabilizim të detyrimeve për taksat/tarifa vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjarë në llog 468 “Debitorë të ndryshëm”, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tyre.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**10.2.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, të bashkëpunojë dhe koordinojë punën me Zyrën e Tatim Taksave dhe me Zyrën e Gjendjes Civile dhe të marrin të dhëna nga U K Sh.A, Pukë apo dega e Operatorit të Shpërndarjes Elektrike (OSHE) Pukë, për të nxjerrë numrin e saktë të familjeve që jetojnë në juridiksionin e Bashkisë Pukë dhe në bazë të tyre të planifikojnë të ardhurat që do të arkëtojnë për vitet në vazhdim.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se për rekomandimin 10.1 janë kontabilizuar detyrimet nga taksat dhe tarfiat vendore ndërsa për rekomandimin 10.2 nga Bashkia Pukë nuk është marrë asnjë masë, vazhdon të jetë e njëjta situatë.

**Zbatimi:** Rekomandimi 10.1 rezulton **i zbatuar pjesërisht**

**Zbatimi:** Rekomandimi 10.2 rezulton **i pazbatuar**

**11.1.Rekomandimi:** Bashkia Pukë, për çdo vit, gjatë planifikimeve buxhetore të parashikojnë në buxhetet vjetore fonde për shlyerjen pjesore të detyrimeve të prapambetura, deri në shuarjen e plotë të tyre.

**Në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi është në proces zbatimi.

**Zbatimi:** Rekomandimi 11.1 rezulton në **proces zbatimi.**

**12.1.Rekomandimi:** Bashkia Pukë, në buxhetin e vitit 2024, të planifikojë fonde nga të ardhurat e veta apo ti kërkojë mbështetje buxhetore pushtetit qendror për investimin dhe realizimin e këtyre projekteve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Bashkia Pukë nuk është marrë asnjë masë.

**Zbatimi:** Rekomandimi 12.1 rezulton **i pazbatuar.**

**13.1.Rekomandimi:** Për rastet konkrete të sipërcituara apo për çdo rast tjetër të mëparshëm që mund të evidentohet, Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm (Zyra e Financës) të bëjë regjistrimet kontabël përkatëse në librat e llogarisë duke i shtuar vlerës së objekteve ekzistuese edhe vlerat e punimeve të kryera në këto objekte.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi është në proces zbatimi.

**Zbatimi:** Rekomandimi 13.1 rezulton në **proces zbatimi.**

**14.1.Rekomandimi:** Bashkia Pukë, për çdo objekt të përfunduar dhe të kolauduar, në përfundim të periudhës së garancisë të punime, të ngrejë komisione të posaçme për marrjen në dorëzim të objekteve dhe të bëjë çlirimin e garancisë së punimeve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi është në proces zbatimi.

**Zbatimi:** Rekomandimi 14.1 rezulton në **proces zbatimi.**

**15.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm (Zyra e Financës) të bashkëpunojë dhe koordinojë punën me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe



Investimeve Publike në Bashkinë Pukë për regjistrimin e objekteve të pa regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

**Në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi është në proces zbatimi.

**Zbatimi:** Rekomandimi 15.1 rezulton i **pazbatuar**.

**16.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Përgjithshëm, të marrë masa që të ngrejë komisione të posaçme për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të mbajtura në ambientet e bashkisë dhe institucionet varëse të saj.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se rekomandimi i mësipërm është zbatuar dhe është trajtuar në pikën e pasqyrave financiare.

**Zbatimi:** Rekomandimi 16.1 rezulton i **zbatuar**.

**17.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për krijimin e pozicionit të punës edhe për 1 inspektor më tepër.

-Gjithashtu të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante dhe funksionimin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e zhvillimit të territorit.

**Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2024**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se me Vendimin nr. 30, datë 22.12.2023 të kryetarit të Bashkisë Pukë “Për miratimin e organigramës dhe strukturës së Bashkisë Pukë, Njësive Administrative, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2024”, si dhe VKB nr.45, datë 29.12.2023, “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Pukë, Njësive Administrative, Institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2024”; Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit funksion me 3 punonjës, një kryeinspektor, në inspektor dhe një specialist.

**Zbatimi:** Rekomandimi 17.1 rezulton i **zbatuar**.

**18.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë, Drejtoria e Financës dhe Sektori Juridik të marrë masat e nevojshme për shitjen e aksioneve që zotëron në Futboll Klub Tërbuni. Në rast se nuk realizohet procesi i shitjes, atëherë me Vendim të Këshillit Bashkiak, klubi i mësipërm duhet të krijohet nga e para, në formën e një shoqate sportive amatore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se Bashkia Pukë ka sjellë komentin se janë në proces në fazën e konsultimit me aktorë kryesorë si Këshillin Bashkiak dhe federatën shqiptare të futbollit në lidhje me me proceduat e nevojshme për kryerjen e një procesi.

**Zbatimi:** Rekomandimi 18.1 rezulton në **proces zbatimi**.

**19.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e vlerës debitore **311,550 lekë**, gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimit të mësipërm.

**Brenda datës 30.03.2024**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se për rekomandimin e mësipërm nuk është marrë asnjë masë.

**Zbatimi:** Rekomandimi 19.1 rezulton i **pazbatuar**.

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.**

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës për të analizuar dhe verifikuar vlerësimin e rezultateve të kësaj analize si dhe të merren masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për punonjësit përgjegjës për dëmin e shkaktuar dhe për vështirësinë financiare që i është shkaktuar Bashkisë Pukë në vlerë 1,655,604 lekë.

**Menjëherë**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nuk ka informacion për masat e marra për punonjësit. Është likuiduar detyrimi prej 1,655,604 lekë si kosto e padrejtë nga vet Bashkia Pukë, sipas urdhër shpenzime me nr. 450 datë 24.11.2023 në vlerën 250,000 lekë dhe pjesa tjetër me urdhër shpenzimit nr. 68 datë 04.03.2024 në vlerën 1,440,000 lekë.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 rezulton i **pazbatuar**.

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

**Përgjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2024 dhe në vijimësi**

**2.2.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme për likuidimin e plotë të detyrimeve të prapambetura, krijuar nga vendimet gjyqësore.

**Brenda vitit 2024**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se këto fonde planifikuar përgjatë viteve sipas mundësi financiare të Bashkisë Pukë.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 rezulton në **proces zbatimi**.

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.2 rezulton në **proces zbatimi**.

## **C. MASA PËR ARKËTIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA.**

**1.1.Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave, Bashkia Pukë të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për 107 subjekte në vlerën 26,854,446 lekë, dhe debitorë nga toka bujqësore në vlerën 2,746,417 lekë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se Lidhur me marrjen e masave për arkëtimin e debitorëve sqarojmë se, Bashkia Pukë po vijon me procese gjyqësore me subjektet "B" shpk, "S - C" shpk, dhe "B" sh.a, për vlerën debitorë prej 6,910,131 lekë. Ndërsa për vlerën debitorë 2,779,201 lekë, vlerë debitorë e cila i përket subjektit "B 1900 HTP" shpk, është lidhur Akt – Marrëveshje pagesë me këste nr. 601 datë 06.03.2024. Subjektet debitorë tjera fizike / juridike rezultojnë me llogari të bllokuara nga ana jonë dhe Bashkia Pukë po vijonë me masat tjera shtrënguese në përcaktim të ligjit nr. 9920 /2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).

Lidhur me debitorët për tokën bujqësore sqarojmë se, është arkëtuar vlera prej 46,417 lekë, ndërsa nga evidentimi në terren mbi planifikimin real të taksës mbi tokën bujqësore është ngritur grupi punës me urdherin e brendshëm nr.13, datë 17.01.2022 "Për hartimin e regjistrave të familjeve fermere që disponojnë tokë bujqësore", ku ka rezultuar se, në Njësitë

Administrative Rrapë dhe Qelëz vlera debitore prej 496,688 lekë u përket personave të vdekur. (598 individ të vedukr sipërfaqe tokë bujqësore 152 ha)

Në njësitë Gjegjan dhe Qerret po vijohet me evidentimin dhe planifikimin real të të ardhurave mbi tokën bujqësore. Nga Njësitë Administrative Gjegjan, Rrape, Qerret dhe Qelëz po vijnë me nxjerrjen e njoftim detyrimeve dhe ndjekjen e rrugëve ligjore për arkëtimin e taksës mbi tokën bujqësore.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 rezulton në **proces zbatimi.**

**2.1.Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim, Kontroll dhe Zhvillim Territorit, të marrë masa që të për të gjithë personat/subjektet të cilët janë pajisur me leje legalizimi, të aplikohet vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë, si dhe në raste të mos arkëtimin të ndiqen të gjitha procedurat ligjore përkatëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se Lidhur me marrjen e masave për arkëtimin e debitorëve për "taksë ndikimi në infrastrukturë", sqarohet se, referuar shkresave të dërguara nga Drejtoria Vendore e ASHK Shkodër, për efekt llogaritjen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve paleje, Bashkia Pukë ka nxjerrë njoftim detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për të gjitha subjektet/individë në referim të nenit 27/c të ligjit nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar). Gjithashtu, Bashkia Pukë i është drejtuar ASHK- së Shkodër dhe ASHK- së Pukë me shkresën nr. 548 prot., datë 28.02.2022, për mos pajisjen me çertifikata legalizimi subjektet dhe individët debitor për taksën e ndikimit në infrastrukturë me qëllim arkëtimin/realizimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Nga vlera debitore progressive 288,286 lekë është arkëtuar vlera 25,507 lekë. Bashkia Pukë po vijon me masat tjera shtrënguese për arkëtimin e debitorëve për taksë ndikimit në infrastrukturë në përcaktim të ligjit nr.9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).

**Zbatimi:** Rekomandimi 2.1 rezulton **zbatuar pjesërisht.**

**3.1.Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Drejtorinë Mjedisit, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë 107,000 lekë.

**Brenda datës 30.03.2024**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se është nxjerrë njoftimi për vlerësimin tatimor por nuk është arkëtuar vlera përkatëse prej 107,000 lekë.

**Zbatimi:** Rekomandimi 3.1 rezulton **zbatuar pjesërisht.**

**4.1.Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave, Bashkia Pukë të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuar të, për **2,010 familje** të pa taksuara në vlerën **2,528,900 lekë.**

Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Pukë, të marrë masat e nevojshme për krijimin e një regjistri mbi taksat dhe tarifatat vendore për kategorinë "Familjar", duke pasqyruar të gjitha informacionet e nevojshme dhe evidentimin real të familjeve që jetojnë në Bashkinë Pukë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se Lidhur me marrjen e masave duke ndjekur rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuar për 2010 familje të pa taksuara në vlerën 2,528,900 lekë, sqarohet se, sipas të dhëna tona numëri prej 2010 familjeve i përket familjeve të përjashtuara me VKB nga taksat e tarifatat vendore. (Nga këto pensionistë 1.500 familje - Nd. Ekonomike dhe PAK 710 familje). Në Njësitë Administrative Gjegjan, Rrapë, Qerret dhe Qelëz, planifikimi i taksës familjare është bërë mbi bazën e inventarizimit fizik, verifikimit në

terren të familjeve që banojnë aktualisht (rezident) për çdo fshat të njësive administrative dhe që janë përfitues të shërbimeve të ofruara Bashkia. Verifikimi/inventarizimi në terren i familjeve është bërë nga administratat e njësisë/ve administrative në koordinim me kryetarët e fshatrave (kryepleqt). Gjithashtu, në zbatim të Rekomandimeve të KLSH- së është ngritur një grup tjetër pune me urdhër të brendshëm nr.127, datë 04.03.2024 "Për evidentimin e taksapaguesve familjar dhe bizneseve që kryejnë aktivitet brenda juridiksionit". Bashkia Pukë po vijon me evidentimin real të familjeve që jetojnë në Bashkinë Pukë.

**Zbatimi:** Rekomandimi 4.1 rezulton në **proces zbatimi**.

**5.1.Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave, Bashkia Pukë të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara, për 1,857 familje në vlerën **557,194 lekë**.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se lidhur me marrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve për taksë familjare, Bashkia Pukë ka nxjerë njoftim detyrimet tatimore dhe nga 557,194 lekë janë arkëtuar 147,397 lekë, mbetet pa arkëtuar 409,797 lekë. Bashkia Pukë po vijon me ezaurimin e rrugëve tjera ligjore në përcaktim të VKB – së, nr.56/30.12.2022 "Paketa Fiskale" (e ndryshuar) dhe ligjit nr.9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).

**Zbatimi:** Rekomandimi 5.1 rezulton në **proces zbatimi**.

**6.1.Rekomandimi:** Bashkia Pukë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie si dhe të krijohet një regjistër i taksës për tokën bujqësore ku të evidentohen të gjithë personat me të dhëna të sakta.

Nga ana e Sektorit të Tatim Taksave në Bashkinë Pukë, gjatë planifikimit të të ardhurave nga toka bujqësore të merren masa për saktësimin e sipërfaqes në vlerën 762 Ha, e llogaritur më pak në vitet e kaluara, ku me çmimin minimal sipas Paketës Fiskale korrespondon në vlerën **381,000 lekë**, si e ardhur e munguar në Buxhetin e Bashkisë Pukë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se nga Bashkia Pukë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit të mësipërm.

**Zbatimi:** Rekomandimi 1.1 rezulton **i pazbatuar**.

## **D. MASA DISIPLINORE.**

**D.1.**Mbështetur në nenin 57 "Përgjegjësia për masat disiplinore", nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", germa "a" dhe nenin 59 "Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore" të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", si dhe nenit 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 15 – Masat disiplinore, të kontratës individuale të punës, **i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Pukë** vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore ndaj:

1. **Z. B A**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile, për kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në disa procedura. (*Trajtuar më hollëshit pika 2.4, faqe 63-91 të Raportit të Auditimit*);

2. **Z. N. A**, me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave, për problemet e konstatuara në lidhje me mbledhjen e të ardhurave dhe menaxhimin e pronës publike, si dhe për mangësitë e konstatuara në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. (*Trajtuar më hollëshit pika 2.2, faqe 27-50 të Raportit të Auditimit*);

3. **Z. E. K.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve Publike dhe ai Juridik, për problemet e konstatuara në lidhje me mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. (*Trajtuar më hollëshit pika 2.4, faqe 63-91 të Raportit të Auditimit*);

## **D.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.**

Për **3- ish punonjësit** e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personi nuk është në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Vërejtje” për:

1. **Znj. F. P.**, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm (Drejtore e Financës) dhe Nëpunës Zbatues, për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe auditin e brendshëm, në lidhje me kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, në lidhje me Menaxhimin financiar dhe Kontrollin, si dhe për mangësitë e konstatuara në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm (*Trajtuar më hollëshit pika 2.3, faqe 27-50 të Raportit të Auditimit*);

2. **Znj. E. P.**, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe auditin e brendshëm, si dhe për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël. (*Trajtuar më hollëshit pika 2.4, faqe 63-91 të Raportit të Auditimit*);

3. **Z. K. M.**, me detyrë Anëtar i KVO, për kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST. (*Trajtuar më hollëshit pika 2.4, faqe 63-91 të Raportit të Auditimit*);

4. **Z. E. P.**, me detyrë Anëtar i KVO, për kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST (*Trajtuar më hollëshit pika 2.4, faqe 63-91 të Raportit të Auditimit*);

5. **Znj. A. M.**, me detyrë Anëtar i NJP, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. (*Trajtuar më hollëshit pika 2.4, faqe 63-91 të Raportit të Auditimit*).

6. **Z. A. L.**, me detyrë Anëtar i NJP, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit. (*Trajtuar më hollëshit pika 2.4, faqe 63-91 të Raportit të Auditimit*).

**Komenti Subjektit/Grupit të Auditimit të KLSH:** Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezultoi se Me urdhërin nr. 229, datë 28.05.2024, është ngritur komisioni disiplinor për vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë të nëpunësve civil të atakuar në Raportin Përfundimtar të KLSH-së (bashkëlidhur kopje e njehësuar e urdhërit).

**Zbatimi:** Rekomandimi rezultoi në **proces zbatimi**.

## **2.5. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.**

Në zbatim të programit të auditimit nr.618/1 datë 09.05.2024 për ushtrimin e auditimit financiar në Bashkinë Pukë, pika 5 “Të ndryshme të dala gjatë auditimit”, janë shqyrtuar ankesat e znj. V. K dhe z. A. G.

### **A. Ankesa e znj. V. K**

Me shkresën nr.707 datë 21.05.2024 është administruar në KLSH ankesa e znj. V. K e cila shpreh problematikën se i është ulur niveli i pagës së pozicionit, në kundërshtim me urdhrin e emërimit në detyrën e drejtores së konviktit. Konkretisht, me urdhrin nr. 337 datë 29.08.2023 znj. V. K është emëruar në pozicionin e Drejtorit të Konviktit “Ali Bytyçi”, me datë fillimi të marrëdhënieve financiare 01.09.2023 me pagë të përlllogaritur (pagë grupi 11,000 + pozicioni 68,500 + 2 % vjetërsi), sipas pikës 2 të këtij urdhri.

Për muajin shtator, znj. V. K është paguar sipas përlllogaritjes të urdhrin të emërimit, ndërsa në muajin tetor është paguar sipas përlllogaritjes (pagë grupi 12,000 lekë + pozicioni 48,000 lekë + 2% vjetërsi).

**I. Nga ana procedurale, mbi veprimet apo mosveprimet e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Nëpunësit Zbatues, nga grupi i auditimit është konstatuar se:**

**I.1** Ndryshimi i pagës së pozicionit nga 68,500 lekë (paga e pozicionit zv/drejtor i shkollës së mesme deri në 300 nxënës) në 48,000 lekë (paga e pozicionit të edukatore/kujdestare, grupi 2), është kryer në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar” i ndryshuar dhe rregulloren e Brendshme të Bashkisë Pukë miratuar me urdhrin nr.247 datë 30.12.2015, Në mënyrë të detajuar, rezultojnë faktet si mëposhtë:

- Zbritja e nivelit të pagës nuk ka ndjekur asnjë procedurë administrative dhe formë shkresore, por është iniciuar kryesisht nga Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Arsimit dhe Rinisë (DMBNJ), z. S. Gj. Konkretisht, nuk është ndryshuar Urdhri nr. 337 datë 29.08.2023 për emërimin e znj. V. K në pozicionin “Drejtor Konvikti” për nivelin e pagesës, nga 68,500 lekë në 48,500 lekë si dhe nuk është hartuar dhe administruar asnjë dokumentacion shkresor për të argumentuar arsyet e ndryshimit. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” ku përcaktohet se: *“Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij”*.

- Nuk është njoftuar zyrtarisht punonjësja znj. V. K për ndryshimin e bërë, me qëllim njohjen me arsyet e këtij ndryshimi dhe ushtrimin e të drejtës ligjore të ankimit.

- Nga ana e Nëpunësit Zbatues të Bashkisë Pukë, znj. F. L, janë miratuar veprimet financiare për ndryshimin e pagës, nga 68,500 lekë në 48,000 lekë, pa administruar dokumentacionin përkatës, konkretisht urdhrin e ndryshuar të emërimit të Kryetarit të Bashkisë dhe dokumentacionin shoqërues. Po ashtu, konstatohet se nuk është mbajtur asnjë korrespondence e brendshme, mes strukturës së financës dhe strukturës së burimeve njerëzore për diferencën që rezulton mes pagës së pozicionit dhe pagës që faktikisht i paguhet znj. V. K. Më hollësisht, mungon arsyetimi ligjor dhe shkresor për të argumentuar se si punonjësi që emërohet në pozicionin “Drejtor Konvikti” me pagë 80,000 lekë, sipas VKM nr.175/2017 i ndryshuar me VKM nr.271/2023, zbret në kategorinë e pozicionit “edukatore/kujdestare” e grupit 2, me pagë 48,000 lekë, duke marrë një pagesë më pak edhe se pozicioni i kujdestarit në këtë konvikti që paguhet me pagë 51,400 lekë. Si pasojë, nuk ka gjurmë auditimi mbi rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare, në rastin konkret për uljen e pagës, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjithë veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Këto veprime dhe mosveprime nga Nëpunësi Zbatues janë në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12 “Përgjegjësia menaxheriale e nëpunësve zbatues” dhe me VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, ndryshuar me VKM nr. 241, datë 20.4.2023.

**I.2.** Ndryshimi i nivelit të pagës është bërë në formë tabelore që i bashkëngjitet një urdhri të përgjithshëm nr.547 datë 02.11.2023 “Për emërimin e punonjësve sipas strukturës organizative të Bashkisë Pukë, njësive administrative dhe institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2023”, ku znj. V. K i është zbritur vlera prej 20,500 lekë nga niveli i pozicionit ku është emëruar, si Drejtore e Konviktit. Ky urdhër është konceptuar nga Drejtori DMBNJ, z. S. Gj dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë z. Rr. D, si vijon:

Tabela 1: Paraqitja tabelore që është bërë në Urdhrin nr.547 datë 02.11.2023

Pozicioni	Kategoria/klasa	Paga e grupit	Vjetërsi	Shtesë për pozicion
Zëvendës drejtor i shkollës së AML-dhe Drejtor i Konviktit	I	14000	2%	68,500 lekë
Znj. V. K	II	12,000	2%	48,000 lekë

Sikurse konstatohet, vlera e përcaktuar si 48,000 lekë nuk përputhet me vlerën prej 68,800 lekë e përcaktuar në urdhrin e emërimit. Përfshirja e kësaj vlerë si pozicion page në tabelën e urdhrin

nr. 547 datë 02.11.2023 është në kundërshtim me vet nivelin e pagës që përcakton edhe ky urdhrë. Ky ndryshim në tabelë, nga ana procedurale, nuk mund të bëhet pa u shoqëruar me urdhrin e ri që do të ndryshonte urdhrin e parë të emërimit nr. 337 datë 29.08.2023 që është në vlerën 68,500 lekë.

Urdhri nr. 547 datë 02.11.2023 mbart përshkrimin se është nxjerrë në zbatim të:

- VKM nr. 241, datë 20.4.2023 “Për disa ndryshime në VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”,
- VKB nr.25 datë 26.09.2023 “Për një ndryshim në VKB nr.67 datë 30.12.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të bashkisë Pukë, njësive administrative dhe institucioneve në varësi të deleguara”.

Për VKB nr. 25 datë 26.06.2023, ku bazohet urdhri i mësipërm, sqarohet faktet juridike si më poshtë:

- Me VKB nr.67 datë 30.12.2022<sup>8</sup>, në tabelën shoqëruese të këtij vendimi është përfshirë pozicioni “zëvendës drejtor i shkollës së AML deri në 300 nxënës dhe drejtor konvikti” (dy pozicione të ndryshme në një pozicion) me pagë 64,300 lekë, me punonjës znj. V. K. Ky pozicion nuk përputhet me funksionin dhe strukturën e Bashkisë, pasi pozicioni i zv/drejtorit të shkollës emërohet dhe është në listë pagesat e drejtorive rajonale arsimore dhe nuk është pjesë e funksioneve të deleguara të bashkisë. Me shkresën nr.51/2 datë 18.01.2023, Prefekti i Qarkut Shkodër ka konstatuar parregullsi për pagat e punonjësve mbështetës dhe ka kërkuar korrigjime.

- Me VKB nr. 25 datë 26.09.2023 është ndryshuar VKB nr.67 datë 30.12.2022, ku në listën tabelore bashkëlidhur vendimit mungojnë pozicionet e funksioneve të deleguara, ku bën pjesë edhe pozicioni i znj. V. K, e për rrjedhojë nuk i është ridërguar Prefektit lista e plotë e punonjësve për funksionet e deleguara. Me shkresën nr.622/1 datë 04.10.2023, Prefekti i Qarkut Shkodër ka kërkuar korrigjimin e VKB nr.25 datë 26.09.2023 referuar VKM nr.326/2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjëseve të tjerë të ndryshëm në disa institucione të administrative publike”. Në këtë kuadër, Prefekti ka lënë shënimin që “të informohet Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës dhe Prefekti i Qarkut”. Ky detyrim nuk është zbatuar nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore. Projektvendimi për VKB nr. 25 datë 26.09.2023, nga struktura e burimeve njerëzore, është dërguar te sekretari i Këshillit në datë 25.07.2023, në shkelje të afatit ligjor, në kundërshtim me nenin 16, pika 2 (ii) të ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e Qarkut” ku përcaktohet se “vendimi i marrë nga organi i njësive të vetëqeverisjes vendore, pas rishqyrtimit të aktit të kthyer nga prefekti i qarkut, depozitohet pranë prefektit të qarkut me të njëjtën procedurë dhe afat sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të kësaj pike”, (brenda 10 ditëve).

## **II. Në lidhje me nivelin e pagës për pozicionin e Drejtorit të Konviktit**

Pozicioni i Drejtorit të Konviktit bën pjesë në funksionet e deleguara të bashkive dhe rregullohet me VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, ndryshuar me VKM nr. 241, datë 20.4.2023. Ndryshimet që pëson kjo VKM kanë të bëjnë kryesisht me nivelin e pagave.

Në pikën 2/2 përcaktohet se: “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë dhe drejtues të institucioneve të arsimit parashkollor, të qendrave kulturore të fëmijëve dhe të konvikteve të nxënësve është sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij”, konkretisht si vijon:

Tabela 1 Lidhja nr. 3 e VKM175/2017

Emërtimi i pozicionit	Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa e pozicionit
-----------------------	---------------	---------------------	-----------------------	---------------------

<sup>8</sup> Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të bashkisë Pukë, njësive administrative & institucioneve në varësi të deleguara”.

<b>Drejtor i Konvikteve</b>	<b>1</b>	<b>2%</b>	<b>5% e PG 10% e PG 20 % e PG</b>	<b>80,000</b>
-----------------------------	----------	-----------	---	---------------

Si rrjedhojë, në zbatim të Urdhrit nr. 337 datë 29.08.2023 për emërimin e znj. V. K në pozicionin e Drejtorit të Konviktit “Ali Bytyçi”, përlllogaritja duhet të ishte (grupi 14,000 + pozicioni 80,000 + 2 % vjetërsi), në zbatim të VKM të sipërcituar.

Kjo bazuar edhe në fakti se sipas 3 (a) paga e grupit (kolona 2 e lidhjeve nr. 1, nr. 2 e nr. 3), është paga për nivelin arsimor të kërkuar, vlera e së cilës përcaktohet sipas lidhjes nr. 4, “Paga për nivelin arsimor”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Sipas VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, ndryshuar me VKM nr. 241, datë 20.4.2023, niveli arsimor i kërkuar për grupin 1 është “Diplomë e ciklit të dytë të studimeve universitare apo të barasvlershme me to sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për arsimin”, për të cilën znj. V. K disponon diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare “Master Profesional”, lëshuar datë 22.06.2012.

Ndërkohë, sipas veprimeve apo mosveprime të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Nëpunësit Zbatues, për të cilat sikurse theksuam s’ka gjurmë auditimi dhe shkresore, rezultojnë të jenë bërë ndryshimet si mëposhtë:

<b>Paga sipas VKM për Drejtorin e Konviktit</b>	<b>Drejtor Konvikti</b>	<b>80,000 lekë</b>
<b>Paga e emërimit Drejtor Konvikti</b>	<b>Paguhet si zv.drejtor e shkollës së mesme deri në 300 nxënës</b>	<b>68,500 lekë</b>
<b>Zbritja e pagës</b>	<b>Kujdestare</b>	<b>48,000 lekë</b>

Si konkluzion, znj. V. K, që ushtron detyrën “Drejtor Konvikti”, ka marrë për 1 muaj (shtator 2023) pagën e zv/drejtorit të shkollës së mesme deri në 300 nxënës (që emërohet nga drejtoritë arsimore por jo Bashkia dhe s’bën pjesë te funksionet e deleguara) dhe nga tetori 2023 e në vijim paguhet si kujdestare konvikti.

Në lidhje me këtë çështje, me shkresën nr.719 datë 27.05.2023 administruar në KLSH, zv/kryetari i Bashkisë, z. F. R, ka kërkuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit interpretim për saktësim punonjësi. Interpretimi konsiderohet i shteruar me trajtimin e ankesës së znj. V. K përcjellë në KLSH me ankesën nr.707 datë 21.05.2024.

Për këtë çështje, theksojmë se Bashkia Pukë nuk mund të kërkojë interpretim “post faktit”, pasi ka kryer veprime financiare që kanë krijuar dhe shkaktuar prej mëse 8 muajsh efekte financiare negative për znj. Kuliçi, por këtë kërkesë mund ta kishte bërë para ndryshimit të pagës. Po ashtu, nuk mund të kërkohej interpretim për një përcaktim që rezulton i shprehur qartë në VKM nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, ndryshuar me nr. 241, datë 20.4.2023, se paga e Drejtorit të Konviktit është në vlerën 80,000 lekë.

Sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet mban përgjegjësi z. S. Gj, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Arsimit dhe Rinisë dhe znj. F. L, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

## **B. Ankesa e z. A. G**

**1.** Me shkresën nr.1085 datë 12.12.2023 është administruar ankesa e z. A. G i cili shprehet se Bashkia Pukë nuk ka zbatuar dispozitat ligjore për dhënien e shpërblimit të pagës për daljen në pension.

Me shkresën nr.1987/2 datë 09.05.2024, kthim përgjigje KLSH-së, konceptuar nga z. S. Gj dhe nënshkruar nga zv/Kryetari z. F. R është refuzuar dhënia e pagesës së shpërblimit me arsyetimin se “shtetasi A. G, i datëlindjes 04.02.1957 ka arritur moshën e daljes në pension me datë 04.02.2022. Zgjatja e mëtejshme e marrëdhënieve të punës deri me datë 19.06.2023, pra 16 muaj më shumë nga afati është bërë në kundërshtim me ligjin pasi nuk ndjekur asnjë procedurë për shtyrjen e daljes në pension”.



Sa më sipër, konstatohet se kjo shkresë nuk ka referencë në asnjë bazë ligjore dhe është në kundërshtim me VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar, pika 7 “Në ndihma të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe raste të tjera, të cilat përballohen nga fondi faktik i veçantë, përfshihen pagesat për rastet:- daljes së punonjësve në pension pleqërie. Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në masën e një page mujore”.

Në këtë rast, nga struktura e burimeve njerëzore nuk është përgatitur urdhri për dhënien e pagës mujore, me rastin e daljes në pension të z. A. G, me qëllim miratimin nga titullari i bashkisë dhe kryerjen e veprimeve nga struktura e financës për lëvrimin e fondit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi z. S. Gj, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Arsimit dhe Rinisë.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:**

**Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2023-2025, u konstatua se:

-Nuk janë marrë masat për të përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin e Bashkisë, kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor;

Për PBA 2023-2025 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Pukë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

-Për PBA 2023-2025 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, pasi nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;

-Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;

-Nuk dokumentohet plotësisht, pasi në dosjen përkatëse të PBA, nuk administrohet dokumentacioni mbi kërkesat e bëra për fondet nga përgjegjësit e sektorëve të Bashkisë Pukë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, (nuk është bërë analize e detajuar); Tavanet përgatitore dhe përfundimtare të PBA-së 2023-2025, janë miratuar jashtë afateve.

Gjithashtu konstatohet se nuk janë zbatuar detyrimet ligjore për hartimin e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2023. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 19 dhe pikat 22-23; Pikën 1 të nenit 33, pikën 1 të nenit 35, pikën 1 të nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 12-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtorja e Financës, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të kryhen konsultimet me komunitetin dhe grupet e interesit.

-Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore dhe Përfundimtare të PBA-së;

-Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;

## **Gjatë planifikimit të PBA buxhetit vjetor pasardhës**

**1.2.Rekomandimi:** Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa që gjatë vitit buxhetor të hartohen raportet 4 mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, me të cilat të njihet këshilli bashkiak dhe njëkohësisht të dërgohen edhe në Ministrinë e Financave.

## **Menjëherë dhe në vijimësi**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi të dhënat e buxhetit të vitit 2023, rezulton se është realizuar në masën 81%, ku nga vlera e parashikuar me gjithë shtesa prej 590,055 mijë lekë është realizuar vlera 479,834 mijë lekë. Ky mos realizim vjen për faktin se parashikimi i shpenzimeve nuk është bërë mbi bazën e të ardhurave faktike të një vitit më parë, por është planifikuar mbi planin e të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, i cili për asnjë vit nuk realizohet.

Zëri kryesorë i shpenzimeve, investimet është zëri që ka përqindjen më të ulët, ku nga vlera e parashikuar prej 154,586 mijë lekë është realizuar në masën 108,671 mijë lekë ose 70%, që do të thotë se nga Bashkia Pukë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Në lidhje me faturat e palikujduara në fund të vitit 2023, konstatohet se janë në vlerën 30,633,989 lekë, nga e cila me të ardhurat e veta 29,479,147 lekë dhe me fondet nga Ministrinë e linjës për vlerën 1,154,842 lekë. Në raport me totalin e shpenzimeve të vitit 479,834 mijë lekë, kjo njësi vendore nuk është në vështirësi financiare, pasi zë 8% të totalit.

Këto veprime janë në kundërshtim me germën (a) të nenin 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 24 dhe 25 në nenin 3, nenin 47 në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, si dhe pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 12-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtorja e Financës të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe të bëjë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

**2.2.Rekomandimi:** Drejtorja e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

## **Përgjatë vitit buxhetor 2024 dhe në vijim**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e paraqitura nga Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Pukë, konstatohet se për periudhën objekt auditimi nuk janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj dhe vjetorë, nuk evidentohet se sa është numri i personave që duhet të paguajnë detyrimin, sa nga këto persona plotësojnë kriteret për pagesa, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe nëse vlera e arkëtuar nga agjentët tatimorë janë likuiduar në afat apo jo, kjo për ASHK (nga shitja e pasurisë), Drejtorja e Transportit (për mjetet qarkullues), Drejtorja Rajonale Tatimorë Shkodër (tatim fitim thjeshtuar) dhe U. K Sha Pukë (abonentët familjarë), Drejtorja e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave (renta minerare), Bashkia Pukë nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Në qoftë se krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do

të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm. Për sa më sipër, Bashkia Pukë nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 7, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”. Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është U. K Sh.a Pukë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1 faqe 12-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1.Rekomandim:** Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifrat apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

**3.2.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Pukë, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifrat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

### Menjëherë dhe në vijimësi

**4.Gjetje nga auditimi:** Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Pukë kryhet në programin Excel. Sektori i Tatim Taksave nuk kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Pukë i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Sektorit të Tatim Taksave.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Sektorit të Tatim Taksave për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të Sektorit të Taksave.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrisë së Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1 faqe 12-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1.Rekomandimi:** Nga Sektori i Tatim Taksave të merren masa të menjëhershme për krijimin e regjistrit të taksave dhe tatimpaguesve vendore në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, me qëllimin ruajtjen dhe mirë administrimin e të dhënave.

### Menjëherë dhe në vijimësi

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se: **Llogaria 4342 “Të tjera Operacione me shtetin (të drejta)”**, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 23,725,698 lekë e cila kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare. Nga auditimi u konstatuan diferenca midis vlerave të pasqyruara në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruar në llogaritë e pasivit, në shumën -

**30,633,989 lekë.** Pra, vlera e kësaj llogarie në bilancin kontabël është pasqyruar në mënyrë jo të drejtë në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar. Vlera e cila duhej paraqitur është 54,359,687 lekë, e cila duhej të përfaqësojë llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, e cila duhej të përbëhej sipas tabelës së mëposhtme:

**Llogaria 4342 “Të tjera Operacione me shtetin (të drejta)”**

000/Lekë

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	14,655,544
Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”	20,681,611
Paga personeli llogaria 42	13,826,786
Tatimi mbi të ardhurat llogaria 431	669,936
Sigurime shoqërore llogaria 435	3,982,435
Sigurime shëndetësore 436	543,375
<b>Totali</b>	<b>54,359,687</b>

Llogaritë e klasës 4, nuk kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 32, kreu III “Procedurat për Përgatitjen, Paraqitjen dhe Konsolidimin e Pasqyrave Financiare në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” të Udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 34-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**5.1. Rekomandimi:** Nëpunësi zbatues të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

**Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2024**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto)” konstatohet se, llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për vlerën historike 633,837,427 lekë, është përfshirë vlera prej **85,000,000 lekë** me emërtimin e objektit “Ujssjellësi i Gjeganit” e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike, pasi kjo vlerë është kapitalizuar dhe përlllogaritur dhe normë amortizimi pa u kryer punimet përfundimtare dhe pa u marrë në dorëzim si investim. Vlera prej 85,000,000 lekë duhej të paraqitej në shpenzime në proces për sa kohë investimi nuk ka përfunduar dhe marrë në dorëzim. Po ashtu është mbajtur jashtë kontabiliteti objekti Ujssjellësi i fshatit Luf- Bashkia Pukë me vlerë 96,256,588 lekë i cili është marrë në dorëzim përfundimtar nga bashkia Pukë me datë 13.11.2023. Është ciluar dhe garancia e punimeve për këtë objekt, cka do të thotë se objekti duhej kapitalizuar në asetet e bashkisë dhe duhej përlllogaritur dhe norma e amortizimit nëse aplikohet. Kjo vlerë ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë dhe saktësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5. Në mbyllje të gjendjes së kësaj llogarie më datës 31.12.2023, është pasqyruar vlera e amortizimit të akumuluar për vitin 2023 në vlerën 29,374,757 lekë por kjo vlerë i përket amortizimit të akumuluar të çeljes së llogarisë më datë 31.12.2022, Kapitulli III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.1, “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, nënpika (Më hollësisht trajtuar në pike III.2.2, faqe 34-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**6.1 Rekomandimi:** Nëpunësi zbatues në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare, të marrë masa për kapitalizimin e të gjitha objekteve të marra në dorëzim. Poashtu të sistemojë vlerat e paraqitura gabim në pasqyrën 7/b me qëllim paraqitjen reale të gjendjes dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata.

**Me mbylljen e Pasqyrave Financiare 2024**

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 244,905,059 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se, në fund të vitit 2023 ka kontrata që kanë përfunduar si punime dhe likujdime për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesa sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Vlera në total prej 73,804,717 lekë duhej kapitalizuar dhe jo të kategorizohej si shpenzim në proces. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23. Për sa më sipër konstatohet se për këtë llogari nuk ka një pasqyrim real jo vetëm të gjendjes faktike por për pasojë ka ndikuar në vlerën e fondit bazë neto të institucionit, dhe në pasqyrimin e aseteve në dispozicion të kësaj bashkie. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 34-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1 Rekomandimi:** Drejtori i financës në cilësinë e nëpunësit zbatues, të marrë masa që me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024 të sistemojë me analizë llogarinë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” me qëllim pasqyrimin e saktë të vlerave në kontabilitet. Poashtu të kapitalizojë vlerën 73,804,717 lekë e cila i përket investimeve të përfunduara prej vitesh.

#### **Me mbylljen e Pasqyrave Financiare 2024**

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2023 janë në vlerën 25,959,120 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur rritje në vlerën 4,703,164 lekë dhe pakësime në vlerën 2,694,800 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie në pasqyrat financiare paraqitet në vlerën 20,681,611 lekë. Vlerat e paraqitura në bilancin kontabël nuk përputhen më të dhënat analitike të vëna në dispozicion nga zyra e financës. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” ka mospërputhje e cila duhej të ishte 27,967,484 lekë dhe jo 20,681,611 lekë. Sa më sipër është kjo llogari është nënvlerësuar në shumën 7,285,873 lekë. Ky veprim ka sjellë një deformim të informacionit kontabël dhe nuk paraqet gjendjen reale të kësaj llogarie. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 34-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1 Rekomandimi:** Me qëllim identifikimin dhe raportimin e saktë e detyrimeve të prapambetura, Drejtoria e Financës të marrë masa të menjëhershme për të bërë sistemimet e nevojshme për këtë llogari, me qëllim paraqitjen e saktë e informacionit kontabël.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se: Nuk është kryer i plotë procesi i inventarizimit sipas pikës 74 të UMF nr.30 ku përcaktohet se: Aktivët që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, **bëhen hyrje** në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur ose djegur. Sipas pikës 109 të UMF. Nr. 30 datë 27.12.2011. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 34-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**9.1 Rekomandimi:** Bashkia Pukë, Drejtoria e Financës të marrë masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve, të mbahet gjurma e auditit dhe të kryhet ndarja e aktiveve nga ato pa vlerë, si dhe të plotësohet i saktë i dokumentacioni justifikues.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**10.Gjetje nga auditimi.** Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Pukë nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të integruar të inventarit të pronave të bashkisë. Në territorin e Bashkisë Pukë, janë miratuar listat përfundimtare të pronave vetëm për bashkinë dhe ish-komunën Qelëz. Tre ish-komunat, Gjegjan, Rrapë dhe Qerret nuk kanë listë

përfundimtare të pasurive të paluajtshme të transferuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Si pasojë në mungesë të këtij akti, ASHK nuk mund të kryejë regjistrime bazuar në listën e inventarit paraprak. Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Pukë nuk është rakorduar me Zyren Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si rrjedhojë, inventari rezulton i papërditësuar, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Në strukturën e bashkisë dhe rregulloren e brendshme nuk përcaktohet asnjë sektor apo specialist për ushtrimin e funksioneve në lidhje me inventarin dhe regjistrimin me qëllim mbulimin e një fushe komplekse sikurse është inventari i pasurive të paluajtshme, në kundërshtim me VKM nr.28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishtme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 53-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të marrë masa për ngritjen e një strukture të posaçme për ushtrimin e funksioneve në lidhje me përditësimin e inventarëve të pasurive të paluajtshme, duke krijuar një inventar të integruar për ish-komunat dhe për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës me qëllim miratimin e inventarëve përfundimtare dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

**Menjëherë**

**11.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i aseteve rezulton se, nga 195 pasuri që i janë transferuar “në pronësi” Bashkisë Pukë dhe ish-Komunës Qelëz (aktualisht njësi administrative), vetëm 10 pasuri rezultojnë me dokumentacion pronësor që i korrespondojnë listës së inventarit përfundimtar. Nga evidencat e shqyrtuara në lidhje me certifikata e pronësisë, rezulton se nuk ka një bazë të dhënash të saktë mbi numrin real të regjistrimeve të pronave. Në lidhje me pasurinë nr. 47/4, zona kadastrale 3092 me sipërfaqe 800 m<sup>2</sup> truall dhe 800 m<sup>2</sup> ndërtesë, objekti gjimnazi, ish-Komuna Qelëz, rezulton se në certifikatën e pronësisë mungon sipërfaqja e truallit funksional. Kjo pasuri i përkon numrit rendor 621 të inventarit me sipërfaqe 1800 m<sup>2</sup> truall dhe 800 m<sup>2</sup> ndërtesë. Si pasojë, rezulton një sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup> më pak sesa inventari, për të cilën në Bashkinë Pukë nuk administrohet asnjë informacion nga Zyra Vendore e ASHK Pukë për arsyet e kësaj diference. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 53-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1.Rekomandimi:** Bashkia Pukë të marrë masa për të krijuar regjistrin e çertifikatave të pronësisë si dhe të kërkojë informacion mbi statusin juridik të truallit funksional të gjimnazit me nr. 47/4 pasurie, për diferencën prej 1000 m<sup>2</sup> që rezulton mes çertifikatës dhe inventarit, për të cilën të kërkojë regjistrimin e kësaj sipërfaqeje.

**Menjëherë**

**12.Gjetje nga auditimi:** Bashkia Pukë ka në administrim një fond pyjor dhe kulloror prej 45774.843 ha. Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave është miratuar me VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, ndryshuar me VKM nr.134 datë 3.3.2021. Në lidhje me regjistrimin e sipërfaqeve të fondit pyjor/ kulloror në Bashkinë Pukë rezulton se:

- Për pasurinë me nr.748/4, me sipërfaqe 19954 m<sup>2</sup> pyll, konstatohet se është përfituar me ndarje sipas shënimit në kartelë por nuk ka të dhëna për pasurinë “mëmë”. Certifikata e pasurisë është lëshuar me datë 16.03.2023.
- Për totalin 660.14 ha, të regjistruar në emër të ish-Komunës Qerret me datë lëshimi çertifikate 21.09.2010 kanë probleme me hartën treguese, duke mos individualizuar në planvendosje kufijtë realë të këtyre sipërfaqeve.

Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 17 të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, Bashkia Pukë nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 50-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1.Rekomandimi:** Bashkia Pukë të marrë masa për të planifikuar fonde për hartimin e planeve të mbarështimit për ekonomitë pyjore. Në lidhje me sipërfaqet e regjistruara, të marrë masa për të aplikuar për certifikata të reja pronësie për pasuritë e regjistruara në emër të ish-komunës Qerret si dhe të kërkojë informacion për pasurinë me nr. 784/4 në lidhje me pasurinë e origjinës dhe ndarjet që ka pësuar, me qëllim identifikimin e saktë të totalit të sipërfaqes së rezultuar për pasurinë përkatëse.

**Menjëherë**

**13.Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me kontratat e qirasë për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor rezultoi se:

**Në 3 raste** për subjektet “W N-E” sh.p.k “L E” sh.p.k, “V 2021” sh.p.k konstatohet se në lidhje me pagesën e detyrimit, në nenin 5 është përcaktuar se pagesa e qirasë do të bëhet brenda 15 ditëve nga data e fillimit të punimeve, e cila është edhe dita e hyrjes në fuqi të kontratës. Ky parashikim është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kerkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, Si pasojë, këto kontrata nuk prodhojnë efekte financiare për Bashkinë Pukë. Në lidhje me kohëzgjatjen është konstatuar se afatet e vendosura nuk i përshtaten qëllimit të objektit të kontratës si dhe dosjet përkatëse nuk janë të inventarizuara me dokumentacionin detyrues si planvendosjen, projektin e ndërtimit, planin e biznesit për përcaktimin e sipërfaqeve të linjave të shtrirjes, etj. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 24 të Udhëzimit nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kerkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”.

**Në 1 rast**, për kontratën nr.1498/1 datë 28.08.2023 (aneks kontratë) për HEC “Fani i Madh” për shoqërinë “MC. E G” sh.p.k, vlera e qirasë nuk është përlllogaritur plotësisht sipas VKM nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”. Konkretisht, Vlera për trungishte për sipërfaqen 13.425 ha është përlllogarit gabim, duhet të ishte në vlerën 322,400 lekë me vlerë tarife 240,000 lekë jo 120,000 lekë, e si rrjedhojë rezulton një diferencë prej 161,200 lekë. Po ashtu, mungon përlllogaritja e tarifave për rrugën e kalimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 53-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1.Rekomandimi:** Bashkia Pukë të marrë masa për të anuluar kontratat e qirave për dhënie në përdorim të fondit pyjor për subjektet W N-E” sh.p.k, “L E” sh.p.k, “V 2021” sh.p.k si kontrata të lidhura në kundërshtim me kuadrin rregullator, duke njoftuar për këtë qëllim Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Po ashtu, të marrë masa për inventarizimin e dosjeve duke i plotësuar me dokumentacionin si planvendosjen, projektin e ndërtimit, planin e biznesit etj. Për kontratën me subjektin “MC. E G” të bëjë një rivlerësim të tarifave, përfshirë rrugën e kalimit.

**Menjëherë**

**14.Gjetje nga auditimi:** Me shkresën nr. 707 datë 21.05.2024 është administruar në KLSH ankesa e znj. V. K e cila shpreh problematikën se i është ulur niveli i pagës së pozicionit. Konkretisht, me urdhrin nr. 337 datë 29.08.2023, znj. V. K është emëruar në pozicionin e Drejtorit të Konviktit “Ali Bytyçi”, me datë fillimi të marrëdhënieve financiar 01.09.2023 me pagë të përlllogaritur (pagë grupi 11,000 + pozicioni 68,500 + 2 % vjetërsi), sipas pikës 2 të këtij urdhri. Për muajin shtator, znj. V. K është paguar sipas përlllogaritjes të urdhrin të emërimit, ndërsa në muajin tetor e në vijim është paguar sipas përlllogaritjes (pagë grupi 12,000 lekë + pozicioni 48,000 lekë + 2% vjetërsi). Nga auditimi rezultoi se:

- Znj. V. K, që ushtron detyrën e Drejtor Konvikti, ka marrë për 1 muaj (shtator 2023) pagën e zv/drejtorit të shkollës së mesme deri në 300 nxënës (që emërohet nga drejtoritë arsimore

por jo Bashkia dhe s'bën pjesë te funksionet e deleguara) dhe nga tetori 2023 e në vijim është paguar me pagën e kujdestares së konviktit.

- Ndryshimi i pagës së pozicionit nga 68,500 lekë (paga e pozicionit zv/drejtor i shkollës së mesme deri në 300 nxënës) në 48,000 lekë (paga e pozicionit të edukatore/kujdestare, grupi 2), është kryer në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar” i ndryshuar me VKM nr. 241, datë 20.4.2023.
- Zbritja e pagës nuk ka ndjekur asnjë procedurë administrative si dhe nuk është njoftuar zyrtarisht punonjësja znj. V. K për ndryshimin e bërë, me qëllim njohjen me arsyet e këtij ndryshimi dhe ushtrimin e të drejtës ligjore të ankimit.
- Nga ana e Nëpunësit Zbatues të Bashkisë Pukë janë miratuar dhe kryer veprimet financiare për ndryshimin e pagës, nga 68,500 lekë në 48,000 lekë, pa administruar dokumentacionin përkatës, konkretisht urdhrin e ndryshuar të emërimit. Si pasojë, nuk ka gjurmë auditimi mbi rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare, në rastin konkret për uljen e pagës, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjithë veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

Në zbatim të VKM nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar” i ndryshuar, lidhja nr.3, për pozicionin “Drejtor Konvikti” përllogaritja duhet të ishte (grupi 14,000 + pozicioni 80,000 + 2 % vjetërsi). Nga përllogaritja rezulton se znj. V. K ka marrë pagë neto (tetor 2023 e në vazhdim) në vlerën 52,436 lekë ndërkohë që duhet të merrte një pagë neto në vlerën 80,246 lekë, me një diferencë prej 27,810 lekë. Për muajin shtator, kur është paguar me pozicionin e zv/drejtorit të shkollës së mesme deri në 300 nxënës me pagë neto 68,449 lekë, rezulton një diferencë prej 11,797 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.5, faqe 69-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë të marrë masa për ndryshimin e urdhrit nr.337 datë 29.08.2023 për emërimin e znj. V. K në pozicionin e Drejtorit të Konviktit “Ali Bytyçi”, duke përcaktuar përllogaritjen e pagës si vijon (pagë grupi 14,000 lekë + pozicioni 80,000 lekë + 2% vjetërsi), në bazë të VKM nr. 175/2017 i ndryshuar si dhe t'i kthehen diferencat e mbajtura padrejtësisht nga paga, duke filluar nga muaji shtator 2023 e në vijim.

**Menjëherë**

**15.Gjetje nga auditimi:** Me shkresën nr.1085 datë 12.12.2023 është administruar ankesa e z. A. G i cili shprehet se Bashkia Pukë nuk ka zbatuar dispozitat ligjore për dhënien e shpërblimit të pagës për daljen në pension.

Me shkresën nr. 1987/2 datë 09.05.2024, kthim përgjigje KLSH-së është refuzuar dhënia e pagesës së shpërblimit me arsyetimin se “shtetasi A. G, i datëlindjes 04.02.1957 ka arritur moshën e daljes në pension me datë 04.02.2022. Zgjatja e mëtejshme e marrëdhënieve të punës deri me datë 19.06.2023, pra 16 muaj më shumë nga afati është bërë në kundërshtim me ligjin pasi nuk ndjekur asnjë procedurë për shtyrjen e daljes në pension”.

Sa më sipër, konstatohet se kjo shkresë nuk ka referencë në asnjë bazë ligjore dhe është në kundërshtim me VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar, pika 7 “Në ndihma të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe raste të tjera, të cilat përballohen nga fondi faktik i veçantë, përfshihen pagesat për rastet:- daljes së punonjësve në pension pleqërie. Pagesa jepet nga titullari i institucionit deri në masën e një page mujore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.5, faqe 69-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë të marrë masa për dhënien e shpërblimit të një page mujore, me rastin e daljes në pension për z. A. G.

**Menjëherë**

**16.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 867/7 prot., datë 01.02.2024, rezulton se:



Nga Bashkia Pukë me shkresën nr. 1895/18 prot., datë 22.02.2024 është kthyer përgjigje në respektim të afatit 20 ditorë, referuar shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në lidhje me zbatimin e afitit 6 mujor, referuar pikës 2 të nenit 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, afati nuk është zbatuar nga subjekti, pasi programi i auditimit në subjekt është brenda këtij afati.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi rezultoi se:

**a. Nga 23 masa organizative** të rekomanduara, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat **3 masa** janë zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht 9 masa nuk janë zbatuar dhe 10 masa janë në proces zbatimi.

**b. Nga 3 masa** për përdorimin e fondeve me efektivitet në vlerën **1,655,604 lekë** të cilat janë pranuar plotësisht nga subjekti, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 1 masë është e pazbatuar.

**c. Nga 6 masa** për të ardhura të munguara në vlerën **33,174,957 lekë** të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat 3 masa janë në proces zbatimi dhe **2 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë e pazbatuar.**

**d. Nga 3 masa** disiplinore të cilat janë pranuar plotësisht, rezultojnë 3 masa në proces zbatimi. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “j”; Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 61-69, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.1. Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

#### **A. Masa organizative:**

**1.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Pukë dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kërkesat e “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, etj. Të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

**3.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Pukë të marrë masa që për 12 rastet e konstatuara ku nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit/kryerja e punimeve, nga Komisioni i blerjeve të vogla të përlllogariten penalitetet përkatëse dhe të njoftohen subjektet për likuidimin e tij.

**4.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm (Drejtoria e Financës) të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Pukë.

-Të dokumentohet procesi i ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-Të respektohen afatet gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;

-Të pasqyrohet trajtimi i risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat çënojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë.

**4.2.Rekomandim:** Për çdo vit buxhetor të kryhen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Pukë.

**5.1.Rekomandim:** Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

**10.1.Rekomandim:** Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Zyrën e Tatim Taksave, Bashkia Pukë të marrë masa për evidentimin dhe kontabilizim të detyrimeve për taksat/tarifa

vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjarë në llog 468 “Debitorë të ndryshëm”, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tyre.

**10.2.Rekomandim:** Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm, të bashkëpunojë dhe koordinojë punën me Zyrën e Tatim Taksave dhe me Zyrën e Gjendjes Civile dhe të marrin të dhëna nga U K Sh.A, Pukë apo dega e Operatorit të Shpërndarjes Elektrike (OSHE) Pukë, për të nxjerrë numrin e saktë të familjeve që jetojnë në juridiksionin e Bashkisë Pukë dhe në bazë të tyre të planifikojnë të ardhurat që do të arkëtojnë për vitet në vazhdim.

**12.1.Rekomandim:** Bashkia Pukë, në buxhetin e vitit 2024, të planifikojë fonde nga të ardhurat e veta apo ti kërkojë mbështetje buxhetore pushtetit qendror për investimin dhe realizimin e këtyre projekteve.

**15.1.Rekomandim:** Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm (Zyra e Financës) të bashkëpunoi dhe koordinoj punën me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve Publike në Bashkinë Pukë për regjistrimin e objekteve të pa regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

**19.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e vlerës debitore 311,550 lekë, gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimit të mësipërm.

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.**

**1.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Pukë, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës për të analizuar dhe verifikuar vlerësimin e rezultateve të kësaj analize si dhe të merren masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për punonjësit përgjegjës për dëmin e shkaktuar dhe për vështirësinë financiare që i është shkaktuar Bashkisë Pukë në vlerë 1,655,604 lekë.

### **C. MASA PËR ARKËTIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA.**

**2.1.Rekomandim:** Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontroll dhe Zhvillim Territorit, të marrë masa që të për të gjithë personat/subjektet të cilët janë pajisur me leje legalizimi, të aplikohet vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë, si dhe në raste të mos arkëtimin të ndiqen të gjitha procedurat ligjore përkatëse.

**3.1.Rekomandim:** Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Drejtorinë Mjedisit, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 107,000 lekë.

**6.1.Rekomandim:** Bashkia Pukë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie si dhe të krijohet një regjistër i taksës për tokën bujqësore ku të evidentohen të gjithë personat me të dhëna të sakta.

Nga ana e Sektorit të Tatim Taksave në Bashkinë Pukë, gjatë planifikimit të të ardhurave nga toka bujqësore të merren masa për saktësimin e sipërfaqes në vlerën 762 Ha, e llogaritur më pak në vitet e kaluara, ku me çmimin minimal sipas Paketës Fiskale korrespondon në vlerën 381,000 lekë, si e ardhur e munguar në Buxhetin e Bashkisë Pukë.

**Menjëherë**

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, rezulton se Bashkia Pukë për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2023 ka shpenzuar vlerën **277,091 lekë**, për 1 rast, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Në urdhrin e Titullarit të institucionit për likuidimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Pukë. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të

zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 12-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

### **Përgjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2024 dhe në vijimësi**

## **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi administrimin e TNI nga ndërtimet informale, rezultojnë se:

Sipas të dhënave të marra nga Sektori i Urbanistikës dhe Planifikimit Vendor Bashkia Pukë, deri në fund të vitit 2023 janë legalizuar gjithsej 19 subjekte për vlerën 1,566,676 lekë, nga e cila likuiduar vlera 140,651 lekë, duke mbetur për detyrim vlera 1,426,025 lekë, e cila konsiderohet si e ardhur e munguar në buxhet, pasi nuk rezultojnë e kontabilizuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5; etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1.6, faqe 12-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** Sektori i Urbanistikës dhe Planifikimit Vendor të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Tatimit Taksave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë **1,426,025 lekë**.

### **Menjëherë**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi administrimin e taksës së tokës bujqësore, rezultojnë se kjo taksë për vitin 2023 është realizuar në vlerën 122 mijë lekë nga vlera 124 mijë lekë të planifikuar ose në masën 98 %. Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga Bashkia Pukë rezultojnë se vlera debitorë për taksën e tokës bujqësore, deri në fillim të vitit 2023 është 2,746,417 lekë, përsa i përket debitorëve të cilët janë krijuar gjatë vitit 2023 rezultojnë se nuk janë krijuar debitorë të rinj, **si rrjedhojë detyrimi deri më 31.12.2023 rezultojnë në vlerën 2,746,417 lekë** vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë, pasi është e pakontabilizuar.

Theksojmë se, sipërfaqe e tokës bujqësore e taksuar, është bërë mbi bazën e vetëdeklarimeve të familjeve që përdorin tokë bujqësore, si dhe jo të jenë bërë verifikime me qëllim sigurimin e të dhënave dhe krijimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore.

Mangësi konstatohen edhe në organizimin e strukturave për ndjekjen e kësaj takse, mos përditësimi i regjistrave të familjeve fermerë që disponojnë toke si dhe niveli i ulët i realizimit të taksës së tokës bujqësore, duke u evidentuar një numri i madh i familjeve debitorë në vlera të konsiderueshme debitorë. Regjistrat nuk janë të përditësuar sipas ndryshimeve të bëra vit pas viti në kadastrë për tokat në disponim dhe përdorim.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe 24. ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10. VKB nr. 56 prot., datë 30.12.2022 pika Tab 2, Për

miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1.6, faqe 12-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1.Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave, në bashkëpunim me Njësitë Administrative të ngrerë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, duke verifikuar në terren si dhe marrjen zyrtare e të dhënave nga institucionet përkatëse. Pas identifikimit dhe evidentimit me të gjithë treguesit të parcelave të tokës që disponon çdo fermer, të rishikohet planifikimi i të ardhurave për këtë taksë, të ndiqet arkëtimi i saj nëpërmjet njoftim-vlerësimeve për detyrimet për gjithë kohën e papaguar për familjet fermerë dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative e ligjore në strukturat e tjera kompetente, sipas rastit.

Gjithashtu të ndiqen të gjitha rrugët ligjore deri në arkëtimin e vlerës **2,746,417 lekë**, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë.

**Menjëherë**

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Bashkia Pukë lidhur me gjendjen e debitorëve progresive për subjektet fizik/juridik, konkretisht biznesi i madh, biznesi i vogël dhe ambulant në fund të vitit 2022 rezultojnë në një numër debitorësh, prej **93 subjekte në vlerën 13,232,744 lekë**. Detyrim i krijuar gjatë vitit 2023 rezultojnë për 17 subjekte në vlerën 973,727 lekë, duke rezultuar në fund të vitit 2023 (progresive), prej 110 subjektësh me vlerë debitorë prej **14,206,471 lekë**.

Nga auditimi deri në fillim të vitit 2023 gjendja e debitorëve nga abonentët familjarë është në vlerën 557,194 lekë për 1.857 familje. Janë krijuar brenda viti 2023 në vlerën 244,954 lekë për 870 familje, duke mbetur debitorë progresiv deri më 31.12.2023 në një numër prej **2.655 familje debitorë në vlerën 802,148 lekë**.

Në fund të vitit 2023 borxhi tatimor në Bashkinë Pukë është në vlerën **19,206,568 lekë** vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pukë.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet se, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2023, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të fushës ndaj debitorëve të Bashkisë Pukë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1.6, faqe 12-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1.Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Pukë, si, Sektori i Urbanistikës dhe Planifikimit Vendor, Sektori Juridik, Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë e Financës, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **19,206,568 lekë** kjo për subjekte/abonent familjare, për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

**Menjëherë**

**4.Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me likuidimin e kontratave të qirave konstatohet se në vitin 2023 janë aktive 8 kontrata për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullësor, nga të cilat 4 subjekte kanë për objekt vendosjen e antenave, 1 subjekt ka për objekt sipërfaqe kullësore dhe 3 subjekte kanë si objekt “HEC”.

Debia progresive e akumuluar ndër vite, në vitin 2023 rezultojnë se është në vlerën 6,420,200 lekë, të cilat nuk janë kontabilizuar. Për vitin 2023, rezultojnë debitor një subjekt “E U” sh.p.k i cili nga detyrimi prej 1,735,400 lekë ka paguar vlerën prej 1,400,000 lekë ose 335,400 lekë më pak se detyrimi. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”, pika 20 ku përcaktohet se “Pagesa e qirasë është vjetore, duke u llogaritur nga data e lidhjes së kontratës dhe shlyhet në momentin e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën datë në vitet pasardhëse”; Gjithashtu, nëse nga subjektet refuzohet

pagesa po në zbatim të nenit 10, pika 10.1, nga Bashkia zgjidhet kontrata për mos përmbushje të kushteve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 53-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1.Rekomandimi:** Bashkia Pukë të marrë të gjitha masat ligjore dhe administrative për arkëtimin e vlerës së debisë progresive nga 8 kontrata, në masën **6,240,200 lekë**.

**Menjëherë**

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se në fund të vitit 2022 janë gjithësej 16 gjoba në vlerën 90,000 lekë, si dhe përgjatë vitit 2023 janë krijuar 12 gjoba në vlerën 12,000 lekë, dhe në mënyrë progresive deri në 31.12.2023 janë krijuar 28 gjoba në vlerën 102,000 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të pa arkëtuara për buxhetin e Bashkisë Pukë.

Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat shtrënguese si dhe nuk janë aplikuar kamat vonesa sipas ligjit në fuqi. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar.

Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1.6, faqe 12-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Pukë në bashkëpunim me Sektorin e Policisë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 102,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **D. MASA DISIPLINORE.**

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil: Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Pukë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

##### **a. “Vërejtje” në zbatim të pikës “a” të nenit 58, për 4 punonjës:**

**1. Znj. F. L**, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm dhe Nëpunës Zbatues, për problematikat e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare, zbatimin e buxhetit dhe trajtimin e ankesave, këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 19 dhe pikat 12-34, etj. *(Trajtuar më hollësisht në pikën III.2.1, faqe 12-35, III.3.2.2 faqe 34-53 dhe pikën III.2.5 faqe 69-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2. Z. N. A**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, për mos marrjen e masave të plota për arkëtimin e debitorëve, këto veprime janë në kundërshtim me nenin 93, 94, 95, 131 të parashikuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar *(Trajtuar më hollësisht në pikën III.2.2.6, faqe 12-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3. Z. S. Gj**, me detyrë Drejtor Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Arsimit dhe Rinisë, për parregullësitë e konstatuara në trajtimin e ankesave. *(Trajtuar më hollësisht në pikën III.2.5, faqe 69-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4. Z. A. H.**, me detyrë Drejtor për pyjet dhe kullotat, aktualisht me detyrë inspektor pyjesh, për problematikat e konstatuara në administrimin e aseteve dhe pyjeve. (*Trajtuar më hollësisht në pikën III.2.3, faqe 53-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

## D.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për **1- ish punonjës** e mëposhtme nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personi nuk është në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Vërejtje” për:

**1. Znj. F. P** me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm dhe Nëpunës Zbatues, për anomalitë e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare dhe zbatimin e buxhetit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 19 dhe pikat 22-23, etj. (*Trajtuar më hollësisht në pikën III.2.1 dhe pikën III.2.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

## V.ANEKSE

### Aneksi nr.1 – Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit trajtuar nga faqja nr.12 deri në faqen nr.35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Tabela 12, Lista e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likuidimet e kryera prej saj për dëmshpërblim page, për punonjësit e larguar nga puna.

Emri i kreditorit	Vendim Gjykate nr./dt	Objekti i Vendimit	Gjendja e palikjuar	Vendime të ardhura gjatë vitit 2023		Likjuar gjatë vitit 2023	Mbetja date 31.12.2023
			31/12/2022	Nr dhe dt. vendimit	Vlera e vendimit		
1	2	3	4	5	6	7	8=4+6-7
Permbaues Gjygsor E M Shkoder	120/12.06.2013,nr 130/4.07.2012	Demshp per largim nga puna	134,000				134,000
H. LI	4449 dt 06.12.18	Demshp per largim nga puna	277,901			277,091	
<b>Totali</b>			<b>411,901</b>			<b>277,091</b>	<b>134,000</b>

*Burimi: Bashkia Pukë*

Tabela 13, Lista e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likuidimet e kryera prej saj për mbi pagesat e vendimet gjyqësore për çështje të tjera të ndryshme

Emri i kreditorit	Vendim Gjykate nr./dt	Objekti i Vendimit	Gjendja e palikjuara	Vendime të ardhura gjatë vitit 2023		Likjuar gjatë vitit 2023	Mbetja date 31.12.2023
			31/12/2022	Nr. dt. vendimit	Vlera e vendimit		
1	2	3	4	5	6	7	8=4+6-7
B sherbimi (pastrimi qytetit)	163 dt 09.02.2015	Sherbime pastrimi	2,326,217			886,216	1,440,001
Vgj per det kopeshti dhe q sociale Z	44, dt 22.01.2018	Tarife permbarimore	457,511			0	457,511
Rigjenerim i Shetitores Puke	58 dt. 08.06.2022	Investim	22,650,099	477/3 dt 16.08.2022		4,000,000	18,650,099
<b>Shuma V.Gjygsore 31.12. 2023</b>			<b>25,433,827</b>			<b>4,886,216</b>	<b>20,547,611</b>

*Burimi: Bashkia Pukë*

Tabela 14, Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për investimet (Nga të ardhurat e veta + transfertën e pakushtëzuar)

Nr	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Nr. i faturës	Data. e faturës	Vlera e detyrimit në 31.12.2022	Shtesat gjatë vitit 2023	Shlyerjet gjatë vitit 2023	Gjendja 31.12.2023
1	Shuma Shpenzime	B SHPK	10.12.2013	10,129,010	09.01.2014	225,000			225,000

2	"Rikonstruksion, Rruga e fshatit Lumzi"	OE "A-I G C	08.06.2011	11,718,559	08.04.2014	3,518,720		2,000,000	1,518,720
